Fatos Çoçoli

EKSPERIENCA E VENDEVE EUROPIANE NË AUDITIMIN E JASHTËM PUBLIK

Seria: botime KLSH: 15/2016/66

Tiranë, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Fatos Çoçoli

EKSPERIENCA E VENDEVE EUROPIANE NË AUDITIMIN E JASHTËM PUBLIK

Seria : botime KLSH: 15/2016/66

ISBN: 978-9928-159-54-0

Tiranë, 2016

Titulli:

"Eksperienca e Vendeve Europiane në Auditimin e Jashtëm Publik"

Përgatiti botimin:

Fatos Çoçoli

Redaktoi:

Redi Ametllari

Realizoi në kompjuter:

Benard Haka

Seria: botime KLSH 15/2016/66

©Copyright KLSH

ISBN: 978-9928-159-54-0

Shtypur në Shtypshkronjën "ILAR"

Tiranë, 2016

PËRMBAJTJA *FAQE*

Kapitulli I. Institucionet Supreme të Auditimit të Evropës dhe raporti i tyre me Parlamentet përkatëse **6**

Hyrje 6

Kapitulli II. Roli i komisioneve parlamentare në punën e SAI-ve **19**

Komisionet parlamentare që kanë kontakte të rregullta me SAI-t 28

Qasja Parlamenti Evropian-Gjykata Evropiane e Audituesve 31

Frekuenca me të cilën komisionet parlamentare takohen për të diskutuar çështjet e SAI-t 37

Rastet kur vendimet e komisioneve parlamentare konsiderohen si të vlefshme 38

Kërkesa ose ftesa ndaj Kryetarit të SAI-t për të marrë pjesë në Komisionin Parlamentar . 38

Persona të tjerë që normalisht ndjekin mbledhjet e Komisionit lidhur me SAI-n 40

Stafi mbështetës i komisioneve parlamentare 40

Mbulimi mediatik i takimeve të komisioneve parlamentare mbi SAI-n 41

Produktet e SAI-t në Parlament 43

Shqyrtimi i raporteve të auditimit të SAI-t nga komisionet parlamentare 46

Bashkëpunimi mes IPU dhe INTOSAI 53

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit nga Komisioni Parlamentar dhe SAI 54

Roli i Komisionit Parlamentar në auditimet e SAI-t. E drejta e Komisionit për të shqyrtuar dhe ndikuar në programin e auditimeve të SAI-t, për të kërkuar një auditim, hetim ose rishikim tjetër nga SAI 58

Kontaktet ndërmjet SAI-t dhe komisionit parlamentar para dhe pas takimeve në Komision 61

Ndikimi i komisioneve parlamentare në punën apo metodologjinë e auditimit të SAI-t ... 67

Funksione të tjera të Komisionit Parlamentar në lidhje me SAI-n. Propozimet dhe opinionet ligjore te SAI-t 67

Roli i komisionit parlamentar në shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të SAI-t 71

Shqyrtimi i raportit vjetor të aktivitetit të SAI-t nga ana e komisioneve parlamentare ... 72

Roli i komisioneve parlamentare në auditimin e SAI-t 73

Raporti Parlament, komisione të tij dhe SAI pare nga këndvështrimi i një SAI. Raport themeltar për mirëqeverisjen..... 73

Rekomandime për t'u zbatuar nga SAI 76

Çështje që drejtuesit e SAI-t mund të dëshirojnë të diskutojnë me anëtarët e Parlamentit 80

Veprimet që ndikojnë drejtpërdrejt marrëdhëniet SAI-Parlament 80

Veprimet që mund të rrisin rolin e Komisioneve Parlamentare 84

Kapitulli III. Dy Rezolutat e OKB-së për pavarësinë e SAI-ve. Simpoziumet OKB-INTOSAI **88**

Rezoluta e Parë (Përmbajtja)..... 93

Rezoluta e Dytë (Permbajtja)..... 97

Simpoziumi i 20 OKB-INTOSAI, 11-13 shkurt 2009, Vjenë, Austri 103

Simpoziumi i 21 OKB-INTOSAI, 13-15 qershor 2011, Vjenë, Austri 106

Simpoziumi i 22-të OKB-INTOSAI, 5-7 mars 2013, Vjenë, Austri..... 107

Simpoziumi i 23-të OKB/INTOSAI, 2-4 Mars 2015, Vjenë, Austri 113

Kapitulli IV. NIK-u polak dhe Parlamenti, NAO Britanike, SAI-t e Hollandës, Danimarkës, Norvegjisë, Portugalisë dhe Parlamentet e tyre **116**

Polonia: Rasti i një bashkëpunimi intensiv SAI-Parlament (NIK-SEJM) 125

Danimarka: Marredheniet mes SAI-t dhe Komisioneve Parlamentare..... 131

Norvegjia: Marrëdhëniet mes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë dhe Komisioneve Parlamentare 135

Portugalia: Marrëdhënia mes Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe Komisioneve Parlamentare 140

Kapitulli V. Kuvendi i Kosovës, komisionet e tij dhe Zyra Kombëtare e Auditimit. **142**

Raportet me Komisionin per Buxhet dhe Financa 145

Krijimi i Komisionit per Mbikqyrjen e Financave Publike: "PAC"-u kosovar 148

Buxheti i SAI-t në Kosove..... 155

KAPITULLI I

Institucionet Supreme të Auditimit të Evropës dhe raporti i tyre me Parlamentet përkatëse

Hyrje

Neni 16, Pika 1 e Deklaratës së Limës, e quajtur ndryshe "Magna Carta", Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) thekson se: "*Institucioni Suprem i Auditimit duhet të fuqizohet dhe të mandatohet nga Kushtetuta për t'i raportuar në mënyrë të pavarur dhe çdo vit gjetjet e tij Parlamentit ose çdo organi tjetër kompetent publik; ky raport duhet të publikohet. Kjo do të sigurojë shpërndarje të gjerë dhe diskutim, duke rritur mundësitë për zbatimin e gjetjeve të Institucionit Suprem të Auditimit*"[1]

Dr. Joseph Moser, ish-Sekretar i Përgjithshëm i organizatës botërore të SAI-ve, INTOSAI dhe ish-President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë, në fjalën e tij të hapjes së Simpoziumit të 21-të OKB-INTOSAI, në Vjenë, cilësoi se "*Auditimi i qeverisjes ka një traditë të gjatë. Ai i ka rrënjët në idenë që qytetarët kanë nevojë për kontroll, kudo që fondet publike të shpenzohen dhe pavarësisht nga lloji i qeverisë. Auditimi i qeverisjes – auditimi i fondeve publike – buron në origjinën e tij nga vetë qytetarët. Në sistemet demokratike, ky funksion kontrolli ushtrohet nga parlamentet kombëtare si institucione që përfaqësojnë qytetarët, popullin. Nga ana operative, parlamentet nuk e kryejnë dot këtë funksion të kontrollit vetë, por mbështeten në auditimin dhe punën këshilluese të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) dhe në raportet e tyre, çfarë përbën arsyen madhore pse marrëdhënia midis Parlamentit si institucioni publik me detyrë kontrollin dhe trupës supreme të auditimit është një partneritet i natyrshëm. Institucionet Supreme të Auditimit janë të pavarura nga ekzekutivi. Është detyra e tyre për t'i dhënë udhëzime administratës publike dhe qeverisë, duke paraqitur fakte për publikun, për menaxherët e sektorit publik dhe për politikëbërësit, për të identifikuar zhvillimet, si dhe të japin rekomandime, duke patur si qëllim për të luftuar abuzimet dhe zhvillimet e keqdrejtuara. Duke ushtruar këtë funksion të kontrollit, ne si SAI japim informacion të pavarur, të paanshëm dhe të besueshëm për parlamentet kombëtare, në mënyrë që ata të mbajnë përgjegjëse qeverinë dhe*

[1] *Deklarata e Limës, Lima, Peru, 1977, http://www.issai.org/media/12901/issai_1_e.pdf*

administratën publike. Në këtë mënyrë, SAI-t mbështesin parlamentet kombëtare në ushtrimin e detyrave të tyre"[2].

Vitor Caldeira, ish-President i Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA), në një intervistë[3] dhënë gazetares Rosmarie Carotti, është shprehur:" *Parlamenti Evropian është një nga partnerët kryesorë të ECA. Deri tani, ne kemi zhvilluar marrëdhënie të mira me Komisionin e Kontrollit Buxhetor. ECA ka për qëllim që të zhvillojë më tej bashkëpunimi me komisionet e tjera të specializuara. Unë besoj se jemi duke ecur në drejtimin e duhur, duke bërë të mundur për Parlamentin Europian qe t'i përdorë në mënyrën më të mirë raportet e ECA-s... Shumë iniciativa që Gjykata po merr, si "Shqyrtimi i Raportit Vjetor 2014", riorganizimi i auditimit tonë dhe proceset e raportimit për raporte të veçanta do të ndihmojnë Gjykatën për t'iu përgjigjur Parlamentit Evropian përmes bashkëpunimit të shtuar dhe duke ofruar raporte auditimi të cilësisë së lartë, të cilat janë edhe më të rëndësishme për nevojat e Parlamentit*".

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj, në Platformen e tij Strategjike[4] për zhvillimin e KLSH-së, paraqitur në dhjetor 2011 në Komisionin e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e Kryetarit të KLSH-së, ka theksuar se një ndër objektivat kryesore të punës së institucionit në 7 vitet e ardhshme do të ishte: "*Intensifikimi i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011- 2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues... Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat*".
Orientimi si më sipër i Deklaratës së Limës, dy Rezolutat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për nxitjen e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe

---

[2] *Dr. Joseph Moser, fjala e hapjes se Simpoziumit te 21-te OKB-INTOSAI, 13-15 korrik 2011, Vjenë, Austri, http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un-dpadm/unpan048597.pdf*

[3] *Vitor Caldeira, interviste dhene me rastin e konfirmimit per here te trete te mandatit si President i ECA-s, Mars 2014, http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/INTERVIEW_CALDEIRA_0314/Caldeira-March2014.pdf*

[4] *www.klsh.org.al/ home/KLSH/Plani Strategjik/Projekt-Ide*

transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit brenda harkut kohor të tre viteve (22 dhjetor 2011-19 dhjetor 2014), citimet e mësipërme të tre personaliteteve të auditimit suprem ndërkombëtar dhe vendas, me kontribute të spikatura në progresin e auditimit të jashtëm publik, si dhe domosdoshmëria për njohjen më të mirë reciproke dhe për të kuptuar qartë e zhvilluar një raport themelor për përmirësimin e qeverisjes, më shtynë të paraqes vrojtimet dhe përfundimet e mëposhtme modeste lidhur me natyrën eksperiencën e SAI-ve evropiane në marrëdhëniet SAI-Parlament.

xx

Për të qenë më efektiv, një SAI duhet të jetë i lirë të funksionojë në mënyrë të pavarur, pa u bërë subjekt ndikimi nga qendra të tjera të pushtetit, por duhet të ketë lidhje të mjaftueshme me të paktën një nga këto qendra të pushtetit. Pavarësia është jetike për të siguruar objektivitetin në punën e auditimit dhe, së bashku me kompetencën profesionale të stafit të auditimit, për të krijuar një bazë për besueshmërinë e rezultateve të auditimit. Nga ana tjetër, lidhjet efektive me një nga qendrat e tjera te pushtetit (legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori, etj.) janë jetike për të siguruar që raportet e auditimit do të marrin vëmendjen e duhur nga këto qendra, të cilat kanë autoritetin për të ndërmarrë veprime korrigjuese ose për të siguruar që të tjerët ta bëjnë këtë. Këto, pavarësia e SAI-t dhe lidhjet efektive me qendrat e tjera të pushtetit, përbëjnë një balancë delikate.

Deri në vitet 90-të të shekullit të kaluar, marrëdhëniet e ngushta SAI-Parlament ishin thjesht një dukuri e rrallë në shumicën e vendeve të botës, duke përjashtuar vendet anglosanksone, si SHBA, Britani e Madhe, Kanada, Australi, me tradita të një jete parlamentare të zhvilluar dhe me kërkesë të spikatur të llogarisë publike. Zakonisht, deri në këtë kohë, Parlamentet dhe komisionet përkatëse parlamentare tregonin vëmendje dhe shprehnin shqetësim vetëm për paraqitjen e një raporti vjetor (shpesh i vonuar) dhe raportet e rastit të hollësishme të auditimit. Në vitet e fundit, këto marrëdhënie kanë fituar një karakter më të rëndësishëm dhe ndonjëherë paraqiten me frekuencë edhe ditore. Ky ndryshim ka çuar në një zgjerim të njohurive të anëtarëve të Parlamentit në çështjet e auditimit suprem publik. Zgjerimi i njohurive te deputetëve të Parlamentit dhe për pasojë rritja e interesimit të tyre për rezultatet e auditimeve të SAI-t kombëtar ka ndihmuar edhe Parlamentin për të kryer funksionet e veta mbikëqyrëse ndaj Ekzekutivit në mënyrë më efiçiente dhe efektive, me profil më të rritur publik.

Marrëdhëniet e Kontrollit të Lartë të Shtetit me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë reflektojnë kërkesat e kohës për më shumë përgjegjësi në menaxhimin e fondeve publike dhe janë zhvilluar pozitivisht dhe me efektivitet, sidomos gjatë viteve të fundit. Këtë e dëshmon nisma e rishikimit të ligjit integral të Kontrollit të Lartë të Shtetit(miratuar në vitin 1997), e përfunduar në nëntor 2014, në të cilën si KLSH dhe Kuvendi (në veçanti Komisioni për Ekonominë dhe Financat, sidomos Kryetari dhe Sekretari i tij, por edhe deputetët e tjerë të Komisionit luajtën një rol parësor për miratimin e një ligji modern për KLSH), mirëpritën dhe mbështetën variantin e paraqitur nga Kryetari i KLSH dhe bashkëpunuan ngushtësisht me strukturat e Bashkimit Evropian, si Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit DG-Budget dhe Programi SIGMA, duke dhënë një ligj tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, çka ishte dhe një kërkesë e përsëritur në vijimësi e Bashkimit Evropian në Progres Raportet e tij për Shqipërinë për vitet 2011, 2012 dhe 2013.

Teorikisht, ekziston një marrëdhënie simbiotike mes një SAI dhe Parlamentit për të cilin ai raporton. Këto dy institucione të rëndësishme, por të ndara me njëra-tjetrën, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive. Parlamenti mund të kryejë funksionet e tij vitale të mbikëqyrjes në mënyrë më efektive, kur ai përdor dhe mund të mbështetet mbi punën audituese të SAI-t. Në mënyrë të ngjashme, SAI mund të jetë shumë më efektiv kur Parlamenti dhe komisionet e tij sigurojnë si një forum për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve të SAI-t, ashtu dhe përbëjnë një aleat të mundshëm në nxitjen e Ekzekutivit si dhe në inkurajimin e fuqishëm të institucioneve të tjera të pavarura, për të ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese të propozuara nga SAI.

Ne prezantimin e tij me titull: "Marrëdhëniet SAI-Parlament si një nga prioritetet afatgjatë të zhvillimit të auditimit shtetëror"[5], Prof. Dr. Recai Akyel, ish-President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë thekson se "*Parlamenti është i adresuari kryesor i raporteve të auditimit të SAI-t, dhe pse SAI ka edhe disa palë të tjera interesi. Prandaj dhe marrëdhëniet mes Parlamenteve dhe SAI-ve duhet të bazohen në këtë lidhje. Veprimet buxhetore dhe administrative kryhen më me efektshmëri kur Parlamentet mbështesin dhe ndjekin zbatimin e veprimeve të rekomanduara në raportet e auditimit të SAI-t dhe që kërkohet të kryhen nga administratat publike. Ka një lidhje*

[5] *Prof. Dr. Recai Akyel, prezantim ne Parlamentin Turk, shtator 2014, www.sayistay.gov.tr/En/Upload/files/Astana%202011.pps*

direkte mes efektivitetit të raporteve të auditimit të një SAI dhe interesit të treguar nga Parlamenti. Një tjetër tregues i interesit të Parlamentit në raportet e SAI-t është që Parlamenti të ketë ngritur strukturën për procesin e ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t dhe që i ndjek ato në mënyrë konsistente"

Përgjegjshmëria, transparenca dhe vlera e parasë publike në përdorimin e fondeve publike janë elementë thelbësore të qeverisjes demokratike. Qeveria pritet të japë llogari përpara përfaqësuesve të zgjedhur në Parlament dhe publikut në përgjithësi, lidhur me administrimin nga ana e saj të parave të taksapaguesve. SAI-t mund të japin një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë proces administrimi fondesh publike, duke siguruar një shqyrtim të pavarur, informacion, siguri dhe këshilla për pasqyrat financiare dhe llogaritë e paraqitura nga Ekzekutivi, si dhe për realizimin e programeve, projekteve, iniciativave dhe aktiviteteve të tjera të nisura nga qeveria .

SAI-t në vendet demokratike në të gjithë botën përpiqen të sigurojnë që të raportojnë lirshëm dhe në mënyrë të pavarur, larg çdo ndikimi të cilitdo krah të politikës dhe qendrave të tjera të pushtetit. Ata gjithashtu përpiqen fort që gjetjeve të tyre nga auditimet dhe rekomandimeve që japin t'u kushtohet vëmendja e duhur dhe të zbatohen plotësisht e në kohë. Në mënyrë ideale, Parlamentet dhe SAI-t janë dy elemente të një sistemi të balancuar të llogaridhënies së qeverisë. Qeveria është përgjegjëse për mënyrën se si ajo ekzekuton Buxhetin e Shtetit, sikurse është miratuar nga Parlamenti.

Si pjesë e detyrës së tij të kontrollit dhe shqyrtimit të mënyrës se si përdoren fondet publike, Parlamenti shqyrton ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit dhe jep një opinion për mënyrën se si qeveria ka ekzekutuar buxhetin, duke e miratuar apo jo atë. SAI kontribuon në këtë rol të Parlamentit duke dhënë rezultatet e auditimeve të tij, një opinion mbi zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit të vitit paraardhës, mendime për Buxhetin e Shtetit të vitit të ardhshëm, rekomandime për përmirësime të kuadrit ligjor ekzistues apo për nisma të reja ligjore, etj.

Sipas Anders B. Johnsson, Sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndërparlamentar Botëror (INB), " *Parlamenti është institucioni kryesor i besuar nga qytetarët për ta mbajtur qeverinë përgjegjëse për fondet publike që ajo menaxhon, por nuk mund të arrijë këtë pa mbështetjen e SAI-t. Në fakt, një studim i fundit i kryer nga IPU-ja tregon se në*

shumicën e vendeve (85%), raporti i SAI-t përbën burimin kryesor të informacionit për Parlamentin në punën e tij kontrolluese"[6].

Një objektiv qendror i këtij sistemi të llogaridhënies, në të cilin SAI-t i duhet të luajë një rol vendimtar si një organizatë profesionale dhe e pavarur, është të garantojë që fondet publike shpenzohen në një mënyrë të rregullt dhe efiçiente, si dhe që mangësitë e mundshme janë korrigjuar në kohën e duhur dhe me efektivitet. Vëmendja politike nga Parlamenti ndihmon për të ushtruar presionin e duhur pozitiv mbi qeverinë dhe ky presion është i nevojshëm, si dhe kontribuon në krijimin e një mjedisi të favorshëm për vendosjen e një kulture të konsiderimit dhe zbatimit me përparësi të lartë të rekomandimeve të auditimit suprem.

Marrëdhëniet ndërmjet SAI-ve dhe Parlamenteve ndryshojnë shumë në mjaft vende të botës. SAI si strukturë mund të jetë pjesë e Legjislativit apo rrallë e Ekzekutivit, ose i pavarur nga të dy. Strukturat e ndryshme të SAI-ve jepen në mënyrë më të detajuar në Boksin e mëposhtëm:[7]

---

[6] *Anders B. Johnsson, fjala në Konferencën për Fuqizimin e Auditimit Publik të Jashtëm në rajonet e INTOSAI-t, maj 2010, Vjenë. http://www.intosai.org/uploads/intosaipublikation02112010small.pdf*

[7] [7]*Botim i Arkivave Kombëtare te Qeverise Britanike, 2014*

http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/+/http:/www.dfid.gov.uk/aboutDFID/organisation/pfma/pfma-externalaudit-briefing.pdf

Boks 1

Modelet e SAI-ve

Sipas praktikave te deritanishme dhe dokumenteve te INTOSAI-t, tri janë modelet e sistemit te auditimit te njohura botërisht:

1. *Modeli i Westminster-it, i njohur gjithashtu si modeli ango-sakson ose parlamentar. Atë e zbatojnë Britania e Madhe, Irlanda, pjesa me e madhe e vendeve te Komunuelthit Britanik, si dhe Danimarka. Po ashtu vendet e Ameriks Latine si Peruja dhe Kili. E zbatojmë edhe ne në Shqipëri ne vija te përgjithshme.*

2. *Modeli gjyqësor ose i Napoleonit. E zbatojnë ne Evrope vendet latine si Italia, Spanja, Portugalia, si dhe Turqia. E zbatojnë po ashtu edhe shume vende te Amerikës Latine si Brazili, Kolumbia, etj.*

3. *Modeli me Bord ose modeli Kolegjial. Ne Evrope e zbatojnë Gjermania dhe Hollanda, ndërsa ne Azi Japonia, Indonezia, etj.*

Sipas një modeli Westminster, puna e Institucionit Suprem të Auditimit (SAI) është e lidhur thelbësisht me sistemin e llogaridhënies parlamentare. Elementët bazë të një sistemi të tillë janë:

- *Autorizimi i shpenzimeve nga Parlamenti;*
- *Prodhimi i llogarive vjetore nga të gjitha departamentet e qeverisë dhe organet e tjera publike;*
- *Auditimi i këtyre llogarive nga ana e SAI-t;*
- *Paraqitja e raporteve të auditimit në Parlament për shqyrtim nga një komision i dedikuar-zakonisht i quajtur Komisioni i Llogarive Publike ;*

Boks 1

• Në Parlament në seanca plenare diskutohen shpesh raportet e këtij komisioni dhe çështjet e zbatimit të rekomandimeve të SAI-t

• Qeveria mbahet përgjegjëse nga Parlamenti dhe ju përgjigjet raporteve të komisionit të dedikuar.

Modeli Gjyqësor

Sipas këtij modeli, SAI është një pjesë integrale e sistemit gjyqësor, i cili operon në mënyrë të pavarur nga degët ekzekutive dhe legjislative. Në këtë model, SAI ka një marrëdhënie të kufizuar me Parlamentin kombëtar. Një aspekt kyç i sistemeve të përgjegjshmërisë gjyqësore është se zyrtarët përkatës të qeverisë zakonisht mbahen personalisht përgjegjës për shumat e përfshira, në rast se kryejnë një pagesë të paautorizuar apo të paligjshme. Përveç rolit gjyqësor të SAI-t, ky model ka të vendosur një sistem plotësues të nivelit të lartë të përgjegjësisë parlamentare për shpenzimet publike.

SAI në sistemin gjyqësor është i njohur zakonisht si Gjykata e Llogarive (ose e Auditimit) dhe në përgjithësi është një Gjykatë më vetë dhe merret vetëm me çështjet financiare publike. Më rrallë, mund të jetë pjesë e Gjykatës së Lartë, dhe është e njohur me emrin Dhoma e Llogarive. Një Gjykatë e Llogarive në përgjithësi gëzon një profil më të lartë dhe një shkallë më të madhe të autonomisë se një Dhomë e Llogarive.

Modeli Kolegjial ose me Bord

Sipas sistemit kolegjial, SAI ka një numër anëtarësh të cilët formojnë një kolegj apo bord qeverisës të tijin, dhe i marrin vendimet së bashku. Organet kolegjiale të auditimit zakonisht janë pjesë e një sistemi parlamentar të llogaridhënies. Raportet dhe opinionet e miratuara nga kolegji i paraqiten Parlamentit, ku zakonisht një formë e Komisionit të Llogarive Publike mbikëqyr punën e SAI-t. Organet kolegjiale nuk kanë funksione gjyqësore. Struktura themelore e modelit të llogaridhënies është e ngjashme me modelin Westminster, me dallimet kryesore në strukturën e brendshme të institucionit suprem të auditimit.

Ndryshimet dhe variacionet e gjera pasqyrojnë faktorët historikë, kulturorë, politikë apo dhe ndikime të tjera në secilin vend. Pothuajse të gjithë SAI-t, pavarësisht strukturës organizative dhe vendit formal në strukturën dhe oligarkinë shtetërore, njohin rëndësinë e sigurimit të pavarësisë së tyre, ndërkohë që u duhet të sigurojnë edhe vëmendjen e duhur parlamentare ndaj rezultateve të auditimit, si një hap thelbësor në ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese mbi problemet e zbuluara gjatë procesit të auditimit.

Rëndësia e marrëdhënieve midis SAI-ve dhe Parlamenteve është theksuar dhe në teorinë e auditimit të jashtë publik dhe pikërisht në standardet ISSAI të organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI (INTOSAI përfshin 192 SAI nga vende të ndryshme të botës). Në veçanti për marrëdhëniet Parlament-SAI është shprehur ISSAI 12.[8]

Boks 2

ISSAI 12

"Vlerat dhe Përfitimet nga institucionet supreme të auditimit-të bësh diferencën në jetët e qytetarëve"

Parimi 6 "Komunikimi efektiv me Parlamentin dhe palët e tjera të interesuara" u kërkon SAI-ve të zhvillojnë marrëdhënie profesionale me Parlamentin dhe partnerët e tjerë, duke "*...komunikuar me Parlamentin dhe veprimtarët e tjerë të interesuar në një mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësive të SAI-t si një auditues i pavarur i sektorit publik;*

(b) kontribuar për rritjen e vetëdijes së Parlamentit dhe palëve të tjera të interesuara për nevojën e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik;

(c) siguruar të kuptuarit e punës dhe rezultateve të auditimit të SAI-t.

SAI-t duhet të angazhohen me Parlamentin dhe grupet e interesit, duke njohur rolet e ndryshme të tyre, si dhe duke marrë parasysh pikëpamjet e tyre, pa kompromentuar pavarësinë e SAI-t. Ato duhet periodikisht të vlerësojnë nëse Parlamenti dhe palët e tjera të interesuara mendojnë se SAI është duke komunikuar në mënyrë efektive".

[8] http://www.issai.org/media/84539/issai-12-e.pdf

Detyrat e mësipërme, që duhet të zbatohen me rigorozitet nga SAI-et, kontribuojnë në rritjen e vëmendjes së Parlamentit ndaj punës audituese të SAI-t dhe në shtimin e përpjekjeve të tij për të siguruar një proces efektiv të ndjekjes nga Parlamenti të zbatimit të rekomandimeve të SAI-t.

Dr. Joseph Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë, shprehet se *"Në përputhje me moton e INTOSAI-t "Experientia mutua Omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët fitojnë të gjithë)" është detyra jonë themelore për të vazhduar bashkëpunimin dhe punën ne rrjet në një shkallë globale, në mënyrë që të forcojmë më tej pozitën e SAI-ve në nivel global dhe të punojmë në mënyrë të vazhdueshme drejt dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara. Vetëm në qoftë se ne arrijmë të kryejmë detyrën tonë kushtetuese dhe të përmbushim pritshmëritë ndaj nesh, do të jemi në gjendje për të siguruar besimin e institucioneve (në veçanti të Parlamenteve) dhe qytetarëve në mënyrë të qëndrueshme, si bazë për punën tonë*[9]".

Dr. Josef Moser, një nga figurat dhe personalitetet qendrore të INTOSAI-t dhe auditimit suprem publik në botë

Shtimi i vëmendjes së Parlamenteve ndaj rolit dhe rezultateve të punës audituese të SAI-ve paraqitet në mënyra të ndryshme, por kryesisht nëpërmjet caktimit të sferës së veprimtarisë së një ose disa komisioneve parlamentare kushtuar marrëdhënieve me SAI-n, apo nëpërmjet ngritjes së nënkomisioneve të posaçme për këto marrëdhënie.

Komisionet parlamentare që kanë kontakte me SAI-t janë ngritur në një numër të madh Parlamentesh te botes. Qëllimi i tyre kryesor është të shqyrtojnë në detaje

[9] *Dr. Josef Moser, fjala e hapjes se Simpoziumit te 21-te OKB-INTOSAI, 13-15 korrik 2011, Vjenë, Austri, faqe 6.* http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un-dpadm/unpan048597.pdf

raportet e auditimit, duke marrë në konsideratë vëzhgimet e SAI-t, gjetjet dhe rekomandimet e tij, duke paraqitur si komisione komentet e tyre ne Parlament, lidhur me veprimtaritë qeveritare te shqyrtuara nga SAI. Komisionet parlamentare shpesh shihen si një mjet për përmirësimin e llogaridhënies publike dhe forcimin e rolit të SAI-ve.

SAI-et, nga ana e tyre, duhet të jenë plotësisht të përgatitura për të punuar me Parlamentin dhe komisionet e tij.

Kjo nënkupton:

- Vendosjen dhe miratimin e politikave dhe standardeve te duhura të auditimit, duke u siguruar që ato të zbatohen;
- Shkruarjen e raporteve te auditimit në mënyrë të qartë dhe koncize, të drejtë dhe faktike, duke shmangur deklaratat politike;
- Miratimin dhe zbatimin e standardeve të duhura etike;
- Dhënien e konsideratave të duhura - por jo ekskluzive - për shqetësimet parlamentare në vendosjen e përparësive të auditimit;
- Të qenit selektiv dhe shumë përgjegjës në përcaktimin se cilat raporte të auditimit të paraqesë në Parlament, duke dërguar vetëm ato raporte të cilat në mënyrë të qartë meritojnë vëmendje parlamentare dhe të cilat përfshijnë një deklaratë-shpjegim të qartë se pse raporti është dërguar në Parlament;
- Të konsiderojë krijimin e një njësie ose caktimin e një personi të veçantë për të koordinuar kontaktet e SAI-t me Parlamentin, për të lehtësuar komunikimin dhe për të ndihmuar ndërgjegjësimin e plotë të SAI-t ndaj nevojave dhe interesave parlamentare;
- Të ndjekë në mënyrë aktivite dhe metodike zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të auditimit dhe të informojë Parlamentin ndaj ndonjë rasti mosveprimi apo moszbatimi rekomandimesh për çështje të rëndësishme;.
- Të shmangë komentet e drejtpërdrejta ndaj politikave të qeverisë, por duke vënë në dukje se zbulimi i problemeve të zbatimit të tyre mund të ngrejë pikëpyetje rreth politikave në fjalë. Sikurse e ka theksuar Gene L. Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i GAO-s Amerikane në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH me rastin e 90 vjetorit të institucionit, "*Institucionet Supreme të*

auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën... Ne nuk bëjmë politika. Ato i ka Kongresi. Ne auditojmë realizimin e politikave dhe programeve të Qeverisë[10]*”.*

SAI-t e zhvilluara tregohen shumë të kujdesshme në raportet me Parlamentet. Dr. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve(ECA), në raportimin përpara Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të Parlementit Evropian për planin e auditimeve të ECA-s per vitin 2015, shprehej: “*Në vitin 2015, kemi në plan për të prodhuar më shumë raporte për kryerjen e politikave dhe programeve të veçanta të BE-së se kurrë më parë. Por ne gjithashtu e kuptojnë se koha e auditimit ka rëndësi. Për vitin 2015, ne tashmë kemi në plan të reduktojmë kohën mesatare që marrim për të prodhuar një raport auditimi, ndërkohë që do të vijojmë t’i prodhojmë ato në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit*[11]”.

Në tërësi, SAI-t duhet të shmangin me skrupolozitet riskun që të duken sikur po instruktojnë Parlamentin se si ai të kryejë përgjegjësitë e tij kushtetuese.

Përgatitje, nga ana tjetër, kërkohet edhe prej komisioneve parlamentare që merren me veprimtarinë e SAI-t. Kjo nënkupton:

- Caktimin e një komisioni parlamentar për të mbikëqyrur financat e SAI-t (pa ndërhyrje nga qeveria) dhe për të rishikuar - por jo në mënyrë të drejtpërdrejtë - punën e tij. Parlamenti duhet të sigurojë se vetë SAI është audituar në mënyrë të pavarur dhe në zbatim të standardeve të njëjta që aplikohen nga SAI tek të audituarit e tij;

- Specifikimi i qartë i llojeve të raporteve të auditimit që duhet të paraqiten në Parlament, por krahas së qenit selektiv, është mirë t’ia lërë detyrën e përzgjedhjes në diskrecionin e SAI-t, aty ku është e mundur;

- Të informojë SAI-n për interesat parlamentare mbi auditimet e SAI-t, duke përfshirë tema të sugjeruara të auditimit, por duke ia lënë SAI-t vendimin final për prioritetet e auditimit;

---

[10] Gene L. Dodaro, http://www.klsh.org.al/web/pub/90_vjetori_2262_1.pdf

[11] Vitor Caldeira, fjala përpara Komisionit te Parlamentit Evropian për Kontrollin e Buxhetit, 19 janar 2015, faqe 2, http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/ECA1503_SPEECH/ECA1503_SPEECH_EN.pdf

- Të kërkojë që të gjitha raportet e auditimit, nëse nuk kufizohen për shkaqe të caktuara (sekret shtetëror, konfidencialitet, etj.), të bëhen publike nga SAI brenda një periudhë të arsyeshme kohore;

- Për shkak të rolit të rëndësishëm të komisioneve parlamentare në përdorimin e punës së SAI-t dhe në mbikëqyrjen e qeverisë, Parlamenti lypset të vendosë rregulla për funksionimin e këtyre komisioneve parlamentare (SIGMA [12], Programi i BE dhe OECD i Mbështetjes për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim, që në vitin 2002 ka përgatitur një listë parimesh dhe detyrash për t'u kryer nga komisionet parlamentare, për t'u siguruar atyre mbështetjen e duhur).

- Të sigurojë që komisioni parlamentar i përshtatshëm merr dijeni të shpejtë dhe të plotë rreth raporteve të auditimit të SAI-t (shpërndarja elektronike ose e printuar e raporteve tek çdo anëtar komisioni, etj.).

- Mbledhjet e komisioneve parlamentare mund të jenë një mjet i rëndësishëm për të tërhequr vëmendjen për problemet e shfaqura në raportet e auditimit te SAI-t. Takimet e komisionit duhet të jenë të hapura për publikun dhe mediat (nëse nuk kufizohet pjesëmarrja për arsye të caktuara), dhe në to duhet të marrin pjesë drejtues nga SAI dhe përfaqësues nga të audituarit, në mënyrë që të maksimizohet efikasiteti i tyre. Anëtarët e Komisionit duhet të përgatiten për të tilla takime, duke zhvilluar pyetjet që mendojnë dhe duke marrë informacione shtesë, si ta konsiderojnë të nevojshme. Në përfundim të takimeve të komisioneve parlamentare, Komisioni mund ta konsiderojnë të përshtatshme për të filluar veprimet e tij në përgjigje të një raporti auditimi të SAI-t. Veprime të tilla duhet, nëse është e mundur, të reflektojnë dakordësinë ndërmjet anëtarëve të Komisionit, pasi kjo do të maksimizonte efektivitetin e punës së Komisionit. Asistenca teknike duhet t'i kërkohet SAI-t, nëse konsiderohet e dobishme.

Qeveria po ashtu duhet të jetë e gatshme për t'iu përgjigjur raporteve dhe veprimeve të tjera të ndërmarra nga Komisioni dhe SAI, ndërsa Komisioni Parlamentar dhe SAI duhet të ndjekin hap pas hapi veprimet e qeverisë lidhur me problemet e ngritura.

---

[12] *SIGMA, Broshura Nr. 33, fq. 18, viti 2002* *http://www.oecd-ilibrary.org/docserver/download/5kml60vd5x8r.pdf?expires=1458381416&id=id&accname=guest&checksum=79324EF56780FE1CCE00*

KAPITULLI II

Roli i komisioneve parlamentare në punën e SAI-ve

Në mbarë botën, mënyra se si marrëdhënia SAI-Parlament funksionon reflektohet në forma të ndryshme, në varësi të këndvështrimit të Parlamentit dhe formës dhe strukturës së SAI-t. Ka vende ku SAI-t kanë raporte gati të përditshme, formale, gjysmë-formale ose dhe jo-formale me Komisione të caktuara Parlamentare. Ka vende të tjera ku raporti mbahet rigorozisht formal, sikurse ka edhe vende ku ky raport është shumë periferik ose i fragmentuar në momente të caktuara kohore (një ose disa herë në vit kur SAI raporton në Parlament). Pavarësisht nga lloji dhe frekuenca e marrëdhënies SAI-Parlament, e rëndësishme është që në shumica dërrmuese e SAI-ve në botë konsiderohen si të pavarura si nga Parlamenti dhe nga Qeveria.

Marrëdhëniet midis SAI-t dhe Parlamentit në shumë vende të botës janë forcuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë dy-tre dekadave të fundit. Sidomos në 8 vitet e fundit, pas shpërthimit të krizës së përbotshme financiare dhe ekonomike në vitin 2008, kur roli i SAI-ve në shëndoshjen e financave publike u rrit ndjeshëm, këto marrëdhënie morën një theks të veçantë. Këtë e konfirmoi dhe Kongresi INCOSAI 21[1] i organizatës INTOSAI në Pekin, më tetor 2013, i zhvilluar nën moton "Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare", i cili theksoi se "*SAI-t duhet të inkurajojnë transparencën e informimit, për të informuar më mirë publikun, Parlamentin dhe grupet e tjera kyçe të interesit, si dhe përgjegjshmërinë, lidhur me kuadrin e financave publike, në mënyrë që të bëjë publik pozicionin dhe ekzistencën e ndonjë pengese, risku dhe sfide që mund të kërkojë vëmendje nga qeveria".*

Ky Kapitull hapet me një aktivitet për marrëdhëniet midis SAI-ve dhe Parlamenteve të vendeve kandidate dhe aspirante për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Ballkanit Jugperëndimor (Konferencë e zhvilluar në Mal të Zi më datat 18-20 Nëntor 2013, në bashkëpunim me SIGMA-n dhe Gjykatën Evropiane të Auditues ve (ECA)), për të dëshmuar perspektivën e qartë integruese në BE që hap përmirësimi dhe rritja e efektivitetit të këtyre marrëdhënieve.

[1] *Deklarata e Pekinit, faqe 23, tetor 2013, http://www.intosai.org/news/previous-information/previous-information-2013/291013-xxi-incosai-outcome.html*

Në shumicën e vendeve kandidate dhe aspirante për anetaresim në BE, SAI-t kanë marrëdhënie të ngushta me parlamentet përkatëse dhe në përgjithësi, një klimë bashkëpunuese. Këto marrëdhënie mes SAI-ve dhe Parlamenteve u konfirmuan edhe nga Konferenca e Budva-s në Mal të Zi e nëntorit 2013, e pasuar nga Takimi i shtatorit 2016 i rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe para-kandidate për në BE, zhvilluar në Sarajevë të Bosnje-Hercegovinës, në lidhje me pavarësinë e SAI-ve.

"Foto nga Konferenca për Marrëdhëniet midis SAI-ve dhe Parlamenteve mbajtur në Budva, Mal i Zi më datat 18-20 Nëntor 2013, në bashkëpunim me SIGMA-n. Nga e djathta në të majtë z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës, Prof. Dr. Rejai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, zj. Tanja Tanevska, Audituese e Përgjithshme e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë, z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës, Dr. Vitor Caldeira, President i Gjykates Evropiane te Audituesve, Dr. Milan Dabović, President i Senatiti të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, z. Radoslav Sretenović, Auditues i Përgjithshëm i Institutit Shtetëror të Auditimit të Serbisë dhe Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH".

Konferenca e Budvës doli me Rezolutën si në Boksin e mëposhtëm, për thellimin dhe forcimin e raportit SAI-Parlament:

Boks 3

Rezoluta e Konferencës së 19 Nëntorit 2013 mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve

Budva, Mali i Zi

Ne, Udhëheqësit e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potenciale për t'u anëtarësuar në BE, me mbështetjen e Gjykatës Evropiane të Audituesve, u takuam në Budva më 19 nëntor 2013,

Duke kujtuar Marrëveshjen e Stambollit, në veçanti:

- angazhimin për të vazhduar të luajmë rolin tonë në zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve pozitive mes SAI-ve dhe Parlamenteve kombëtare, bazuar në respektin e ndërsjellë për rolin dhe pavarësinë e të dy palëve;

- vendimin për të organizuar një konferencë mbi rëndësinë e rritjes së marrëdhënieve konstruktive mes SAI-ve dhe Parlamenteve, si dhe me organet e tjera të administratës publike;

Duke njohur parimet tashmë të përcaktuara në dokumentin e SIGMA-s Nr. 33 mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Komisioneve Parlamentare (Sigma, Paris, 2002), sidomos parimet e:

- llogaridhënies, transparencës dhe efiçiencës (vlerës për para) në përdorimin e fondeve publike, të cilat janë elemente thelbësorë të qeverisjes demokratike;

- Qeveria Ekzekutive pritet të japë llogari tek përfaqësuesit e zgjedhur në Parlament dhe tek publikun në përgjithësi për administrimin nga ana e saj të parave të taksapaguesve;

- SAI-t mund të japin një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë proces të administrimit të parave të taksapaguesve, duke siguruar një shqyrtim të pavarur, duke dhënë informacion, siguri dhe këshilla lidhur me llogaritë e paraqitura nga Ekzekutivi, si dhe në zbatimin e programeve, projekteve, nismave dhe aktiviteteve të tjera të nisura nga Qeveria;

Duke përshëndetur Rezolutën e OKB-së me Nr. A / 66/209 të datës 22 dhjetor 2011, në të cilën Asambleja e Përgjithshme e OKB-së inkurajon të gjitha Shtetet Anëtare të OKB-së për të zbatuar parimet e përcaktuara në deklaratat e Limës dhe të Meksikës, duke ilustruar mbështetjen e gjerë botërore për zbatimin e këtyre parimeve themelore;

Duke theksuar se në këtë Rezolutë të OKB-së, pavarësia operacionale e SAI-ve është cilësuar si thelbësore për funksionimin e mirë të SAI-ve dhe se thirrja për forcimin e SAI-ve në këtë Rezolutë kërkon që burime të mjaftueshme financiare të jenë vënë në dispozicion;

Duke marrë parasysh konkluzionet e Konferencës së Budvas mbi Marrëdhëniet ndërmjet Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Parlamenteve të vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potenciale për në BE, që:

- efektiviteti i SAI-ve si auditorë publikë dhe nxitës të transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mire, është i lidhur direkt me aftësinë e tyre për t'u angazhuar dhe për të bashkëpunuar me veprimtarët e tjerë, në veçanti me Parlamentet në rolin e tyre të mbikëqyrjes politike të menaxhimit të fondeve publike;

- kjo duhet të bazohet në respektin e ndërsjellë për pavarësinë, rolin dhe përgjegjësinë e SAI-ve dhe Parlamenteve në sistemin e përgjithshëm të përgjegjësisë demokratike;

- një mbështetje dhe bashkëpunim i tillë duhet të kuptohet në një kontekst ku SAI-t dhe Parlamentet ndajnë qëllimin e përbashkët për të siguruar menaxhim të shëndoshë financiar dhe përgjegjshmëri për të mirën e qytetarëve, duke përfshirë kontributin në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit;

- duke kërkuar mënyrën më të mirë për të arritur këtë qëllim të përbashkët, e cila nënkupton vlerësimin e praktikave aktuale, identifikimin e praktikave të mira dhe maksimizimin e përpjekjeve të përbashkëta të SAI-ve dhe Parlamenteve; si dhe,

- duke bërë kështu, SAI-t kontribuojnë në forcimin e zinxhirit të llogaridhënies dhe të institucioneve të përfshira, duke shtruar rrugën për anëtarësim në BE.

Duke vënë në dukje sidomos propozimin për të zhvilluar udhëzime të duhura, të cilat mund të përdoren nga SAI-t individuale dhe nga Parlamentet për të forcuar bashkëpunimin e tyre reciprokisht të dobishëm;

Vendosëm:

- të monitorojmë rregullisht progresin në vende të veçanta në lidhje me zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet SAI-ve dhe Parlamenteve;

- për këtë qëllim, udhëzime të përshtatshme do të zhvillohen nga një Grup Pune i Zyrtarëve Ndërlidhës të interesuar dhe / ose nga ekspertët përkatës.

Nënshkruesit e Rezolutës:

Prof. Dr. Rejai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë

Zj. Tanja Tanevska, Audituese e Përgjithshme e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë

Z. Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnje-Hercegovinës

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

Z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës

Z. Radoslav Sretenović, Auditues i Përgjithshëm i Institutit Shtetëror të Auditimit të Serbisë

Z. Milan Dabović, President i Senatit të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi.

Përgatitur në Budva, Mali i Zi, më 19 nëntor 2013.

Në datën 8 shtator 2016, në Sarajevë, me iniciativë të Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnje dhe Hercegovinës u mbajt takimi i Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe para-kandidate për në BE, me pjesëmarrjen edhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe të SIGMA-s, ku u diskutua lidhur me Pavarësinë e SAI-ve të Ballkanit Jug Perëndimor.

Foto nga Takimi në Sarajevë

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësuesit e tetë SAI-ve nga Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova, Shqipëria, Serbia, Rumania dhe Turqia.

Punimet e takimit u hapën me rezultatet e një sondazhi për pavarësinë e SAI-ve, në të cilin kanë marrë pjesë SAI-t e vendeve kandidate dhe para-kandidate për në BE në Ballkanin Jug Perëndimor, si edhe Gjykata Evropiane e Audituesve. Nga përgjigjet e sondazhit rezultoi se disa SAI gëzojnë një nivel dukshëm më të lartë të pavarësisë se të tjerët. Sipas përgjigjeve të paraqitura nga dhjetë SAI, SAI-t e Shqipërisë, Kosovës, Turqisë, Maqedonisë dhe Republikës së Bosnje Hercegovinës janë në pozita më të favorshme në lidhje me nivelin e tyre të përgjithshëm të pavarësisë. Nga ana tjetër, SAI-t e Malit të Zi, Serbisë dhe Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës përballen me sfida më të mëdha të shkaktuara kryesisht nga devijimet apo boshllëqet në mes të çfarë është përcaktuar zyrtarisht nga ligjet dhe asaj që ndodh në realitet.

Nga të dyja aktivitetet doli e qartë perspektiva integruese e marrëdhënieve SAI-Parlament, parë dhe në këndvështrimin e funksioneve të reja që SAI-t më të zhvilluara në BE, sidomos ECA, SAI i Holandës, SAI suedez, ai norvegjez, etj., kanë marrë në vlerësimin e përgjegjësive fiskale, në bashkëpunim me parlamentet përkatëse. Këtij fokusi të ri i shërbeu edhe Seminari i organizuar nga SIGMA dhe i mbajtur në Podgoricë më 28 maj 2015, me titull "*Vlerësimi i përgjegjësive fiskale, roli i SAI-t dhe i Parlamentit*"[2], ku Presidenti i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Milan Dabović theksoi Ligjin e ri për buxhetin e Shtetit, përgjegjësitë e reja fiskale dhe implikimet e tyre në veprimtarinë e SAI-t. Ai prezantoi historinë e ligjit të ri të Buxhetit të Shtetit dhe detyrat e reja të SAI-t në vlerësimin dhe raportimin e kritereve të përgjegjësisë fiskale, duke bërë lidhjen e detyrave shtesë të SAI-t me monitorimet të reja për komisionet parlamentare..

Perspektiva integruese dhe detyrat e përgjegjësitë e SAI-t në këtë kontekst janë konsideruar me përparësi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Më poshtë vijon një Boks me 11 rekomandime që duhet të plotësojë një Institucion Suprem i Auditimit për integrimin në BE, të cilat kanë qenë në themel të të gjithë dokumenteve strategjike të KLSH për periudhën 2012-2016.

---

[2] *SIGMA Papers, "Vlerësimi i përgjegjësive fiskale, roli i SAI-t dhe i Parlamentit", Podgorice, 28 maj 2015, http://www.slideshare.net/SIGMA2013/assessing-fiscal-responsibility-criteria-and-contributing-to-fiscal-responsibility-agenda*

Boks 4

11 rekomandimet që duhet të plotësojë një Institucion Suprem i Auditimit për integrimin në BE

Rekomandimi 1
SAI duhet të ketë një bazë ligjore të plotë, të qëndrueshme dhe të zbatueshme që parashikohet në Kushtetutë dhe në ligj dhe të plotësuar me udhëzime, rregulla dhe procedura.

Rekomandimi 2

SAI duhet të ketë pavarësinë e duhur funksionale, organizative, vepruese dhe financiare, që të përmbushë në mënyrë objektive dhe efektive detyrat e tij.

Rekomandimi 3

SAI duhet të ketë fuqitë ligjore dhe mjetet, të shprehura qartë në Kushtetutë dhe në ligj, për të kontrolluar të gjitha burimet dhe veprimet publike, përfshirë burimet e BE, pavarësisht nëse ato janë përfshirë në buxhetin kombëtar dhe pavarësisht se kush i merr apo i administron këto burime dhe veprime publike.

Rekomandimi 4

SAI duhet të përfshijë sferën e plotë të auditimit të jashtëm të sektorit publik, që përfshin si auditimet e rregullshmërisë, përputhshmërisë, performancës dhe të teknologjisë së informacionit.

Rekomandimi 5

SAI duhet të jetë në gjendje të raportojë lirshëm dhe pa kufizim mbi rezultatet e punës së tij. Raportet duhet t'i paraqiten Parlamentit dhe të bëhen publike.

Rekomandimi 6

SAI duhet t'i përshtatet kushteve të vendit të vet dhe të pranojë zyrtarisht, të propagandojë dhe të përhapë standarde auditimi në përputhje me Standardet e Auditimit të INTOSAI, me Udhëzuesit Evropianë të Zbatimit të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-t dhe me çdo standard auditues të sektorit publik përkatës, nxjerrë nga IFAC dhe pranuar për zbatim nga BE. Standardet e auditimit duhet të zbatohen mbi një bazë të qëndrueshme dhe të besueshme të punës të SAI, për t'u siguruar që detyra e kontrollit ka kompetencën dhe cilësinë e duhur.

SAI duhet të përpilojë manualet e auditimit dhe udhëzimet e detajuara teknike, për të ndihmuar në përdorimin praktik dhe arritjen e këtyre standardeve.

Rekomandimi 7

SAI duhet të sigurohet që burimet e tij njerëzore dhe financiare janë përdorur në mënyrë plotësisht të efektshme, për të garantuar zbatimin efektiv të mandatit të tij. Për këtë, drejtuesit e SAI duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe masa të përshtatshme që garantojnë se SAI është organizuar me kompetence, për të kryer një aktivitet auditimi me efektivitet dhe cilësi të lartë.

Rekomandimi 8

SAI duhet ta shndërrojë organizimin e tij të brendshëm në një strukturë mbështetëse për drejtimin e mirë të punës, lidhur me kërkesat e periudhës së aderimit në BE.

Rekomandimi 9

SAI duhet të sigurohet që stafi i tij është kompetent, i aftë dhe i angazhuar për garantimin e një pune audituese efektive, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane.

Rekomandimi 10

SAI duhet të rrisë aftësinë profesionale dhe teknike të stafit të tij nëpërmjet arsimimit dhe trajnimit.

Rekomandimi 11

SAI duhet të përqendrohet në zhvillimin me një cilësi të lartë dhe efektivitet të sistemeve të auditimit të brendshëm tek subjektet e audituara.

Marrëdhëniet SAI-Parlament mund të jenë të lidhura me emërimin / shkarkimin e kreut të SAI-t, me shqyrtimin e raporteve të auditimit, me rishikimin e legjislacionit (veçanërisht në fushat e kontrollit financiar), me rishikimin e programit vjetor të auditimit të SAI-t dhe aktivitetet e tij, me kërkesat për auditime në fusha të caktuara, me miratimin e buxhetit të SAI-t, me shqyrtimin e faturave që lidhen me SAI-n, etj Marrëdhëniet mund të jenë drejtpërdrejt me Parlamentin, ose me komisionet parlamentare.

Komisionet parlamentare që kanë kontakte të rregullta me SAI-t

Nga studime të disa organizatave ndërkombëtare, si OECD, Banka Botërore, etj., SAI-t e vendeve kandidate dhe anëtarë të BE-së bashkëpunojnë me komisionet e mëposhtme parlamentare të llojeve të mëposhtme:

- Komisionet që janë në krye të degëve të ndryshme të administratës dhe ekonomisë, dmth komisionet që kanë kuadër të veçantë të përgjegjësisë, si komisionet në ekonomi, transport, bujqësi dhe në kujdesin shëndetësor (të quajtura komisione degë). Funksioni kryesor i këtyre komisioneve parlamentare është që të shqyrtojnë dhe të përgatisin çështjet që janë aktualisht objekt i debatit parlamentar dhe për të dhënë opinione për çështje, për të cilat ka referencë nga Parlamenti apo Kryetari i saj. Brenda kufijve të përcaktuar me Kushtetutë dhe me statut, komisionet gjithashtu punojnë edhe me struktura të shqyrtimit parlamentar në fusha të veçanta të aktiviteteve të qeverisë.

Komisionet përgjegjëse, eskluzivisht ose kryesisht për çështjet e auditimit shtetëror (të quajtur komisione të auditimit), mund të ndahen në dy lloje:

- Komisionet e Llogarive Publike, përgjegjëse kryesisht për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me llogaritë publike të parashikuara në Kushtetutë, ose që ju referohen atyre nga Parlamenti, një ministër apo Kreu i SAI-t (rasti i Qipros, Maltës).

- Komisione të auditimit shtetëror që në emër të Parlamentit shqyrtojnë veprimet e SAI-t. Ato japin opinione për programet vjetore të auditimit dhe për aktivitetet e SAI-t, vlerësojnë performancën e SAI-t në punën e përditshme, të shqyrtojë disa nga raportet e auditimit dhe përpiqen për të bashkërenduar marrëdhëniet e SAI-t me komisionet e tjera parlamentare. Ndonjëherë ata janë gjithashtu përgjegjëse për shqyrtimin e funksionimit të organeve të tjera të inspektimit dhe kontrollit në të gjithë vendin, si dhe për bashkëpunimin e këtyre organeve me SAI-n (Komiteti Shtetëror i Auditimit në Hungari, Komiteti i Kontrollit të Shtetit në Poloni). Një zgjidhje pjesore e ngjashme është krijimi i një nënkomisioni të auditimit brenda një

Komisioni Parlamentar për Buxhetin, me qëllim të trajtimit të çështjeve në lidhje me sistemin e auditimit, veçanërisht për aktivitetet dhe statusin e SAI-t(Republika Çeke).

Një ndërveprim aktiv mes SAI-t dhe komisioneve parlamentare është rasti i Polonisë. Në Takimin në mars 2011 të Grupit të Kontaktit të Kryetarëve të SAI-eve të Bashkimit Evropian[3] me përfaqësues të Parlamenteve kombëtare (si në foton që vijon), me temë:

"Roli i Parlamenteve kombëtare pas Traktatit të Lisbonës", Presidenti i asaj kohe i SAI-t polak NIK, z. Jacek Jezierski, theksoi nevojën e lidhjeve më të ngushta SAI-Parlament, për të përballuar pasojat e krizës botërore financiare dhe ekonomike, si dhe solli eksperiencën e NIK-ut në kontaktet dhe diskutimet me grupet parlamentare, të cilat sjellin përfitime të dyanshme. Ai u shpreh:" *Përfaqësuesit e NIK u paraqesin komisioneve parlamentare njohuritë dhe propozimet e tyre dhe në të njëjtën kohë njihen me mendimet dhe nevojat e deputetëve. Për më tepër, komisionet parlamentare i japin NIK informacion dhe orientim për fushat me interes parësor të Parlamentit për auditim*".

- Komisionet specifike, përgjegjëse kryesisht për çështjet që lidhen me buxhetin e SAI-ve: aprovimi i buxhetit te SAI-ve, emërimin e audituesve të jashtëm për të audituar SAI-n dhe shqyrtimin e llogarive të audituara (Komisioni i Llogarive i Zyrës së Auditimit Kombëtar në Maltë, një komision i ngjashëm në Rumani).

  Praktika tregon raste kur SAI-t mbajnë marrëdhënie të rregullta me një ose më shumë komisione parlamentare. Mund të dallojmë modelet si më poshtë:

[3] *Takimi i 23-të I Grupit të Kontaktit të Kryetarëve të SAI-eve të Bashkimit Evropian, Mars 2011, Luksemburg, file:///C:/Users/tosi/Downloads/2016_03_21_08_02_29.pdf*

- Bashkëpunimi me komisione të ndryshme të degëve (Kroacia, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania).
- Bashkëpunimi me komisione të ndryshme të degëve dhe me Komisionin e Auditimit të Shtetit (Hungari, Poloni).
- Bashkëpunimi me një, ose kryesisht me një, komision të degës - veçanërisht me Komisionin që merret me çështjet e financave publike (Shqipëri, Bullgari, Republika Sllovake, Slloveni).
- Bashkëpunimi me komisione të ndryshme të degëve dhe me Komitetin e Auditimit të Shtetit (Hungari, Poloni).
- Bashkëpunimi kryesisht me një komision publik të llogarive (Qipro, Malta) ose me një nënkomision të auditimit brenda një komisioni parlamentar për buxhetin (Republika Çeke).

Lidhjet Komisione Parlamentare-SAI i kanë trajtuar ekspertët Jacek Mazur, Ph.D., Këshilltar pranë Presidentit të Dhomës Supreme të Kontrollit (NIK) të Polonisë dhe Brian Vella, Asistent i Auditorit të Përgjithshëm të Maltës, në studimin e tyre të vitit 2003 " Marrëdhëniet ndërmjet SAI-ve dhe Komisioneve Parlamentare", në të cilin sugjerojnë: "*Duhet krijuar një njësi ose caktuar një person i veçantë për të koordinuar lidhjet e SAI-t me Komisionin përgjegjës Parlamentar, për të lehtësuar komunikimin dhe për të ndihmuar që të sigurohet ndërgjegjësimi i SAI-t ndaj nevojave dhe interesave parlamentare. SAI duhet t'i përcjellë Komisionit përgjegjës në Parlament gjetjet e mëparshme të auditimit dhe ta informojë atë për rastet e mosveprimit qeveritar ndaj rekomandimeve të SAI-t për probleme të rëndësishme të administrimit publik....SAI-t, ndërsa komunikojnë me Komisionet Parlamentare, duhet të evitojnë komentet mbi politikat qeveritare, por duhet të theksojnë se problemet që kanë evidentuar me zbatimin e këtyre politikave mund të ngrenë pikëpyetje lidhur me politikat në fjalë.*" [4]

---

[4] *Intosai Journal, Janar 2003, « Marrëdhëniet ndërmjet SAI-ve dhe Komisioneve Parlamentare - Përmbledhje», faqe 3, http://www.intosaijournal.org/technicalarticles/technicaljan03a.html*

Qasja Parlamenti Evropian-Gjykata Evropiane e Audituesve

Marrëdhëniet e Parlamentit Evropian me ECA-n janë një shembull i mire për t'u ndjekur nga shume SAI evropiane. Ato bazohen në një mirëkuptim të gjerë mes eurodeputeteve dhe drejtuesve të Gjykatës Evropiane të Audituesve për një gamë çështjesh themelore të menaxhimit të financave dhe të Buxhetit të Komisionit Evropian. Për këto marrëdhënie dhe problematikat e sotme të tyre, me një sinqeritet të thellë dhe profesionalizëm të lartë, ka folur një personalitet i spikatur i auditimit suprem dhe jetës politike evropiane, Eurodeputeti Dr. Igor Sholtes, Zv Kryetar i Komisionit për Kontrollin e Buxhetit të Parlamentit Evropian.

Në boksin e mëposhtëm është fjala e plotë e Dr. Sholtes 5, mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare "Roli i Auditimit të Jashtëm për Menaxhimin Efektiv te Sektorit Publik", me 19 nëntor 2015, Sofje, Bullgari

Foto nga dekorimi i Dr. Igor Sholtes nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani, maj 2013.

---

[5] Ky material u vu ne dispozicion te KLSH nga Zyra e Deputetit te Parlamentit Evropian Dr. Igor Sholtes, një personalitet i spikatur i auditimit suprem evropian, ekspert në fushën e prokurimeve publike, me kontribut te ndjeshëm për auditimin suprem slloven dhe jetën politike evropiane. Dr. Sholtes është edhe mik i Shqipërisë dhe i KLSH. Ai ka marrë vlerësimin më të lartë për një të huaj "Për Merita të Veçanta Civile" nga Presidenti i Republikës Bujar Nishani, Titullin "Qytetar Nderi" i Vlorës si dhe Titullin "Doktor Honoris Causa" nga Universiteti Publik "Aleksandër Xhuvani" i Elbasanit .

Boks 5

Fjala e Dr. Igor Sholtes

"Si Zëvendës-Kryetar i Komisionit të Parlamentit Evropian "Për Kontrollin e Buxhetit", unë i shpreh mirënjohjen time z. Cvetkov, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë, për ftesën e tij për të folur në këtë Konferencë të rëndësishme ndërkombëtare, kushtuar bashkëpunimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë me Parlamentin dhe organet e tjera të kontrollit në nivel kombëtar dhe evropian. I shtrij përgëzimet e mia të veçanta në këtë rast të rëndësishëm i cili është i dedikuar edhe 135-vjetorit të themelimit dhe 20 vjetorit të restaurimit të Institucionit Suprem të Auditimit të Bullgarisë.

Si ish-President i Gjykatës Sllovene të Auditimit, mund të më kuptoni se unë dua të përdor njohuritë dhe përvojën time në mënyrën më të mirë të mundshme dhe u bashkova me Komisionin e Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit Evropian.

Ajo që është më interesante për ne tani është që marrim të gjithë linjën e prodhimit të raporteve, rekomandimeve dhe raporteve të veçanta të Gjykatës Evropiane të Audituesve, të cilat formojnë informacionin më të madh prej të cilit ky Komision varet. Një pozicion mjaft unik për mua të shoh dhe të marr pjesë në ndjekjen politike të punës dhe rekomandimeve të audituesve që punojnë me zyrat qendrore në Luksembourg. Në kuadër të Komisionit, m'u dha përgjegjësia e veçantë për marrëdhëniet dhe rishikimin e punës së Gjykatës Evropiane të Audituesve.

Pak më shumë se një vit ka kaluar në punën time si relator i përhershëm në Komisionin "Për Kontrollin e Buxhetit" dhe gjatë kësaj kohe ka qenë e qartë se Evropa e shtrenjtë, keqmenaxhimi i fondeve evropiane, korrupsioni dhe mashtrimi financiar me paratë e taksapaguesve tanë janë ende shumë të pranishëm në axhendën tone të përditshme.

Ne të gjithë kemi rolin tonë për të luajtur. Si organe kontrolli e auditimi këtu së bashku, ne duhet ta bëjmë të qartë për publikun e gjerë të brendshëm dhe atë evropian që Zyrat e Auditimit Kombëtar në këtë Europë luajnë një rol thelbësor në luftën kundër çdo forme të keqpërdorimit të fondeve kombëtare dhe evropiane.

Ne kontrollojmë dhe auditojmë përputhshmërinë me rregullat. Ne përqendrohemi më shumë në performancën. Ne identifikojmë praktikat më të mira. Ne tregojmë se ku janë të nevojshme përmirësimet.

Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme. Të gjithë duhet të luajnë rolin e tyre. Dhe ata që janë përgjegjës duhet të bëhen shembull.

Më lejoni të ilustroj këtë pohim me një shembull konkret: Këshilli Evropian çuditërisht refuzon të bashkëpunojë me Komisionin e Kontrollit të Buxhetit. Ai nuk na jep informacion të mjaftueshëm , as dhe na jep dokumentet e shpenzimeve buxhetore që kërkojmë. Ata madje refuzojnë të diskutojnë shpenzimet e tyre me ne.

Si pasojë, gjatë viteve të fundit ne nuk kemi qenë në gjendje të japë vlerësimin e plotë për punën e Këshillit. Dhe Këshilli duhet të jetë perla e transparencës!

Ne duhet të nxisim më tej efektivitetin dhe efikasitetin, përgjegjësinë dhe transparencën e përdorimit të parave publike, e cila kontribuon drejt arritjes së prioriteteve nacionale dhe evropiane. Por duke pasur parasysh gjendjen e vështirë globale dhe kohët tejet të zgjatura të krizës financiare dhe ekonomike, të shoqëruara me gjendjen e vështirë të refugjatëve, është e sigurt se periudha para nesh është dhe do të jetë akoma dhe më e vështirë.

Prandaj është edhe më e rëndësishme që të përqendrohet në monitorimin e fushave me risqet më të larta. Sfida të tilla si kriza e zgjatur e refugjatëve, partneritete të ndryshme trans-kontinentale, nivel që qëndron i papunësisë së brendshme dhe evropiane, mungesa e konkurrencës së mjedisit të biznesit, fonde të dhëna me qëllim që të kapërcehet hendeku aktual i investimeve në Bashkimin Evropian si Fondi Evropian për Investimet Strategjike (EFSI) duhet të adresohen me kujdes të madh. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vlerësimit të efikasitetit të Programeve të Bashkimit Evropian, objektivave dhe rezultateve te tyre dhe zbatimin e programeve të tilla.

Prandaj unë sinqerisht besoj se është e rëndësishme që zyrat kombëtare të auditimit të ruajnë pozitën e tyre të pavarur në të cilën ato mund të kryejnë detyrat e tyre dhe në këtë mënyrë të reagojnë në mënyrë efikase ndaj sfidave të lart-përmendura. Në këtë aspekt, më lejoni t'Ju kujtoj Rezolutën A / 66/209 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të vitit 2011 "Promovimi i efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit". Kjo Rezolutë e rëndësishme thotë se institucionet e auditimit supreme mund të kryejnë misionin e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, vetëm nëse ato mbeten të pavarura nga subjekti i audituar dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme.

Të nderuar të ftuar,

Në këtë periudhë të vështirë e sfiduese, është më e rëndësishme se kurrë që të ruajmë dhe të forcojmë bashkëpunimin ndërmjet Gjykatës Evropiane të Audituesve, Zyrave kombëtare të auditimit dhe Parlamentit Evropian, duke shkëmbyer pikëpamjet dhe përvojën e fituar gjatë viteve. Shkëmbimi i praktikave më të mira në ngjarjet siç është Konferenca e sotme, është në dobi të të gjithëve dhe kontribuon për një zhvillim të shëndoshë ekonomik.

Ne jetojmë në kohën kur zyrave te auditimit suprem dhe institucioneve të tjera relevante mbikëqyrëse u kërkohet që të rrisin sasinë dhe cilësinë e rezultateve e tyre, ndërsa burimet që kanë bëhen gjithnjë e më të pakta. Prandaj është me rëndësi të madhe që këto institucione të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike. Më lejoni të theksoj se bashkëpunimi efektiv ndërmjet Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të Parlamentit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve kontribuon në mënyrë të qartë për arritjen e këtyre objektivave. Raportet, raporte të veçanta dhe dokumente të tjera të rëndësishme të ECA-s janë duke u diskutuar dhe monitoruar në detaje, ato janë gjithmonë të rëndësishme dhe të dorëzuara në kohë. Jam i bindur se një mënyra e tillë bashkëpunimi duhet të perceptohet si një shembull i ndritshëm në kohë të vështira e me shumë sfida".

Komisionet parlamentare që kanë kontakte të rregullta me SAI-n janë krijuar në bazë të parimeve të përgjithshme, të ngjashme me ato që rregullojnë krijimin e komisioneve të tjera në këmbë. Ata janë të përbërë vetëm nga anëtarë të Parlamentit (deputetët). Personat e tjerë mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit, në qoftë se janë të ftuar ose u kërkohet nga Komisioni. Deputetët të cilët nuk janë anëtarë të Komisionit mund të marrin pjesë lirisht në një takim të tij, por nuk kanë të drejtë vote.

Numri i anëtarëve të Komisionit mund të jetë fiks (në Urdhëresat e Përhershme të Parlamentit ose në një rezolutë të veçantë), ose mund të dalë nga rezoluta për zgjedhjen e tyre. Në praktikë, numri i anëtarëve të komisionit parlamentar, në komisionet e ndryshme të vendeve të ndryshme varion midis 7 dhe 40 deputetësh, duke përfshirë një kryetar, si dhe një ose më shumë nënkryetarë.

Përbërja e komisioneve parlamentare rezulton nga procedurat e konsultimit të kryera në mes të grupeve parlamentare dhe është zakonisht e bazuar mbi parimin e përfaqësimit proporcional. Emërimi i kryetarit dhe zëvendës-kryetarit është zakonisht një çështje e marrëveshjes politike. Në praktikë, grupimet parlamentare janë gjithashtu përgjegjës për emërimin e anëtarëve të tjerë të Komisionit, edhe pse kjo duhet të miratohet me anë të një rezolute parlamentare. Si rezultat i kësaj, përbërja e komisioneve shpesh reflekton strukturën politike të parlamentit me shumicën e anëtarëve të komisionit shpesh përfaqësues të partisë që qeveris ose të koalicionit qeverisës.

Roli i Parlamentit dhe komisioneve parlamentare është më shpesh i një natyre politike. Megjithatë, ka edhe funksione që nuk janë, apo nuk duhet të jenë, me karakter politik, të tilla si në rastin kur diskutohen çështjet e lidhura me SAI-n. Faktorët në vijim mund të ndihmojnë në sigurimin e mos-politizimit të takimeve të Komisionit për çështjet lidhur me SAI-n :

a) organizimi i punës së Komisionit në bazë të Urdhëresës së përhershme të Parlamentit;

b) pjesëmarrja në takimet e Komisionit të zyrtarëve përgjegjës për çështjet që diskutohen dhe të ekspertëve të tjerë;

c) pjesëmarrja në Komision të anëtarëve nga të gjitha partitë politike dhe e drejta e të gjithë anëtarëve të dëgjohen;

d) betimi që secili deputet bën, i cili parashikon respektimin e Kushtetutës dhe çdo ligji tjetër;

e) në disa vende, deputetët të përpiqen të shmangin politizimin në seancat e Komisionit kur diskutohen çështjet e auditimit publik suprem;

f) në rastet kur Komisioni është vetëm ose kryesisht i ngarkuar me çështjet e auditimit shtetëror, pozita e Kryetarit është mbajtur ndonjëherë dhe nga një përfaqësues i një partie të opozitës (Polonia, Republika Çeke, Malta), ose një përfaqësues i një partie opozitare mban pozicionin e një zëvendës-Kryetari.

Ka raste kur puna e SAI-t, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Parlamentar përgjegjës, çon në rezultate shumë të mira, madje në kursim të parasë publike në një masë të konsiderueshme. Në faqen në internet të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe, cilësohet se *"Puna jonë, së bashku me atë të Komisionit të Llogarive Publike, ka çuar në kursime dhe fitime të tjera të efiçiencës me vlerë gati 1.21 miliardë paund në vitin 2015"*[6] .

Në forcimin e bashkëpunimit Komision Parlamentar-SAI, me interes mund të jetë dhe komunikimi mes SAI-t dhe Komisionit përgjegjës Parlamentar jashtë mjediseve të Parlamentit. ECA, Gjykata Evropiane e Audituesve ka një tradite të mirë në ketë drejtim. Çdo vit, ne mjediset e ECA-s në Luksemburg, zhvillohet takimi mes Komisionit të Parlamentit Evropian për Kontrollin Buxhetor dhe përfaqësuesve më të lartë të ECA-s, ku ECA paraqet për diskutim programin e saj vjetor të punës. Gjate vitit 2015, ky takim ndodhi me 13 tetor ne Luksemburg. Takimi gjithnjë kryhet një muaj përpara se sa ECA të paraqesë ne Parlamentin Evropian Raportin e saj mbi Zbatimin e Buxhetit te BE-se për vitin e mëparshëm. Ai paraprihet nga një vizite pune e anëtarëve te Komisionet ne mjediset e ECA-s, te shoqëruar nga Presidenti i ECA-s. Gjate takimit te vitit 2015, mes Komisionit te Parlamentit Evropian për Kontrollin Buxhetor dhe ECA-s u diskutuan prioritetet vjetore të Parlamentit Evropian, u shkëmbyen informacione dhe u fol gjerësisht për tema të tjera të rëndësishme, si p.sh. Fondi Evropian për Investimeve Strategjike dhe mandati i auditimit të ECA-së, raportet vjetore dhe të veçanta të ECA-së, ristrukturimi i ECA-s si një organizatë model me bazë detyrat e caktuara nga Parlamenti, etj.

---

[6] *Faqja në internet e Zyrës Kombëtare të Auditim it të Britanisë se Madhe, dritarja « Puna Jone-Our Work »* https://www.nao.org.uk/about-us/role-2/our-work/

Ky takim i përvitshëm shërben edhe për njohjen më të mire reciproke mes anëtarëve të Komisionit Parlamentar dhe drejtuesve të SAI-t. Anëtarët e Komisionit njihen dhe shikojne nga afer punen e audituesve te ECA-s, marrin drejtpersedrejti opinionet e tyre, etj.[7].

Foto nga takimi ECA-Komisioni Parlamentar për Kontrollin Buxhetor, Luksemburg, 13 tetor 2015

Frekuenca me të cilën komisionet parlamentare takohen për të diskutuar çështjet e SAI-t

Në shumicën e vendeve nuk ka traditë të takimeve të shpeshta dhe periodike ndërmjet SAI-ve dhe komisioneve parlamentare. Takime të tilla ndodhin në parlamentet ku ekzistojnë komitetet që merren vetëm ose kryesisht me çështjet e kontrollit dhe auditimit të Shtetit (Hungari, Qipro, Maltë), ose ku ekziston një traditë e konsoliduar e shqyrtimit të raporteve të auditimit nga shumica e komisioneve parlamentare (Poloni). Numri vjetor i takimeve të Komisionit të organizuara për të diskutuar çështjet që lidhen me SAI-n varion nga një deri në tre në Shqipëri, Bullgari, Letoni dhe Lituani; në disa takime (deri në 10) në Kroaci, Republikën Çeke, Estoni, Rumani, Republikën Sllovake dhe Sllloveni; në rreth 20 në Hungari dhe Maltë; deri në

[7] *Njoftimi ne faqen ne internet te ECA-s mbi takimin vjetor ECA-Komisioni Parlamentar per Kontrollin Buxhetor te dates 13 tetor 2016, http://www.eca.europa.eu/en/Pages/NewsItem.aspx?nid=6083*

rreth 75 takimeve të tilla të mbajtura në Poloni dhe Qipro. Ndodh rrallë herë që të gjitha takimet të jenë të përkushtuara për çështjet që kanë të bëjnë vetëm me SAI-n. Më shpesh ato çështje përbëjnë vetëm një artikull në rendin e ditës. Kohëzgjatja e mbledhjes së Komisionit varet kryesisht nga sasia dhe serioziteti i temave në diskutim.

Nuk ka ndonjë procedurë të veçantë specifike në ndonjë nga parlamentet (e vrojtuara deri tani nga studime të disa organizatave ndërkombëtare, si OECD, Banka Botërore, etj.), e cila të adoptohet vetëm për t'u marrë me çështjet që kanë të bëjnë me SAI-n. Raportet e auditimit shqyrtohen në bazë të procedurave të ngjashme që zbatohen për dokumentet e tjera të paraqitura nga qeveria ose autoritetet e tjera shtetërore. Zakonisht, dispozitat e ligjit nuk kërkojnë që raporte të tilla të shqyrtohen nga Parlamenti, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me ekzekutimin e auditimit të Buxhetit të Shtetit. Në rrethana të tilla, vetëm disa nga raportet e auditimit shqyrtohen në mbledhjet e komisioneve parlamentare.

Rastet kur vendimet e komisioneve parlamentare konsiderohen si të vlefshme

Vendimet e komisioneve parlamentare janë të vlefshme nëse shumica e anëtarëve të Komisionit janë të pranishëm (Shqipëria, Kroacia, Qipro, Hungaria, Lituania, Malta, Republika Sllovake), por ndonjëherë prania e vetëm një të tretës të anëtarëve të Komisionit përbën kuorumin për vendim-marrje(Polonia, Republika Çeke, Estonia). Për vendimet që do të merren nga Komisioni, shumica e thjeshtë e votave të anëtarëve të pranishëm është e nevojshme (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovenia). Në një rast (Letoni), shumica e cilësuar e anëtarëve të pranishëm është e nevojshme dhe në një rast tjetër (Republika Sllovake), shumica absolute e të gjithë anëtarëve, jo vetëm të pranishmit, është e nevojshme.

Kërkesa ose ftesa ndaj Kryetarit të SAI-t për të marrë pjesë në Komisionin Parlamentar

Kryetarët dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Institucioneve Supreme të Auditimit zakonisht marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e komisioneve parlamentare që shqyrtojnë dokumenta të paraqitura nga SAI (sidomos kur janë duke u shqyrtuar raportet e auditimit). Në shumicën e vendeve, është e zakonshme që Kreu i SAI-t të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit. Në rastet kur e ka të pamundur, ai mund të dërgojë zëvendësin ose një përfaqësues tjetër të lartë të SAI-t. Pozicioni i

përfaqësuesit të SAI-t është normalisht i një niveli të lartë dhe varet nga natyra e çështjes (seriozitetit ose ndjeshmërisë së çështjes ose auditimit në diskutim).

Çështja e së drejtës, apo detyrës për të marrë pjesë në mbledhje rrallë specifikohet në mënyrë të qartë dhe varet nga praktika e përditshme. Më shpesh, Komisioni parlamentar fton Kreun e SAI-t për të marrë pjesë në një takim. Prezumohet që ai / ajo, ose një përfaqësues, mund të marrë pjesë në një takim të tillë, i shoqëruar nga punonjës të tjerë të SAI-t që Kryetari i konsideron të përshtatshëm. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh perspektivën ligjore, pjesëmarrja e Kreut të SAI-t apo përfaqësuesit të tij nuk është e detyrueshme. Megjithatë, kreu i SAI-t apo përfaqësuesi i tij pritet në përgjithësi të marrë pjesë në takime të tilla dhe kjo është në interes të vetë SAI-t.

Drejtuesi i SAI-t mund të ftohet edhe për të ditur opinionin e tij/saj për mbarëvajtjen e programeve apo agjencive qeveritare me interes te veçante. Sidomos ftesa te tilla kanë ndodhur për Drejtuesit e SAI-ve gjatë shpërthimit dhe acarimit të krizës botërore ekonomike 2008-2012.

Vetëm në disa vende, pjesëmarrja e SAI-t në mbledhje të Komisionit konsiderohet e detyrueshme (Shqipëria, Lituania, Polonia), ose e detyrueshme nëse kërkohet nga Komisioni (Republika Çeke).

Në praktikë, në shumë nga vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, komisionet parlamentare nuk shqyrtojnë dokumentet e paraqitura nga SAI-t në baza të rregullta. Prandaj, përfaqësuesit e SAI-ve shpesh nuk marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve. Takimet e Komisionit lidhur me SAI-n, në disa vende, janë të kufizuara në shqyrtimin e raportit vjetor për aktivitetet e auditimit dhe raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit. Takimet më të shpeshta ndodhin në parlamentet ku ekzistojnë komisione që merren vetëm ose kryesisht me çështjet e kontrollit të Shtetit (Hungari, Qipro, Maltë), ose aty ku ekziston një traditë e konsoliduar e shqyrtimit të raporteve të auditimit nga shumica e komisioneve(Poloni). Situata në Poloni është e ndryshme, ngaqë SAI polak (NIK) njoftohet për të gjitha takimet e Komisionit. Megjithatë, është tema e një takimi, rëndësia e çështjes që trajtohet ajo që përcakton nëse një përfaqësues i SAI-t ka të drejtë apo detyrë të jetë në mbledhje. Presidenti i NIK (ose një përfaqësues i autorizuar i tij) është i detyruar të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit që lidhen me NIK. Për çështje të tjera, NIK merr një ftesë për takimin (në praktikë, përfaqësuesit e NIK marrin pjesë në rreth 60-70% të të gjitha takimeve të Komisionit).

Persona të tjerë që normalisht ndjekin mbledhjet e Komisionit lidhur me SAI-n

Sipas studimeve nga OECD dhe BB, në pothuajse të gjitha vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, përfaqësues të lartë të ministrive përkatëse, duke përfshirë edhe Ministrinë e Financave, marrin pjesë në shumicën e takimeve të Komisionit lidhur me SAI-n. Me kërkesë të Komisionit, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore shtetërore janë të detyruar të dorëzojnë pranë tij raporte dhe të japin informacion. Ata (ose përfaqësues të autorizuar të tyre) janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit që do të shqyrtojnë çështjet në fushën e tyre të veprimit. Në praktikë, për pjesën më të madhe të rasteve, ata janë të përfaqësuar nga zëvendësit e tyre. Në përputhje me ligjin e funksionimit të Parlamentit, Komisioni ka të drejtë të kërkojë informacion me gojë ose me shkrim në lidhje me detyrat e tyre dhe kjo jo domosdoshmërisht është një kërkesë që ata të marrin pjesë në takim(në rastin e informacioneve me shkrim). Kur marrin pjesë, Komisioni kërkon që çfarë do të thonë të jetë e vërtetë, si dhe të mos refuzojnë ose fshehin ndonjë material apo informacion që Komisioni e konsideron të dobishëm mbi çështjet që shqyrton. Ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore shtetërore u kërkohen nga Komisioni që të diskutojnë raportet e auditimit dhe t'u përgjigjen pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit (për këtë ata mund të sjellin me vete edhe ekspertë në takim, ose të përfaqësohen nga zëvendësit e tyre apo nga përfaqësuesit e autorizuar). Prania e këtyre zyrtarëve të qeverisë (të ftuar ose të kërkuar që të paraqiten) është e detyrueshme, edhe pse mospjesëmarrja nuk është "e dënueshme" (mediat mund të tërheqin vëmendjen e publikut për mungesën e tyre dhe nganjëherë zyrtarë të tillë mund të mbahen politikisht përgjegjës përpara Parlamentit).

Përveç kësaj, në takimet në lidhje me SAI-n, Komisioni parlamentar mund të ftojë persona të tjerë, të tillë si përfaqësues të organizatave profesionale, sociale apo edhe politike, për të siguruar informacionin e kërkuar ose shpjegime. Komisioni gjithashtu ka të drejtë të ftojë ekspertë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, të cilët mund të veprojnë në cilësinë e këshilltarëve të Komisionit. Ekspertët joqeveritarë, të cilët janë ftuar, pritet që të marrin pjesë vullnetarisht në një takim të Komisionit.

Stafi mbështetës i komisioneve parlamentare

Çdo Komision parlamentar zakonisht ka një person (rrallë dy ose tre) në krye të detyrave administrative (për çështjet organizative, koordinimin dhe detyrat administrative). Kur një Komision ka nevojë për ekspertizë profesionale, ai ka tre

zgjidhje tipike. Në disa vende, anëtarë të stafit mbështetës kryejnë si detyrat administrative dhe ato këshillëdhënëse (Shqipëri, Estoni, Qipro; në vende të tjera, Komisionet kanë këshilltarët e tyre të përhershëm (Bullgari, Hungari, Letonia, Lituani, Shqipëri); ose mund të kërkojnë ndihmë nga këshillues të specializuar pranë Sekretariatit Parlamentar (Shqipëria, Kroacia, Polonia). Përveç kësaj, Komisioni mund të punësojë ekspertë të jashtëm.

Mbulimi mediatik i takimeve të komisioneve parlamentare mbi SAI-n

Nga pikëpamja formale, në parlamentet e vendeve anëtare dhe kandidate të BE-së, ka dy situata në lidhje me pjesëmarrjen e medias dhe palëve të interesuara në takimet e Komisionit.

- Takimet janë publike dhe për këtë arsye mediat dhe palët e interesuara mund të marrin pjesë, përveç në raste të rralla, kur takimet mund të jenë të mbyllura për arsye shumë specifike(Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Hungaria, Letonia, Malta, Rumania, Republika Sllovake, Sllovenia).

- Takimet e Komisionit nuk janë publike, por përfaqësues të mediave dhe palëve të tjera të interesuara mund të marrin lirisht leje për të marrë pjesë në këto takime (Shqipëria, Estonia, Lituania, Polonia).

Në praktikë, mediat dhe publiku i gjerë zakonisht mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit, pavarësisht nëse ato janë publike ose jo. Një shërbim i përshtatshëm parlamentar (zakonisht Sekretariati i Parlamentit apo punonjësi për marrëdhëniet me publikun) krijon kushtet e duhura në mënyrë që të mundësojë pjesëmarrjen e mediave dhe palëve të interesuara, më një njoftim publik ku informon për datën e mbledhjes dhe rendin e saj të ditës.

Kjo në teori, sepse në realitet një mundësi e tillë nuk shfrytëzohet shpesh. Në shumicën e vendeve, media dhe palët e interesuara rrallë marrin pjesë në takime të tilla (mediat janë gjithmonë të pranishme në Qipro dhe Maltë, shumë shpesh në Poloni). Në disa vende, shërbimi parlamentar bën përpjekje për të informuar publikun në lidhje me rrjedhën e takimeve për SAI-n, kryesisht duke publikuar një buletin që përshkruan dhe detajon çdo takim të tillë (Letoni, Lituani, Poloni).

Mbulimi mediatik përfshin shërbimet televizive dhe radio, reportazhe dhe artikuj në gazeta dhe revista, si dhe gjithashtu mbulim në internet. Shkalla e mbulimit mediatik të takimeve të Komisionit për SAI-n varet nga rëndësia e temave për publikun e gjerë. Gazetarët rrallë marrin pjesë në takime të tilla dhe artikujt e tyre janë të shkurtër. Takimet që merren me çështje të interesit material publik mbulohen më nga afër dhe pjesëmarrësit në takime të tilla të Komisionit ndonjëherë janë intervistuar, ndërsa informacioni thelbësor është transmetuar rregullisht nga agjencitë e lajmeve. Nga studimet e OECD dhe BB, vetëm për disa vende shkalla e mbulimit mediatik të takimeve konsiderohet si e përshtatshme (Slloveni, Qipro)[8].

Gjatë viteve 2005-2015, kanë zhvilluar raportet me mediat në një nivel të mirë SAI si NAO (Zyra Kombëtare e Auditimit) e Britanisë së Madhe, NIK-u polak, Gjykata e Auditimit e Hollandës, Institucioni Shtetëror i Auditimit i Kroacisë, etj. Rreth 65 përqind e SAI-ve të Evropës tashmë janë të pranishëm dhe në mediat sociale (FaceBook, Twitter, Instagram, etj.) dhe i përcjellin rregullisht në këto media takimet e tyre me Komisionet Parlamentare.

Sidomos e pranishme në mediat, në rradhë të parë ato televizive është veprimtaria e NAO-s britanike dhe dëgjesat e Komisionit te Llogarive Publike te Parlamentit Anglez. Programi i dëgjesave të Komisionit shfaqet paraprakisht në lajmërimet e televizionit të përkushtuar për aktivitetet parlamentare http://www.parliamentlive.tv/ .

Një nga aktivitetet më të ndjekura në mediat britanike, në gazetat dhe televizionet kryesore të saj ka qenë raporti i NAO-s Britanike dhe dëgjesat e Komisionit të Llogarive Publike mbi pagesat e fryra ndaj drejtuesve të BBC-së, Televizionit gjigand shtetëror anglez, gjatë viteve 2005-2013, sikurse e dështon dhe boksi i mëposhtëm:

Boks 6

The Telegraph

BBC gave inflated pay-offs to top staff, NAO says

BBC pay-offs to senior staff have breached its own guidelines by being over-generous and have “put public trust at risk”, according to the public spending watchdog.

[8] *Konkluzionet e studimeve varen edhe nga koha kur ato janë kryer (vitet 2002-2004). Situata me mbulimin mediatik të takimeve të Komisioneve parlamentare për SAI-n ndërkohë është përmirësuar në mjaft vende të BE-së. Nuk ka studime të mirëfillta për këtë, por si KLSH jemi përpjekur të krahasojmë dhe nxjerrim disa konkluzione paraprake nga mbulimi në mediat sociale dhe faqet në internet të SAI-ve evropiane*

Pasi u publikua raporti i pare i SAI-t britanik, NAO, mbi gjendjen financiare dhe pagesat e stafit të BBC-së, me kërkesë te Komisionit dhe te Fondit Publik te Mirëbesimit të BBC-se, NAO zhvilloi një auditim shtese mbi 150 pagesat e drejtuesve me te larte te televizionit publik gjate 8 viteve 2005-2013. Nga raporti i auditimit i publikuar ne korrik 2013, rezultoi një abuzim rreth 60 milionë sterlina dhe kjo shkaktoi një pështjellim në mediat dhe opinionin publik anglez, si dhe një furtune te vërtetë në menaxhimin e BBC-se[9]. Në katër vitet e fundit 2013-2016, një nga institucionet publike më të mëdha te vendit, BBC ka njohur përmirësim të ndjeshëm te menaxhimit te tij financiar dhe te përgjegjshmërisë në drejtim, pikërisht ne saje te gjetjeve, vërejtjeve dhe rekomandimeve te NAO-s, të kërkuara, theksuara dhe ndjekura për zbatim nga ana e Komisionit te Llogarive Publike te Parlamentit Britanik.

Produktet përfundimtare të një SAI janë raportet e auditimit, të cilat përfshijnë gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet e mundshme, aty ku ato janë të zbatueshme. Raportet e auditimit janë bërë për deklaratat e përgjithshme ose të veçanta financiare të qeverisjes, për pasqyrat financiare të korporatave qeveritare, kompanive apo subjekteve të tjera publike, për vlerën e shërbimit të realizuar kundrejt parasë së harxhuar (auditimet e performancës), këshilla për hartimin e legjislacionit, si dhe raporte të tjera mbi fusha dhe çështje brenda mandatit të auditimit të një SAI. Lloji më i zakonshëm i raporteve të përgatitura nga SAI-t janë auditimet financiare dhe të përputhshmërisë, si dhe auditimet e performancës. Auditimet e performancës kanë marrë shumë rëndësi nga SAI-t në vitet e fundit. SAI-t japin llogari për veprimtarinë e tyre në raportet e tyre vjetore.

Produktet e SAI-t në Parlament

Disa SAI nxjerrin një raport individual për çdo gjetje materiale të auditimit. SAI të tjerë nxjerrin një raport auditimi për disa gjetje të auditimit në të njëjtën kohë. Krahasimet nuk mund të bëhen në lidhje me këto produkte të auditimit dhe sa prej tyre i kalojnë Parlamentit për shqyrtim, pasi jo vetëm tematikat ndryshojnë gjerësisht, por edhe vëllimi i punës gjithashtu varet nga madhësia e SAI-t në fjalë. Po

[9] https://www.nao.org.uk/report/severance-payments-wider-benefits-senior-bbc-managers-supplementary-note/
http://www.telegraph.co.uk/culture/tvandradio/bbc/10152981/BBC-gave-inflated-pay-offs-to-top-staff-NAO-says.html

ashtu, numri i audituesve në SAI të ndryshme (duke përfshirë edhe zyrat rajonale) ndryshon në mënyrë të konsiderueshme: nga nën 100 auditues (p.sh. Qipro, Estonia, Malta) në disa qindra auditues (p.sh Republika Çeke, Hungaria), ose dhe me mijëra (Polonia, Rumania, Turqia). Numri i punonjësve të SAI-t varet si nga madhësia e vendit në fjalë, ashtu dhe nga qëllimi i funksionimit të SAI-t, kompetencat kushtetuese dhe të përcaktuara me ligj të veçantë.

Krahas raporteve tradicionale të auditimit që shkojnë ne Parlament, ka SAI që zgjedhin të përgatisin dhe t'i paraqesin parlamentit edhe raporte speciale. Për shembull, Gjykata Evropiane e Audituesve, krahas raporteve vjetore te zbatimit te Buxhetit te BE-se dhe te performancës se ECA-s, përgatit çdo vit rreth 50 raporte specifike vjetore për agjencitë e ndryshme te BE-se, programet e përbashkëta, etj. ECA përgatit po ashtu rreth 20 raporte speciale çdo vit, kushtuar fushave te ndryshme te aktivitetit te BE-se, ku alokohen fondet e Buxhetit te BE-se, si dhe rreth 10 opinione mbi propozimet për ndryshime dhe përmirësime te legjislacionit evropian. Produkti me i ri i ECA-s janë Rishikimet Tematike (Landscape Reviews). Ato konsiderojnë tematika te gjera, bazuar ne eksperiencën dhe kërkimin shkencor te institucionit suprem te auditimit te Bashkimit Evropian[10].

Një nga raportet speciale te ECA-s qe ka ngjallur interes te veçante kohet e fundit, është Raporti Special Nr. 17/2016, i publikuar me 13 korrik 2016 "Institucionet e BE-se mund të bëjnë me tepër për të lehtësuar aksesin ne prokurimet e tyre publike". Në këtë raport, theksohet se" *Institucionet e BE-së duhet të bëjnë më shumë për të ndihmuar bizneset të gjejnë kontratat që ofrohen dhe ofertën për ta. I duhet dhënë fund shiritit të kuq që përjashton sidomos bizneset e vogla dhe te mesme në prokurimin publik të BE-së, si dhe nevojitet një platformë të re online me kontratat nga të gjitha institucionet... Kur institucionet e BE-së rishikuan rregullat e prokurimit publik në vitin 2015, ato nuk e realizuan qasjen duke thjeshtuar procedurat dhe sqaruar sa më shumë të jetë e mundur zonat gri në procedurat e prokurimit publik në BE*"[11].

---

[10] *Faqja ne internet e ECA-s : Raportet, opinionet dhe publikimet e ECA-s.*
http://www.eca.europa.eu/en/Pages/AuditReportsOpinions.aspx

[11] *Raporti Special Nr. 17/2016. 13 korrik 2016.*
http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/INSR16_17/INSR_PROCUREMENT_EN.pdf

Në bazë të Kushtetutës ose ligjit bazë të tyre, SAI-t janë të detyruar të dorëzojnë raportet kryesore të auditimit në Parlament, në veçanti një raport vjetor për aktivitetet e tyre, një raport të auditimit për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raporte mbi auditimet e kërkuara nga Parlamenti (kur është e aplikueshme). Në disa raste, ata japin opinion mbi llogaritë publike, një raport mbi përdorimin dhe ruajtjen e pasurive shtetërore dhe një raport mbi borxhin publik. Në Republikën Çeke, SAI është i detyruar të paraqesë të gjitha raportet e auditimit në Parlament.

Jo të gjitha raportet e auditimit të SAI-t që shkojnë në Parlament shqyrtohen nga komisionet parlamentare. Kryesisht, komisionet parlamentare rishikojnë rregullisht ato raporte të auditimit, shqyrtimi i të cilave nga Parlamenti është i detyrueshëm. Për më tepër, komisionet parlamentare shqyrtojnë me shumë vëmendje raportet e auditimit të kërkuara (aty ku me ligj është e aplikueshme) ose sugjeruara nga ana e tyre.

Në shumicën e vendeve, komisionet parlamentare zakonisht nuk shqyrtojnë më shumë se gjysmën e raporteve të auditimit të pranuara nga Parlamenti. Ka disa situata në lidhje me këtë:

- Komisionet parlamentare marrin një numër të konsiderueshëm të raporteve të auditimit çdo vit (p.sh. rreth 40, 60 apo 200), dhe shqyrtojnë tërësisht shumicën e tyre gjatë disa takimeve gjatë gjithë vitit (Polonia, Hungaria, Qipro);

- Në disa vende të BE-së, një shumicë e konsiderueshme e gjetjeve të auditimit është përfshirë në raportin vjetor dhe / ose në raportin e auditimit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit. Këto shqyrtohen nga komisionet parlamentare gjatë një, dy ose tre takimeve (Shqipëria, Bullgaria, Rumania)

- Komisionet parlamentare ndonjëherë, gjatë disa takimeve, mund të shqyrtojnë një numër të madh të raporteve të auditimit (p.sh. rreth 70, 120 ose 900), shumica e të cilave janë të karakterit të detajuar (p.sh. në lidhje me auditimet e pasqyrave financiare dhe të transaksioneve financiare të qeverisjes lokale dhe

njësive të tjera të qeverisjes). Në raste të tilla, disa prej tyre janë shqyrtuar përgjithësisht në thellësi (Kroacia, Lituania, Sllovenia).

Shqyrtimi i raporteve të auditimit të SAI-t nga komisionet parlamentare

Qëllimi i shqyrtimit të raporteve të auditimit nga Komisioni Parlamentar është për të marrë parasysh vëzhgimet e SAI-t, gjetjet dhe rekomandimet e tij, si dhe për të paraqitur pikëpamjet e Komisionit dhe rekomandimet për të ndihmuar Parlamentin dhe organizatat e audituara të marrin vendimet dhe të ndërmarrin veprimet e duhura. Në këtë mënyrë, presioni zbatohet mbi qeverinë dhe subjektin e audituar për të marrë në kohë masat e propozuara nga SAI, të nevojshme për të ndrequr të metat. Përmes një sistemi të tillë të rishikimit dhe shqyrtimit rritet përgjegjësia e subjekteve të audituara në administrimin e burimeve dhe fondeve publike.

Komisioni i përhershëm i Financave Publike (PAC) në Kanada ka një praktike te mire të mënyrës se shqyrtimit të raporteve të Zyrës se Auditorit të Përgjithshëm te Kanadasë. Në prezantimin e Fondacionit Gjithëpërfshirës të Auditimit Kanadez, më 31 janar 2012, "PAC dhe SAI: partnere në procesin e mbajtjes se administratës publike të përgjegjshme", eksperienca e Komisionit kanadez jepej ne pese drejtime të punës se tij me SAI-n, dhe pikërisht "*1. Përgatitja e pyetjeve efektive gjate seancave dëgjimore të Komisionit te Financave Publike (PAC); 2. Angazhimi i PAC ne mbajtjen e qeverisë të përgjegjshme për kryerjen e veprimeve korrigjuese sipas rekomandimeve të SAI-t; 3. Planifikimi i punës dhe Prioritetet në raportet me SAI-n; 4. Performanca, Ndikimi dhe Komunikimi duke punuar me SAI-n, si dhe 5. Trajnimi për stafin mbështetës të PAC në raportet me SAI-n.*"[12]

Në të gjitha vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, komisionet parlamentare konsiderojnë, vlerësojnë dhe analizojnë raportet e auditimit (ose të paktën i njohin ato pa diskutim). Në pothuajse të gjitha rastet e shqyrtimit, procedura është e njëjtë me atë të dokumenteve të tjera që janë konsideruar dhe diskutuar gjatë takimeve të komisioneve parlamentare. Si një normë, raportet e auditimit dorëzohen para

---

[12] *Yves Gauthier, Prezantim i Fondacionit Gjithëpërfshirës te Auditimit Kanadez, 31 janar 2012, "PAC dhe SAI: partnere në procesin e mbajtjes së administratës publike të përgjegjshme", http://www.parlamericas.org/uploads/documents/Yves%20Gauthier's%20presentation.pdf*

mbledhjes së Komisionit, në mënyrë që anëtarët e tij të mund të njihen me raportin e auditimit në fjalë. Ndonjëherë Komisioni kërkon informacion dhe dokumentacion shtesë përpara mbledhjes.

Pas shqyrtimit të auditimit të raporteve të caktuara, disa komisione përgatisin raportet me pikëpamjet e tyre, komentet dhe rekomandimet në Parlament (Kroacia, Rumania, ndonjëherë Qipro), ose formulojnë një projekt-rezolutë për Parlamentin (Letonia). Në këto raste, Komisioni duhet të raportojë mbi mendimet e pakicës së anëtarëve të tij, nëse këmbëngul pakica. Në Hungari, Komisioni merr një vendim formal të miratimit ose refuzimit të një raporti të SAI-t, dhe ky vendim përmendet në Parlament. Komisionet në vende të tjera shqyrtojnë raportet e auditimit, por nuk marrin ndonjë vendim / rezolutë formale, pasi vendime të tilla nënkuptohet që do të merren nga Parlamenti në seancat plenare (Shqipëria, Bullgaria, Estonia, Lituania, Malta dhe Sllovenia). Ne disa vende, transkriptet e seancave të Komisionit me SAI-n i jepen si një kopje vetë SAI-t dhe ekstrakte të tyre u jepen edhe subjekteve të audituara, për të cilat është diskutuar në seancë. Në vendin tonë, Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat i hedh në faqen në internet të Parlamentit transkriptet e çdo mbledhjeje të Komisionit me KLSH. Transkripti quhet "Proces-Verbal i Mbledhjes" [13] dhe përmban te gjitha diskutimet e deputeteve të Komisionit, pyetjet e tyre dhe përgjigjet e KLSH.

Ka komisione parlamentare që marrin parasysh raportet e auditimit, por nuk i diskutojnë formalisht ato (Republika Sllovake). Në Republikën Çeke, është nënkomisioni i buxhetit, i cili diskuton raportet e SAI-t dhe propozon një projekt-rezolutë. Komisioni zakonisht vepron mbi sugjerimet e nënkomisionit dhe paraqet projekt-rezolutën në Parlament. Në raste të tjera, vendimet merren vetëm në raportin vjetor të aktiviteteve të SAI-t, por jo në raportet e auditimit (Bullgari, Kroaci, Sllloveni).

Një shembull i mire në Ballkan për raporte të efektshme SAI-Parlament jepet nga Kroacia. SAI kroat është një institucion i zhvillua auditimi, me një tradite konsultimesh

---

[13] *Proces-Verbali i mbledhjes së datës 2 nëntor 2015 për Miratimin e Buxhetit faktik të Shtetit për vitin 2014 ».https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2016/01/komisioni_i_ekonomise_date_2_11_2015_25016_1.pdf*

me Komisionin kroat për Buxhetin. Përparimi i dukshëm i cilësisë së raporteve të auditimit dhe i bashkëpunimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë me Parlamentin u theksua dhe gjatë vizitës që Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Kroacisë, z. Ivan Klesiç zhvilloi në Gjykatën Evropiane të Audituesve në Luksemburg, me 27 tetor 2015.

Audituesi i Përgjithshëm i Kroacisë z. Ivan Klesiç gjatë vizitës ne ECA.

IPU mbi raportet Parlament-SAI

Boks 7

Ç 'është IPU?

Unioni Ndërkombëtar Parlamentar (IPU) është një organizatë ndërkombëtare e parlamenteve të Botës (neni 1 i Statutit të Unionit Ndër-Parlamentar). Ai është themeluar në vitin 1889, si forum dhe pikë fokale për dialog parlamentar të gjerë. IPU punon për vendosjen e demokracisë së fortë përfaqësuese.

Për këtë qëllim, ai promovon kontakte, koordinimin dhe shkëmbimin e përvojës mes parlamenteve dhe parlamentarëve të të gjitha vendeve, konsideron çështjet me interes dhe shqetësim ndërkombëtar dhe shpreh pikëpamjet e tij për çështje të tilla në mënyrë që të sjellë ndërveprimin nga ana e parlamenteve dhe parlamentarëve.

IPU mbështet përpjekjet e dhe punon në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, pranë së cilës ka statusin e Vëzhguesit të Përhershëm.

objektivat e të cilit ajo ndan. Unioni gjithashtu bashkëpunon me organizatat rajonale ndër parlamentarë, si dhe me organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare që janë të motivuara nga të njëjtat ideale.

Në tetor të vitit 2011, IPU miratoi Strategjinë e tij të Zhvillimit 2012-2017, nën moton "Parlamente më të mira, demokraci më e fortë".

IPU financohet kryesisht nga anëtarët e tij nga fondet publike. Zyrat qendrore të IPU janë në Gjenevë (Zvicër). Bashkëpunimi mes IPU dhe INTOSAI-t është i vazhdueshëm dhe mbi baza konkrete. Një moment domethënës të këtij bashkëpunimi e përben fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të IPU në një nga Konferencat Ndërkombëtare më të rëndësishme te INTOSAI-t ne dhjete vitet e fundit.

Për vete rëndësinë e një organizate ndërkombëtare si IPU, mendova që në këtë punim modest të përfshij të plotë fjalën e z. Anders B. Johnsson, Sekretar i Përgjithshëm, Unioni Ndër Parlamentar (IPU), mbajtur në Konferencën e INTOSAI-t "Fuqizimi i Auditimit Publik të Jashtëm ne Rajonet INTOSAI », 26-27 maj 2010, Vjenë, Austri[14].

Në foto Sekretari i Përgjithshëm i IPU z. Anders B. Johnsson dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB Ban Ki-Moon.

«*Unë jam shumë mirënjohës për këtë mundësi për të thënë disa fjalë për bashkëpunimin ndërmjet Parlamenteve dhe SAI-ve. Unë do të doja t'u parathoja komenteve të mia mbi këtë çështje, duke deklaruar besimin tim se Parlamentet dhe SAI-t janë të domosdoshëm për njëri-tjetrin.*

Parlamentet vijnë në forma dhe struktura të shumta. Në një kuptim, çdo Parlament është i ndryshëm, në varësi të historisë kombëtare, kulturës, evolucionit. Të gjitha Parlamentet megjithatë ndajnë përgjegjësi të përbashkëta, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë. Ata miratojnë ligjet e vendit dhe e mbajnë qeverinë në llogaridhënie, të përgjegjshme. Sado të ndryshëm që ata mund të jenë, të gjithë Parlamentet ndajnë karakteristika të përbashkëta.

---

[14] *Konferenca e INTOSAI-t Fuqizimi i Auditimit Publik te Jashtëm ne Rajonet INTOSAI », 26-27 maj 2010, Vjene, Austri, faqe 50-55, http://www.intosai.org/uploads/intosaipublikation02112010small.pdf*

Me një parlament demokratik ne kuptojmë një parlament që është përfaqësues, si shoqëror ashtu dhe politik, i popullit, një Kuvend që është transparent, dmth i hapur për qytetarët dhe median, që është në dispozicion të publikut në mënyrë që qytetarët të mund të kontribuojnë në punën e Parlamentit; një Kuvend që është vetë përgjegjës para popullit edhe për performancën në zyrë dhe integritetin e anëtarëve të tij, si dhe një Parlament që është efektiv në kryerjen e funksioneve të tij kryesore.

Llogaridhënia, nocioni i mbajtjes së qeverisë të përgjegjshme, është po aq i vjetër sa vetë Parlamenti. Asaj i është dhënë një theks i ripërtërirë kohën e fundit përmes diskutimeve rreth ndihmës për zhvillim. Shqyrtimi më i madh publik i ndihmës në donatorëve si dhe punës së vendeve përfituese ka çuar në thirrje për efektivitet më të madh në përdorimin e këtyre burimeve. Deklarata e Parisit dhe Axhenda Accra për Veprim[15] – baza për marrëveshjet e arritura në nivel ndërkombëtar për të rritur efektivitetin e ndihmës – i vënë theks të veçantë llogaridhënies. Axhenda Accra, në mënyrë të veçantë, thekson se Parlamenti ka përgjegjësi për të siguruar pronësinë kombëtare të politikave dhe llogaridhënies në përdorimin e ndihmës për zhvillim. Llogaridhënia ka qenë shumë në lajmet e fundit edhe në raport me Parlamentin dhe integritetin e anëtarëve të tij. Unë nuk kam pse të mos kujtoj mos-shërbimet dhe dëmet që i janë bërë demokracisë, nëse publiku beson se anëtarët e parlamentit, të cilëve ai u ka dhënë besimin publik, janë parë duke ndihmuar veten e tyre nëpërmjet arkës së Shtetit. Prandaj përgjegjshmëria qëndron në thelb, jo vetëm të asaj që Parlamentet duhet të bëjnë, por edhe se si ata duhet ta bëjnë atë.

Përgjegjshmëria kuptohet gjithnjë e më shumë si një sistem institucionesh dhe procesesh që kontribuojnë në përdorimin efikas të burimeve të kufizuara. Kjo kërkon një ndryshim në theks, nga forcimi i institucioneve të veçanta drejt një qasjeje më holistike, më të përgjithshme, që adreson marrëdhëniet dhe ndërlidhjet që ekzistojnë apo duhet të ekzistojë ndërmjet një game të tërë të institucionesh që mund të kontribuojnë për forcimin e llogaridhënies. Parlamentet dhe SAI-t bien në këtë kategori. Ata kanë një axhendë të përbashkët për të siguruar mbikëqyrjen e qeverisë, me qëllim përdorimin e duhur të burimeve, dmth shpenzimet të jenë kryer në përputhje me autorizimet e dhëna në buxhet dhe në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive. Unë do të argumentoja se Parlamenti është institucioni kryesor i besuar nga populli për të mbajtur Qeverinë të përgjegjshme dhe për t'i kërkuar llogari asaj, por nuk mund ta arrijë këtë pa mbështetjen e SAI-t. Në fakt, një studim i fundit i kryer nga

---

[15] Axhenda ACCRA për Veprim e vitit 2008 është Plani i Veprimit i Komunitetit Ndërkombëtar te Donatoreve, për zbatimin e objektivave te Deklaratës se Parisit. http://www.oecd.org/dac/effectiveness/parisdeclarationandaccraagendaforaction.htm

IPU-ja tregon se në shumicën e vendeve (85%), raporti i SAI-t përbën burimin kryesor të informacionit për Parlamentit në punën e tij të kontrollit të shpenzimeve të kryera nga Qeveria. Parlamentet dhe SAI-t janë siguristht jo vetëm; institucione të tjera që duhet të jenë faktorë në sistem përfshijnë institucionin e Avokatit të Popullit, komisionet e të drejtave të njeriut, komisionet kundër korrupsionit, etj. Prandaj dhe nuk ka vend për habi për faktin që në praktikë ka një lidhje shumë të fortë mes parlamenteve dhe SAI-ve.

Një studim i kohëve të fundit i kryer nga IPU në 120 parlamente dha rezultatet e mëposhtme. Pothuajse secili prej Parlamenteve (118 nga 120) raportoi ekzistencën e një organi – Institucion Suprem i Auditimit - me përgjegjësi për auditimin e llogarive të qeverisë. 41 nga këto organe janë të emëruara nga Parlamenti, ndërsa 45 janë të emëruar nga Kryetari i Shtetit. Pjesa tjetër janë të emëruar nga Kryetari i Shtetit apo i Qeverisë, por janë subjekt i konfirmimit nga Parlamenti. Tendenca është që drejtuesi i SAI-t ka më shumë gjasa të emërohet nga Kryetari i Shtetit në vendet me një sistem presidencial apo gjysmë-presidencial; dhe më shumë gjasa të jetë i emëruar nga Parlamenti në vendet me një sistem parlamentar. Megjithatë, në të dyja rastet, raporti është vetëm rreth 60:40, duke sugjeruar se lloji i sistemit politik nuk është një përcaktues i fuqishëm i metodës së emërimit të drejtuesit të SAI-t. 92% e këtyre SAI-ve janë të detyruar të raportojnë në Parlament dhe normalisht e bëjnë këtë një herë në vit. Megjithatë ka edhe SAI (rasti I Vietnamit), ku raportimi zhvillohet në baza tremujore apo çdo gjashtë muaj. Edhe pse IPU nuk ka informacion të detajuar se cilat komisione parlamentare pranojnë raportet e SAI-t, besohet se në parlamentet bazuar në modelin Westminster, Komisioni i Llogarive Publike është përfituesi më i shpeshtë i këtyre raporteve. Në shumë juridiksione të tjera, marrësi është komisioni përgjegjës për miratimin e Buxhetit, ose, si në Gjermani, një nën-komision i tij.

Shpesh kur dikush merr pjesë në debate publike rreth një demokracie, influencohet nga prirja jonë për të ngatërruar teorinë me faktet. Ne mund të jemi të gjithë dakord mbi rolin thelbësor të parlamenteve në mbajtjen e qeverisë të përgjegjshme llogari, por priremi të harrojmë se Parlamentet përballen me sfida shumë të vështira në përmbushjen e përgjegjësive të tyre, dhe unë mund ta imagjinoj se SAI-t përballen po ashtu me sfida njëlloj të forta. Shumica e Parlamenteve sot kanë një histori relativisht të shkurtër të funksionimit si institucione llogari-kërkuese. Ato janë me të vërtetë duke u përpjekur për të nxjerrë ligje dhe për ta mbajtur Qeverinë në një kërkesë konstante llogarie. Në një numër shumë të konsiderueshëm vendesh, ka pasur vetëm disa mandate kohë kur Parlamenti të jetë zgjedhur në bazë të një sistemi shumëpartiak. Në këto vende, Parlamenti është mbledhur vetëm rrallë më parë dhe

ka arritur veç pak më shumë se sa të miratojë planet e përgatitura nga Ekzekutivi. Këto Parlamente kanë burime të kufizuara – pra kanë pak kapacitet institucional - dhe duhet të funksionojnë në një mjedis që është shumë kompleks, shumë teknik, virtual, duke lëvizur shpejt, dhe ku shumë prej vendimeve të rëndësishme në shoqëri janë marrë jo nga qeveria, jo nga Parlamenti, por nga një shumëllojshmëri aktorësh të tjerë. Nëse ne jemi serioze në lidhje dëshirën për të siguruar llogaridhënie, duhet të adresojmë çështjen e kapaciteteve dhe, në fund të fundit, edhe çështjen e burimeve. Kjo nuk është vetëm një çështje e pasjes së më shumë burimeve, por edhe një çështje e përdorimit më të mirë të burimeve ekzistuese dhe, për këtë qëllim, kërkohet bashkëpunim më i mire mes Parlamenteve dhe SAI-ve, si dhe mes INTOSAI-t dhe IPU.

Bashkëpunimi mes IPU dhe INTOSAI

Në shumë mënyra, IPU nuk është aq e ndryshme si organizatë nga INTOSAI. Ne jemi të dy organizata ndërkombëtare të ngritura për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve tanë. Ne jemi institucione jo qeveritare; pos as dhe nuk jemi OJF ndërkombëtare. Ne jemi organizata ndërkombëtare që sjellin së bashku institucionet e pavarura të Shtetit. Ne jemi gjithashtu organizata që ofrojnë përkrahje për anëtarët tanë dhe të përpiqen për të ndihmuar ata të përmbushin mandatet e tyre. Në rastin e IPU, ne ndihmojmë zhvillimin e standardeve dhe kritereve për parlamentet demokratike. Ne i ndihmojmë Parlamentet në vlerësimin e asaj që ata e bëjnë mirë dhe çfarë mund të bëjnë më mirë. Ne i ndihmojmë Parlamentet me programet e asistencës dhe ndihmojnë në zbatimin e tyre nëpërmjet asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë procesit të buxhetit dhe auditimit të tij. Buxheti është mjeti më i rëndësishëm i politikës ekonomike të qeverisë dhe kërkohet kontributi i plotë i SAI-t, në kuadër të kornizës kushtetuese të prioriteteve të kombit.

Shumica prej jush SAI-ve duhet të punojë me Parlamentin dhe ne, në Parlament, kemi një interes të fortë për të siguruar që ju të jeni në gjendje të bëni një punë të mirë. Prandaj, ne kemi një interes të përbashkët për të siguruar që Parlamenti të ndajë burimet e nevojshme për SAI-t dhe për të hartuar një kuadër ligjor që mundëson SAI-t për të funksionuar në mënyrë efektive dhe të pavarur. Ashtu siç Ju më keni ftuar në këtë Konferencë, unë do të doja t'ju ftoja në aktivitetet e IPU, ku ju mund t'u adresoheni përfaqësuesve të Parlamenteve të shumicës së vendeve të botës dhe të rrisni ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me institucionin tuaj dhe nevojat që ata kanë që Ju të kryeni detyrën tuaj sa më mirë. Po ashtu, ne e kemi një interes në programet për ndërtimin e kapaciteteve për deputetët, për të ndihmuar që ata të kuptojnë procesin e auditimit dhe si kontribuon ai në efikasitetin dhe llogaridhënien e Qeverisë.

Kjo duhet të përfshijë edhe Opozitën dhe të sigurojë një rol të rëndësishëm për opozitën në Parlament. Ne kemi nevojë për të siguruar burime të mjaftueshme për komisionet parlamentare që kanë të bëjnë me raportet e auditimit. Ka shumë Parlamente ku një numër i konsiderueshëm i raporteve të auditimit qëndron pirg i pa konsideruar, për shkak të mungesës së burimeve dhe kapaciteteve parlamentare. Do të kishte kuptim për Parlamentet dhe SAI-t që të punojnë së bashku për zhvillimin e programeve të përbashkëta që promovojnë llogaridhënien. Një nismë e tillë mund të jetë në hartimin e kodeve të etikës.

Për të çuar përpara një axhendë të tillë, unë do të sugjeroja që IPU dhe INTOSAI të punojnë së bashku për të zhvilluar një kuptim më të madh të modeleve të ndryshme për bashkëveprim dhe bashkëpunim ndërmjet Parlamenteve dhe SAI-ve. Ne mund të identifikojmë Komisionet në Parlament, të cilat kanë një mandat në lidhje me auditimin kombëtar. Ne gjithashtu mund të ndërmarrim disa raste studimore për të identifikuar modele të ndryshme për mbajtjen e qeverisë në llogaridhënie në Parlament, gjatë procesit të auditimit. Kjo do të na ndihmojë për të lehtësuar rrjetëzimin, shkëmbimin e përvojave, dokumentimin e shembujve të mirë dhe identifikimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve.

Konkluzion

Më lejoni të përfundoj duke përsëritur se unë Ju jam mirënjohës për këtë mundësi për t'u angazhuar me Ju në një diskutim mbi bashkëpunimin ndërmjet Parlamenteve dhe SAI-ve. Më lejoni të theksoj megjithatë se unë e shoh këtë si fillimin e një procesi në të cilin ne mund të shpresojmë të jemi të një dobie më të rritur për njëri-tjetrin dhe, në këtë mënyrë, të ndihmojmë për të siguruar llogaridhënien më të madhe dhe efikase të Qeverisë për të mirën e përbashkët".

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit nga Komisioni Parlamentar dhe SAI

Në shumicën e vendeve anëtare dhe kandidate të BE-së, realizohet një formë e ndjekjes se zbatimit të rekomandimeve, ose nga Komisioni apo vetë SAI, ose nga të dy (Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Hungaria, Malta, Polonia, Rumania, Republika Sllovake dhe Sllovenia). Komisionet e tjera parlamentare dhe SAI-et e tjera, si rregull, nuk kryejnë ndjekje të zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e SAI-t.

Format e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të SAI-janë të ndryshme dhe lloji, niveli dhe shkalla e aplikimit të tyre varion nga një vend në një tjetër, si më poshtë:

- Audituesit janë të detyruar për të parë se çfarë përparimi është bërë tek i audituari me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (në shumë vende kjo detyrë është e përfshirë në metodat e auditimit dhe procedurat e planifikimit të auditimeve nga ana e SAI-t. Në vendin tonë, auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH është pjesë integrale e çdo auditimi të ri). Nëse një çështje/rekomandim i rëndësishëm i dalë në raportin e auditimit nuk është zgjidhur, çështja do të përfshihet në Raportin Vjetor të SAI-t për vitin të ardhshëm (p.sh Hungari, Qipro, etj.).

- Komisioni parlamentar mund t'u kërkojë organeve të ndryshme shtetërore për të raportuar lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të SAI-t. Në bazë të raportit të auditimit, Komisioni mund të miratojë një rezolutë duke i bërë disa kërkesa specifike Qeverisë, ministrive ose organet të tjera qendrore shtetërore. Në veçanti, ai mund të kërkojë që të metat dhe mangësitë e vërejtur nga SAI të korrigjohen dhe Komisioni të informohet lidhur me masat përmirësuese të aplikuara dhe rezultatin e tyre. Organit shtetëror të cilit i është adresuar një rezolute e tillë i kërkohet të komunikojë informacionin ose t'i japë një shpjegim Komisionit brenda një afati kohor të caktuar (p.sh. Republika Çeke, Polonia, Republika Sllovake).

- Raporti i Komisionit në Parlament mund të përmbajë propozime konkrete për ndjekjen e zbatimit të masave të propozuara nga SAI (p.sh Polonia, Hungaria, Rumania, Kroacia, Republika Çeke, etj.).

- Në shumë vende, përdoruesi i fondeve publike, në veprimet e të cilit SAI ka zbuluar parregullsi ose joefikasitet, duhet t'i paraqesë SAI-t një raport mbi punën e bërë prej tij ndreqjen e parregullsive dhe joefikasitetit të zbuluar nga SAI (Raporti në përgjigje të raportit të auditimit).

Një studim i Programit Gjerman për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (GIZ) i gushtit 2015[16], me titull "Bashkëpunimi për Përgjegjshmëri-Institucioni Suprem i Auditimit dhe Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike, një manual komunikimi", jep portretin si në Boksin e mëposhtëm, të një Komisioni Parlamentar ideal për një marrëdhënie shume te efektshme Parlament-SAI.

Boks 8

Komisioni Parlamentar Ideal

(Mund të jetë një komision i llogarive publike ose një komision për kontrollin buxhetor dhe financat)

Komisionet parlamentare në përgjithësi i kanë të ndryshme praktikat operative dhe proceset, në varësi të mjediseve legjislative dhe politike brenda të cilave veprojnë. Megjithatë, studiuesi i mirënjohur Rick Stapenhurst rekomandon atributet në vijim për një "Komision ideal":

• Masa: 5-11 anëtarë, ku asnjëri prej të cilëve nuk duhet të jetë ministër i qeverisë;

• Kryesuesi: një anëtar i lartë i opozitës;

• Afati i emërimit: mandati i plotë i Parlamentit;

• Burimet: burime të mjaftueshme, me një nëpunës me përvojë dhe një ose disa studiues kompetentë , duke pasur trajnime adekuate dhe qasje në ekspertizën që ata kërkojnë;

• Komisioni duhet të veprojë në mënyrë jopartiake dhe të ketë fuqinë për të hetuar të gjitha shpenzimet qeveritare të kaluara dhe të tanishme, pavarësisht se kur janë bërë.

[16] *GIZ, « Bashkëpunimi për Përgjegjshmëri", gusht 2015, https://www.giz.de/en/downloads/giz2015-en-gfg-cooperation-accountability.pdf*

• Mandati: qartësia mbi rolin dhe përgjegjësitë e tij, duke pasur parasysh fuqinë për të siguruar se rekomandimet si të tij dhe të SAI-t janë zbatuar;

• Organizon shpesh dëgjime publike, të hapura për publikun dhe median;

• Raportet e auditimit i kalojnë automatikisht Komisionit nga Kryetari i Parlamentit dhe ku SAI në Përmbledhjen e Raportit e informon mjaftueshëm Komisionin mbi pikat kryesore të Raportit dhe gjetjet kryesore të auditimit;

• Unanimiteti: Komisioni përpiqet për sa më shumë konsensus në vendimet dhe raportet e tij në lidhje me SAI-n;

• Raportimi në Parlament: prodhon paktën një here në vit raporte thelbësore në Parlament lidhur me vlerësimin e punës së SAI-t dhe çështjet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të tij;

• Ndjekja e rekomandimeve: ka një procedurë formale për ndjekjen e rekomandimeve. të tij.

Roli i Komisionit Parlamentar në auditimet e SAI-t. E drejta e Komisionit për të shqyrtuar dhe ndikuar në programin e auditimeve të SAI-t, për të kërkuar një auditim, hetim ose rishikim tjetër nga SAI

Praktikisht të gjitha SAI-t, efektivisht kanë një shkallë të arsyeshme të pavarësisë në përgatitjen e programit të tyre vjetor të auditimit. Disa SAI nuk marrin asnjë orientim në përgatitjen e planit të tyre të punës audituese, nga Parlamenti apo nga komisione parlamentare të veçanta (Shqipëria, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Malta). SAI të tjerë janë të ndikuar apo të orientuar në një farë mase. Megjithatë, pjesa më e madhe e punës së kryer nga SAI-t në tërësi varet vetëm nga prioritetet dhe vendimet e SAI-t.

Më poshtë janë disa shembuj të ndikimit në programin vjetor të auditimit të SAI-t:

- Në Kroaci, në bazë të dispozitave të Ligjit Shtetëror për Auditimin, Dhoma e Përfaqësuesve (Parlamenti kroat) duhet të konfirmojë Programin vjetor të Auditimit të SAI-t me propozimin e këtij të fundit (në praktikë, Parlamenti nuk e ka ndikuar ndonjëherë Programin vjetor të SAI-t).

- Në Slloveni, SAI është i detyruar që të përfshijë në planin e tij të punës audituese pesë propozime për auditime nga Parlamenti, dy prej të cilave do të jenë nga deputetët e opozitës dhe dy nga Komisioni Parlamentar.

- Në Hungari, Presidenti i SAI-t përcakton përmbajtjen e Programit Vjetor të Auditimit pas konsultimit me Komitetin e Auditimit Shtetëror.

- Në Poloni, sipas ligjit të NIK, "*NIK i kryen detyrat e tij në bazë të planeve periodike, të cilat i janë paraqitur Sejm-it(Parlamentit polak)*". Komisioni parlamentar i Kontrollit Shtetëror diskuton planin vjetor të auditimit, kur ai është i miratuar nga NIK.

- Në Republikën Çeke, pasi është miratuar, plani i aktivitetit të auditimit paraqitet në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senat për informimin e tyre (Presidenti i SAI-t

gjithashtu raporton vetë për planin e auditimeve në Komisionin parlamentar të Buxhetit).

Shembull i një bashkëpunimi të shëndetshëm SAI-Komisione Parlamentare është edhe Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA). Në fjalën e tij me 11 janar 2016, ne prezantimin e programit vjetor te ECA-s për vitin 2016 përpara Komisionit te Parlamentit Evropian mbi Kontrollin e Buxhetit, Dr. Vitor Caldeira, President i ECA-s, shprehej: *"Për programin e punës të këtij viti, ne kemi përfituar nga një nivel i angazhimit më i madh se kurrë më parë me komisionet e Parlamentit Evropian. Unë do të doja të falënderoj Komisionin mbi Kontrollin e Buxhetit dhe Konferencën e Kryetarëve të Komisioneve të Parlamentit për këtë"*[17].

A porosit Parlamenti auditime?

Në disa vende ekziston edhe mundësia që Parlamenti të porosisë auditime shtesë:

- Në disa raste, vetëm një nga dhomat e Parlamentit mund të kërkojë një auditim ose rishikim tjetër, por jo komisionet parlamentare individuale (në Bullgari - deri në tre auditime çdo vit, në Kroaci, Hungari, Lituani, Rumani dhe në Republikën Sllovake). Është e mundur për komisionet parlamentare për të kaluar në seancë plenare të Parlamentit, që të udhëzojnë SAI-n për të ndryshuar programin vjetor të auditimit, ose që të përfshijnë një temë të re auditimi në planin vjetor të punës së SAI-t. Megjithatë, në praktikë porosi të tilla nga Parlamenti janë të rralla.

- Në Poloni, në bazë të ligjit për Dhomën e Lartë të Kontrollit, "*NIK (SAI polak) ndërmerr auditime me porosi të Sejm-it(Parlamentit polak) ose të organeve të tij*". Porositë janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga NIK. Një porosi nga komisioni parlamentar ndodh kur Komisioni kalon një rezolutë mbi një auditim

[17] *Dr. Vitor Caldeira, ish-President i Gjykates Evropiane te Audituesve, Fjala perpara Komisionit mbi Kontrollin e Buxhetit te Parlamentit Evropian, 11 janar 2016, faqe 2, http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/Speech_WP2016/speech-WP2016-EN.pdf*

që duhet të kryhet nga NIK. Në vitin 1999 ka pasur 14 auditime sipas porosive të Sejm-it ose/dhe organeve të tij, në vitin 2014 ka pasur pesë auditime të tilla.

- Në Letoni, një komision hetimor parlamentar, në përputhje me detyrat e caktuara nga Saeima (Parlamenti letonez), ka të drejtë të kërkojë të kryhet një auditim.

Përveç këtyre rasteve, në shumë vende anëtare/kandidate të BE-së, ka një praktikë informale të komisioneve parlamentare (apo edhe deputetëve individualë) të japin sugjerime mbi tema të auditimeve për t'u zhvilluar. Ato mund të përfshihen në programin e auditimit të SAI-t, më vendim të Kryetarit të SAI-t ose Bordit kolegjial drejtues të tij(në rastet kur SAI drejtohet nga Bordi dhe nuk është strukturë monokratike. Edhe pse propozime të tilla nuk janë të detyrueshme, SAI-t i konsiderojnë seriozisht ato dhe u përgjigjen në mënyrën e duhur. Propozimet shpesh dorëzohen pas konsultimeve paraprake me SAI-n. Disa SAI theksojnë se ata kurrë nuk refuzojnë propozime të tilla, për aq kohë sa ato janë të arsyeshme dhe brenda mandatit të tyre. Për shembull, nga viti 1996 deri në vitin 2013, SAI i Republikës Çeke ka pranuar gjithsej 48 sugjerime të tilla, kryesisht nga Komisione të veçanta, nga të cilat 33 janë pranuar. Në Poloni, në gjysmën e parë të çdo viti, Presidenti i NIK i kërkon Kryetarit të Sejm (Parlamentit Polak) sugjerime mbi temat e auditimit për vitin e ardhshëm. Komisionet shpesh e përdorin këtë mundësi (kërkesën nga Presidenti i SAI-t) - në vitin 2000 kanë dorëzuar 46 propozime nga të cilat 43 pjesërisht apo tërësisht janë konsideruar, në vitin 2010, 32 propozime (për më tepër, komisionet parlamentare ndikojnë aktivitetet e auditimit të NIK përmes porosive për auditime).

Nuk ka asnjë dëshmi të dukshme në asnjë prej vendeve të studiuara nga OECD ose BB, që parlamentet apo komisionet parlamentare të kenë parandaluar auditime që të planifikohen ose kryhen nga SAI. Në teori, kjo mund të bëhet në mënyrë formale apo joformale, për shembull duke aplikuar presion politik mbi SAI-n, ose duke kërcënuar për raprezalje në alokimet buxhetore për SAI-n. Nga studimet nuk kanë dalë raste të fuqive parlamentare me veto për SAI-n. Megjithatë, mënyrat informale të ndikimit mund të jenë një problem serioz, nëse një Komision Parlamentar kontrollohet nga partia / koalicioni politik qeverisës, pasi ai mund të ketë një interes në shmangien e auditimeve që qeveria mund t'i gjejë politikisht të dëmshme për të. Ky rrezik do të varet nga pjekuria politike e partisë ose koalicionin që ka shumicën në Parlament dhe që qeveris.

Kontaktet ndërmjet SAI-t dhe komisionit parlamentar para dhe pas takimeve në Komision

Në shumicën e vendeve të studiuara, ka kontakte ndërmjet SAI-t dhe Komisionit parlamentar përpara dhe pas takimeve në Komision. Këto kanë të bëjnë me diskutimet që ka Komisioni lidhur me raportet e auditimit të SAI-t dhe me çështje të tjera. Disa SAI kanë pak kontakte të tilla (Qipro, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Lituania, Malta, Rumania, Republika Sllovake). SAI-t të tjera kanë një mënyrë më të shpeshtë komunikimi me Komisionin(Shqipëria, Kroacia, Hungaria, Polonia, Sllovenia).

Kontaktet kanë të bëjnë me marrjen e një informacioni më të detajuar në lidhje me raportet e SAI-t që do të jenë në rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Komisionit (Shqipëri, Kroaci), me bashkëpunimin dhe përgatitjen për takimin (Rumani, Republika Sllovake, Sllovenia), duke përfshirë edhe listat e pyetjeve të propozuara nga SAI për Komisionin përpara takimit (Malta), me kërkesën për dokumente, informacione apo sqarime shtesë (Letoni, Poloni), si dhe me shqyrtimin paraprak të raporteve nga Komisioni (Bullgari). Në Hungari, SAI e informon Komisionin në lidhje me një raport të auditimit gjashtë muaj para përfundimit të auditimit dhe dorëzimit të raportit përkatës tek Komisioni.

Fusha kryesore e kontakteve SAI-Komision Parlamentar ka të bëjë me raportet e auditimit. Konkluzionet që rezultojnë nga aktivitetet e auditimit ndonjëherë frymëzojnë Komisionin për të vepruar mbi probleme të caktuara. Përveç kësaj, SAI-t nganjëherë ofrojnë asistencë dhe mbështetje, e cila mund të marrë formën e komenteve mbi disa draft-ligje të paraqitura përpara SAI-t për shqyrtim (Bullgaria, Republika Çeke, Lituania, Polonia), diskutime mbi çështje të veçanta (Kroacia), duke përgatitur dokumente analitike shtesë (Lituani, Poloni), prezantime dhe udhëzime për çështje profesionale (Hungari) ose dorëzimin e të dhëna të tjera të kërkuara nga Komisioni (Rumani, Republika Sllovake). Në Republikën Çeke, nëse kërkohet nga Dhoma e Përfaqësuesve apo Komitetet e Senatit që janë caktuar të debatojnë mbi projekt-ligje të caktuara, Kryetari i Zyrës Shtetërore të Auditimit (SAI-t) mund që herë pas here të emërojë një anëtar të SAI-t apo një punonjës të tij, i cili zotëron ekspertizën në fushën përkatëse, për të marrë pjesë në diskutimet në lidhje me projekt-ligje të tilla.

Në mënyrë tipike, sigurisht që ka kontakte në mes të Kryetarit të Komisionit dhe Kryetarit të SAI-t, por në disa vende edhe njësi të SAI-t (departamente, drejtori, etj) kanë kontakte të drejtpërdrejta me Komisionin përkatës parlamentar(Bullgaria, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Sllovake). Këto kontakte përfshijnë si komunikimin informal me gojë ashtu dhe atë më zyrtar me shkrim ndërmjet anëtarëve të Komisionit dhe anëtarëve të SAI-t. Anëtarët e Komisionit mund të jenë të shqetësuar dhe të kërkojnë detaje të mëtejshme, sqarime ose informacione të tjera për çështje të caktuara në raportin e auditimit, ose në nivel të bashkëpunimit në një kuptim më të gjerë. Kur ekzistojnë kontaktet, këto zakonisht janë në mes të Kryetarit të Komisionit ose anëtarëve të tij dhe Nënkryetarit, asistentëve të Kryetarit apo drejtorëve në SAI. Në disa raste, është raportuesi i Komisionit, përgjegjës për një raport të veçantë të auditimit, i cili, në përgatitjen e raportit të tij / saj për Komisionin, kontakton me një anëtar përkatës ose drejtor të SAI-t, ose me audituesit që përgatitën raportin e auditimit. Kjo bëhet me qëllim të sqarimit të pyetje të veçanta që mund të dalin nga raporti i auditimit. Në vende të tjera, departamentet dhe drejtoritë e SAI-t nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me Komisionin Parlamentar.

Në lidhje me shpeshtësinë dhe natyrën e kontakteve SAI-Parlament, studimi i GIZ "Bashkëpunimi për Përgjegjshmëri-Institucioni Suprem i Auditimit dhe Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike, një manual komunikimi" i gushtit 2015 ve theksin ne disa mangësi te raporteve Komision Parlamentar-SAI, duke dhënë si zgjidhje për këto mangësi qasjen e komunikimit mbështetës dhe komunikimit mbi bazën e reputacionit, në Boksin si më poshtë:

Boks 9

Problematika dhe zgjidhjet e GIZ për komunikimin Komision Parlamentar-SAI

SAI-t kanë nevojë për mbështetje të fokusuar për të përmirësuar komunikimin dhe marrëdhëniet e tyre me grupet e interesit të tyre, veçanërisht me Komisionet Parlamentare përgjegjëse për shqyrtimin e raporteve të tyre. Në shumë vende të botës, viret re një hendek mes asaj që Komisionet Parlamentare presin nga raportet e auditimit dhe se çfarë është në të vërtetë ndodhet në raportet e SAI-ve. SAI-t duhet të synojnë reduktimin e këtyre mangësive, për të rritur ndikimin e tyre në Parlament. Një numër i sfidave që ekzistojnë në lidhje me bashkëpunimin SAI-Komision Parlamentar përgjegjës, dhe që, në rast se nuk trajtohen, mund të ndikojnë negativisht në funksionimin e zinxhirit të llogaridhënies, janë si në vijim:

- *SAI-t shpesh nuk japin mbështetje të mjaftueshme për Komisionin. Raportet e auditimit janë të shkruara në gjuhën e komplikuar teknike, gjë që e bën të vështirë për anëtarët e Komisionit të kuptojnë gjetjet e auditimit dhe mesazhet kryesore të raporteve të auditimit. Ky problem mund të lidhet me faktin se shumë anëtarëve të Komisionit shpesh u mungojnë njohuritë e mjaftueshme të menaxhimit financiar publik, auditimit dhe të kontabilitetit (ky nuk është rasti i Komisonit për Ekonominë dhe Financat në vendin tonë, pasi shumica e anëtarëve të tij janë ekspertë dhe ekonomistë e financierë të njohur), pasi ata janë zgjedhur si përfaqësues politikë të zgjedhësve të tyre. Ata nuk posedojnë aftësi të mjaftueshme teknike për të kryer funksionet e tyre mbikëqyrëse në mënyrë efektive. Për më tepër, ata shpesh nuk mbështeten sa duhet nga stafi ndihmës parlamentar, nga ekspertët kërkimorë dhe nëpunësit.*

- *Raportet e auditimit nuk dorëzohen në kohë nga SAI. Kjo e bën të pamundur për Komisionin të shqyrtojë raportet e auditimit dhe të hetojë rastet urgjente.*

• Vonesat e Komisionit në hartimin e rezolutave të tij dhe në raportimin në Parlament, të cilat kontribuojnë në një llogaridhënie të pjesshme dhe jo të thellë të praktikave të menaxhimit financiar në njësitë e sektorit publik. Vonesat janë shpesh rezultat i ngarkesës së punës në Komision, si dhe i komunikimit dhe koordinimit të paefektshëm ndërmjet SAI-t dhe Komisionit gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve. Komunikimi në kohë për numrin e raporteve të auditimit që duhet të sigurohen nga SAI është i rëndësishëm në menaxhimin e ngarkesës së punës së Komisionit.

• Raportet e auditimit nuk përdoren vetëm për të forcuar përgjegjshmërinë financiare publike. Në disa raste, ata shfrytëzohen nga anëtarë të Komisionit për të avancuar axhendat politike dhe përdoren për fushatë.

• Ka mungesë të rregullave formale dhe udhëzimeve që qeverisin ndërveprimin dhe marrëdhëniet në mes të SAI-t dhe Komisionit.

• Shkalla e lartë e rotacionit të anëtarëve të Komisionit nga disa legjislatura sjell ndikime negative në kujtesën institucionale dhe vazhdimësinë e punës së Komisionit, si dhe në marrëdhëniet e tij me SAI-n.

• Në Komision mungojnë mekanizmat për ndjekjen e rekomandimeve të SAI-t.

Mangësitë e mësipërme në bashkëpunimin Komision-SAI tregojnë nevojën për të gjetur një mënyrë për të përmirësuar situatën. Vetëvlerësimet nga shumë SAI nëpërmjet procesit të Peer Review kanë konfirmuar se një pjesë e madhe e sfidave dhe problemeve ekzistuese në marrëdhëniet Komision Parlamentar-SAI mund të zgjidhen duke përmirësuar komunikiminin mes te dyja institucioneve.

Në tërësi, Komisioni kërkon mbështetje nga SAI në përmbushjen e rolit të tij për të shqyrtuar raportet e auditimit dhe dhënien e rekomandimeve për administrimin financiar të qeverisë. Kjo mbështetje merr forma të ndryshme, në varësi të thellësisë së marrëdhënieve që SAI ka me Komisionin dhe burimet në dispozicion. Si një minimum, SAI e informon Komisionin mbi gjetjet e auditimit dhe merr pjesë në dëgjimet e tij publike si një dëshmitar ekspert.

Nëse marrëdhënia SAI-Komision është e fortë, mbështetja sigurohet në të gjitha aspektet e punës së Komisionit për mbajtjen e Qeverisë të përgjegjshme në administrimin financiar, duke shqyrtuar raportet e auditimit. Prandaj është e domosdoshme që komunikimi SAI-Komision të përmirësohet në kontekstin e marrëdhënies së tyre të punës, duke shfrytëzuar gjetjet e auditimit për të krijuar institucione të përgjegjshme dhe transparente të sektorit publik.

Ka dy qasje komunikimi. Objektivi i komunikimit mbështetës është për t'i siguruar Komisionit mbështetjen e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin e vet dhe efikasitetin në planifikimin, shqyrtimin e raporteve të auditimit, duke mbajtur dëgjesa publike, duke zhvilluar rezoluta dhe duke ndjekur në mënyrë sistematike rekomandimet e SAI-t. Nëse komunikimi mbështetës projektohet si duhet, ai mund të prodhojë tre përfitime. Së pari, ai promovon një marrëdhënie efektive të punës ndërmjet Komisionit dhe SAI-t. Së dyti, ai kontribuon në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të Komisionit në shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe ndërmarrjen e aktiviteteve përcjellëse. Së fundi, në qoftë se Komisioni dhe SAI kanë një marrëdhënie efektive, ata do të komunikojnë nevojat e tyre për njeri-tjetrin dhe do të përpiqen të jenë reciprokisht të përgjegjshëm dhe të marrin në konsideratë nevojat e njeri-tjetrit.

Si Komisioni dhe SAI, në mënyrë që të komunikojnë me sukses, duhet të marrin në konsideratë më shumë se vendosjen e objektivave specifike, përcaktimin e zonave fokus. Kjo është kritike për të zhvilluar mesazhet strategjike të komunikimit dhe për të përzgjedhur kanalet e duhura të komunikimit. Mesazhet e komunikimit janë deklarata përmbledhëse të çështjeve kryesore që nismëtarët e komunikimit duan të përcjellin në një audiencë të synuar. Informacioni është përshtatur për të siguruar se ai do të kuptohet nga audienca e synuar. Mesazhet e komunikimit duhet të marrin parasysh nevojat për informacion të audiencës së synuar dhe kapacitetet e saj.

Kur formulojnë mesazhet e komunikimit, SAI-t duhet të konsiderojnë pyetjet e mëposhtme:

• Çfarë informacioni duam ne si SAI të përcjellim në Komision?

• Çfarë dëshiron Komisioni të njohë dhe të kuptojë (për shembull, në lidhje me gjetjet e auditimit / funksionin e SAI-t, etj.)?

• Çfarë ndryshimesh do të duam të shohim si SAI në njohuritë apo qëndrimet e Komisionit, si rezultat i komunikimit tonë?

• Cilat janë nevojat e informacionit për Komisionin?

Mesazhet e komunikimit SAI-Komision mund të dërgohen me anë të një kanali ose një kombinim kanalesh të ndryshme komunikimi.

Shembuj të kanaleve të zakonshme për komunikimin SAI-Komision paraqiten si më poshtë.

Kanalet e komunikimit

Komunikimi Mbështetës	*Komunikimi përmes reputacionit*
Përmbledhje informuese	*Broshura*
Shënime informuese	*Prezantime*
Raporte auditimi	*Konferenca*
Prezantime	*Buletine elektronikë*
Deklarata të përbashkëta për mediat	*Botime periodike të shtypura*
Konferenca dhe dokumenta	*Dokumenta të konferencës*
të Konferences"	

Ndikimi i komisioneve parlamentare në punën apo metodologjinë e auditimit të SAI-t

Të 14 SAI-t e vrojtuara në studimet e OECD dhe BB të viteve 2002-2005, raportuan se Komisioni Parlamentar nuk mund të ndërhyjë në punën dhe metodologjinë e auditimit të SAI-t. U vu re se aktivitetet audituese, organizimi dhe metodologjia që do të aplikohet janë prerogativë dhe e drejtë ekskluzive e SAI-t. Procedurat e auditimit të SAI-t nganjëherë janë të përcaktuara me një akt ligjor, në mënyrë që asnjë subjekt i jashtëm të mund të ndikojë në procedurën e auditimit. Komisionet parlamentare nuk mund të ndikojnë metodologjinë e auditimit. Kjo mund të përshkruhet në dispozitat ligjore dhe është zhvilluar në mënyrë të detajuar dhe në mënyrë individuale për çdo auditim nga ana e SAI-t.

Funksione të tjera të Komisionit Parlamentar në lidhje me SAI-n. Propozimet dhe opinionet ligjore te SAI-t

Një nga kriteret bazë të auditimeve të kryera nga SAI është kriteri i ligjshmërisë. Vlerësimi i veprimtarisë së subjekteve të audituara nga pikëpamja e ligjshmërisë, i siguron SAI-t një bazë të gjerë për të përgatitur shënime dhe konkluzione mbi ligjin në fuqi apo ndryshimet e nevojshme të tij. Kjo ka të bëjë, në veçanti, me natyrën e legjislacionit për të cilin SAI-t janë më të shqetësuar, domethënë me legjislacionin e zbatueshëm për financat publike dhe çështje të tjera që i takojnë auditimit, si Ligji i Buxhetit të Shtetit, Akti Normativ i Buxhetit të Shtetit, Ligjit i Prokurimit Publik, Ligji për Kontrollin Financiar, Ligji për Kontabilitetin Akti, ligjet mbi taksat dhe tarifat doganore, Ligji për SAI-n, etj. Në dokumentet e ndryshme të siguruara gjatë auditimit (p.sh. dokumente pune, protokollet e auditimit, deklarata pas auditimit), si dhe në raportet e auditimit, ka vëzhgime dhe vërejtje në lidhje me legjislacionin aktual dhe këshillime lidhur me amendamente, ndryshime e përmirësime që mund t'i bëhen atij.

Shumica e SAI-ve kohë pas kohe i paraqesin sugjerimet dhe propozimet e tyre në formën e mocioneve "de lege ferenda" (me një shikim në ligjet e ardhshme", edhe pse disa prej tyre e shmangin këtë praktikë, të cilën ata e perceptojnë që hyn në fushën e politikës. Si rregull, "Një SAI nuk mund të komentojë mbi çështjet e politikës".

Megjithatë, SAI-t theksojnë ne auditimet e tyre rastet kur zbatimi i politikave çalon në praktikë. Kjo nënkupton dhe programe te Bashkimit Evropian. Ne maj 2012, Gjykata e Auditimit e Holandës i raportoi Parlamentit te Holandës mbi pozicionin e saj dhe mbi auditimin e jashtëm publik te Mekanizmit te Stabilitetit Evropian (ESM), një strukture e themeluar ne BE nga 17 vendet e Eurozonës, pas shpërthimit të krizës botërore ekonomike dhe financiare te vitit 2009, me aftësi kredidhenese në 500 miliardë euro. Sipas SAI-t hollandez, "*Bordi i Audituesve i përcaktuar për ESM ("Zyra e Auditimit" e ESM-së) ka pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë të emëruar nga institucionet e larta të auditimit të 17 vendeve të Eurozonës dhe një nga Gjykata Evropiane e Auditorëve. Bordi është organi i vetëm që mund të japë një pasqyrë të pavarur dhe transparente në rezultatet aktuale të programeve mbështetëse të financuara nga ESM (dmth në përdorimin e rregullt dhe efektiv të fondeve). Auditimi i jashtëm i parashikuar në Traktatin e Romës të BE-së nuk mund të japë një pasqyrë të tillë. Vendet pjesëmarrëse aktualisht po negociojnë akte nënligjore, të cilat do të përfshijnë marrëveshje të mëtejshme me Bordin e Audituesve. Gjykata Hollandeze e Auditimit do të tërheqë vëmendje të veçantë për të dy pikat e mëposhtme:*

1. *Traktati i BE-se nuk parashikon në mënyrë të qartë se çfarë lloj auditimi Bordi mund të kryejë dhe për çfarë arsye. Gjykata e Auditimit rekomandon që aktet nënligjore t'i sigurojnë Bordit një mandat të gjerë, duke përfshirë fuqinë për auditimin e rregullsisë, pajtueshmërinë e politikave, efektivitetin dhe menaxhimin e riskut të programeve mbështetëse të financuara nga ESM në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.*

2. *Marrëveshja përcakton se Bordi i Auditorëve do të raportojë një herë në vit pranë Bordit të Guvernatorëve (ministrat e financave të 17 vendeve të Eurozonë). Gjykata e Auditimit mendon se ky kufizim i Bordit për mundësitë e publikimit të raportit të audituesve është i padëshirueshëm. Aktet nënligjore duhet të përcaktojnë që raporti vjetor publik të përmbajnë të paktën konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga auditimet e Bordit. Gjithashtu do të ishte e këshillueshme për të përfshirë detyrimin e Bordit të Guvernatorëve që të japë përgjigje ndaj këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve. Raporti vjetor i Bordit duhet natyrshëm të vihet në dispozicion të*

parlamenteve kombëtare, të cilët janë përgjegjës për kontrollin demokratik të ESM" [18].

Në praktikë, nismat legjislative zakonisht nuk ndërmerren nga vetë SAI, por me anë të organeve të tjera, kryesisht nëpërmjet komisioneve përkatëse parlamentare-me nismën e një deputeti ose një grupi deputetësh (Shqipëria[edhe Ligji i ri organik për KLSH i vitit 2014, i hyrë në fuqi në janar 2015, i përgatitur nga specialistet e KLSH, DG-Budget dhe SIGMA, u propozua nga një deputet, Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat], Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Letonia dhe Polonia). Asnjë SAI nuk ka fuqinë dhe tagrin për t'i propozuar ligje drejtpërsëdrejti Parlamentit. SAI-t vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të paraqesin në Qeveri draftet e tyre të ndryshimeve apo nismave ligjore. Prandaj, në qoftë se një SAI dëshiron të arrijë disa ndryshime legjislative, kjo para së gjithash kërkon që SAI të konsultohet me komisionet përkatëse parlamentare dhe të tërheqë vëmendjen e tyre për dështimet e rregullimeve ligjore ekzistuese.

Në qoftë se një komision parlamentar bie dakord me propozimet e SAI-t, ai mund të paraqesë një projekt-ligj në seancë plenare. Duhet theksuar, megjithatë, se kjo praktikë nuk është shumë e shpeshtë.

Aktiviteti i një Zyre Kombëtare profesionale auditimi si NAO Britanike sjell shembuj të shumtë propozimesh për ndryshime legjislacioni, të bëra së bashku me Komisionin parlamentar mbi Llogaritë Publike (PAC), sidomos në fushën e mbledhjes së të ardhurave publike. Një raport i NAO-s i publikuar me 21 nëntor 2012 me titull "*Shmangia e taksave: sfida me skemat e shmangies*"[19], jep 93 propozime të NAO-s në periudhën 2004-2011 për ndryshime në Ligjin për Taksat, nëpërmjet Komisionit të Auditimit Publik. Pas Brexit, NAO po punon me intensitet me Komisionin parlamentar

---

[18] *Faqja në internet e Gjykatës së Auditimit të Hollandes. Faqe 2. http://www.courtofaudit.nl/english/Latest_News/All_newsitems/2012/05/Court_of_Audit_on_the_ESM_emergency_fund/Public_external_audit_Board_of_Auditors_of_the_ESM*

[19] *Raporti i NAO-s se Britanise se Madhe Nr. HC 730 SESSION 2012-13, faqe 34. https://www.nao.org.uk/wp-content/uploads/2012/11/1213730es.pdf*

përgjegjës (PAC) për të kontribuar në ndryshimet e ligjeve britanike për tregun e punës, sidomos të ligjit për punësimin[20].

Më e zakonshme është praktika ku SAI jep mendimet e tij mbi projekt-ligje të paraqitura nga institucione të tjera. Kjo mund të bëhet në rrjedhën e punës së qeverisë (Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Letonia, Malta dhe Polonia), ose gjatë punës parlamentare. Zakonisht, këto mendime të SAI-t paraqiten gjatë seancave të komisioneve parlamentare (Bullgaria, Republika Çeke, Letonia, Polonia, Rumania dhe Sllovenia). Në vende të ndryshme ka procedura të ndryshme në dispozicion, duke përfshirë: a) të drejtën e përgjithshme të SAI-t për të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisioneve dhe mundësinë për të paraqitur mendimin e tij për të gjitha projektligjet (vetëm në Poloni); b) përgatitjen e një opinioni mbi një projekt-ligj të dhënë, në bazë të kërkesës nga Parlamenti ose nga organet e tij (Republika Çeke, Letonia dhe Rumania); dhe c) një delegacion-përfaqësi e ekspertëve të SAI-t si konsulentë në debatet për një projekt-ligj të dhënë, me kërkesë nga Komisioni përkatës (Republika Çeke). Në disa vende konsiderohet si veçanërisht e rëndësishme dhe kjo është pjesë e mandatit të SAI-t, për të paraqitur komentet e veta në Projektligjin për Buxhetin e Shtetit (Hungaria dhe Estonia).

Vlen të theksohet se disa SAI i paraqesin opinionet e tyre jo vetëm në projektligjet, por edhe në hartimin e legjislacionit dytësor(vendimet e Këshillit të Ministrave për zbatimin e një ligji), përkatësisht në fazën e konsultimeve të jashtme me degën (ministrinë) përkatëse të ekzekutivit. Në parim, të ofrojnë komente mbi projektligje dhe rregullore të përgatitura nga ministritë qeveritare, apo organe të tjera administrative qendrore, nuk është detyrë e SAI-t, por ata i perceptojnë aktivitete të tilla, si pjesë e përpjekjeve të tyre për të promovuar parimet e menaxhimit të shëndetshëm dhe të përgjegjshëm financiar në administratën shtetërore (Republika Çeke, Estonia dhe Polonia).

[20] http://www.onrec.com/news/news-archive/brexit-what-would-happen-to-uk-employment-law

Roli i komisionit parlamentar në shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të SAI-t

Për të përmbushur mandatin, burimet e veta të duhura financiare duhet të jenë në dispozicion të SAI-t. Në të gjitha vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, Buxheti i Institucionit Suprem të Auditimit përbën një kapitull të veçantë në Buxhetin e Shtetit. Projektbuxheti i SAI-t është i përgatitur nga ai vetë dhe pastaj dorëzohet në qeveri (ose eventualisht edhe drejtpërdrejt në Parlament), për t'u përfshirë në projektligjin për Buxhetin e përgjithshëm të Shtetit. Në disa vende (Qipro, Estonia, Letonia), qeveria ka të drejtë për të ndryshuar draft-Buxhetin e SAI-t. Projektligji mbi Buxhetin e Shtetit paraqitet më pas në Parlament për miratim.

Për këtë arsye, Parlamenti dhe Qeveria shpesh ndikojnë në vendimet lidhur me përmasat e buxhetit të SAI-t. Komisionet parlamentare luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim në pothuajse të gjitha vendet e vrojtuara. Ekzistojnë dy modele themelore:

- Shqyrtimi i projekt-buxhetit të SAI-t kryhet nga një komision buxhetor brenda një procesi të përgjithshëm të miratimit të projekt-Buxhetit të Shtetit (Shqipëria, Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia , Rumania, Republika Sllovake, Sllovenia). Në këtë aspekt, situata në Poloni është pak më ndryshe, pasi Sejmi (Parlamenti polak) ia kalon projekt-Buxhetin e Shtetit për shqyrtim Komisionit të Financave Publike. Pjesë të caktuara të projekt-Buxhetit shqyrtohen edhe nga Komisionet përkatëse. Për sa i përket projekt-Buxhetit të SAI-t, Komisioni i Auditimit Shtetëror është komisioni parlamentar përkatës. Duke shqyrtuar projekt-Buxhetin, komisionet parlamentare dërgojnë qëndrimet e tyre së bashku me mendime ose propozime për ndryshime, tek Komisioni i Financave Publike. Pasi shqyrton pjesët e veçanta të projekt-Buxhetit të Shtetit, si dhe pozicionet(vërejtjet dhe sugjerimet) e paraqitura nga komisionet parlamentare, Komisioni i Financave Publike i paraqet një raport në seancë plenare Sejm-it. Ne vitin 2013, në raportin vjetor të SAI-t polak[21] (NIK), Presidenti i asaj kohe i NIK, z. Jacek Jezierski, , në adresimin e tij drejtuar Parlamentit polak, theksonte:" *Pozicionimi i NIK në procesin*

[21] *Raporti Vjetor "Performanca e NIK 2012", adresimi i ish-Presidentit te NIK, z. Jacek Jezierski, https://www.nik.gov.pl/plik/id,218.pdf*

buxhetor gjithashtu garanton rolin e vet të veçantë në mesin e institucioneve shtetërore. Pas miratimit nga Kolegji i NIK, projekt-buxheti është dërguar direkt në Parlament për miratim. Ministri i Financave nuk është i përfshirë fare në hartimin e planit financiar të NIK. Në këtë mënyrë, buxheti ynë është krejtësisht i pavarur nga organet qeveritare apo institucionet e tjera, të cilat janë të audituarat tona".

- Shqyrtimi i projekt-buxhetit të SAI-t kryhet nga një komision, i vendosur kryesisht për këtë qëllim (rasti i Maltës). Komisioni parlamentar për Llogaritë e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Maltë, rishikon buxhetin e SAI-t si dhe zbatimin e tij dhe paraqet një raport në Parlament për shqyrtimin e këtij buxheti. Bazuar në raportin e Komisionit, Parlamenti pastaj miraton buxhetin e SAI-t.

Në praktikë, roli që komisionet parlamentare luajnë në këtë proces është shpesh vendimtar, pasi ata mund të sugjerojnë rritje (në shumicën e vendeve) ose zvogëlim në shumën e buxhetit të SAI-t dhe nganjëherë ata e bëjnë këtë. Herë pas here, ndryshimi në buxhetin e SAI-t bëhet nën ndikimin e qeverisë, pasi vetë qeveria nuk ka mandat për ndryshimin e projekt-Buxhetin të SAI-t, por ajo mund të bindë Parlamentin për ta bërë këtë.

Shqyrtimi i raportit vjetor të aktivitetit të SAI-t nga ana e komisioneve parlamentare

Në disa nga vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, komisionet parlamentare nuk kanë të drejtë për të shqyrtuar dhe vlerësuar raportin vjetor të aktivitetit të SAI-t (Bullgaria, Qiproja, Estonia, Letonia, Rumania, Republika Sllovake, Slloveni). Në vende të tjera, komisionet e kanë një të drejtë të tillë (Shqipëria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Lituania, Malta dhe Polonia), sidomos kur ky raport është një përgatitje për diskutime të mëtejshme që do të bëhen nga Parlamenti.

Rezultatet e vlerësimit të punës së SAI-t kanë qenë praktikisht gjithmonë pozitive deri më tani. Duhet theksuar, megjithatë, se një vlerësim i mundshëm negativ nuk do ta pengonte, në fakt, SAI-n në punën e tij. Kjo nuk do të thotë se nuk do të merrej parasysh një vlerësim i tillë nga SAI. Komisioni përkatës parlamentar do ta kishte inkurajuar dhe këshilluar SAI-n për të ndrequr dhe për të përmirësuar gjërat dhe

ndoshta për të kërkuar ndihmë profesionale, nëse do të ishte e nevojshme. Në shumicën e vendeve, SAI nuk do të ishte i detyruar zyrtarisht të ndiqte rekomandime të tilla, në funksion të pavarësisë së dhënë atij në Kushtetutë dhe në ligjin përkatës (pavarësi e cila zakonisht siguron që SAI nuk është subjekt i autoritetit apo presionit nga çdo person ose organ publik). Megjithatë, në praktikë, SAI do të përpiqej për të respektuar rekomandimet e Komisionit Parlamentar.

Roli i komisioneve parlamentare në auditimin e SAI-t

Në disa nga vendet anëtare dhe kandidate të BE-së, ligji parashikon që Komisioni Parlamentar ka të drejtë të caktojë ose të sugjerojë auditues të jashtëm për të kryer auditimin vjetor të SAI-t (Shqipëria, Estonia, Hungaria, Malta, Sllovenia). Në vende të tjera, ligji i jep SAI-t të drejtën që ai vetë të zgjedhë një auditues të jashtëm (Republika Çeke, Letonia), ose që ta kryejë vetë auditimin e vet (Bullgaria, Kroacia, Qipro). Në Republikën Sllovake, Ministria e Financave kryen auditimin e SAI-t. Në Poloni - sipas Ligjit të Dhomës Supreme të Kontrollit, NIK-ut – është Sejmi, Parlamenti që do të mbikëqyrë zbatimin e buxhetit të NIK. Një zgjidhje e ngjashme ekziston dhe në Lituani.

Në disa nga vendet e vrojtuara, rezultatet e auditimit vjetor të SAI-t i paraqiten Komisionit parlamentar përkatëse për informacion ose rishikim (Republika Çeke, Hungaria, Malta, Rumania). Më shpesh, auditimi i SAI-t është një auditim financiar (Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Republika Sllovake, Sllovenia); rrallë është auditimi i performancës (i planifikuar në Bullgari dhe Estoni).

Raporti Parlament, komisione të tij dhe SAI pare nga këndvështrimi i një SAI. Raport themeltar për mirëqeverisjen

Çdo diskutim i marrëdhënieve në mes të një SAI dhe Parlamentit të tij, si dhe të hapave që mund të ndërmerren për t'i përmirësuar këto marrëdhënie, duhet të fillojë duke njohur raportin simbiotik që në mënyrë ideale ekziston në mes të këtyre institucioneve të rëndësishme, por të ndara. Sikurse e ka cilësua Anders B. Johnsson,

Sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndër Parlamentar Ndërkombëtar (IPU), "*Parlamentet dhe SAI-t janë të domosdoshëm për njëri-tjetrin*[22]".

Parlamenti mund të kryejë funksionet e tij mbikëqyrëse vitale në mënyrë më efektive kur ai përdor - dhe mund të mbështetet mbi - punën e auditimit të një SAI. Në mënyrë të ngjashme, një SAI mund të jetë shumë më efektiv atëhere kur Parlamenti dhe komisionet e tij i sigurojnë edhe një forum për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve të tij, si dhe, potencialisht, shërbejnë si një aleat në marrjen në konsideratë ose inkurajimin e fuqishëm të veprimtarëve të tjerë, kryesisht Ekzekutivi. që të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese, të kërkuara nga rekomandimet e SAI-t.

Më sipër pamë praktikat e deritanishme, të ilustruara me shembuj konkretë, në marrëdhëniet ndërmjet SAI-ve dhe komisioneve parlamentare në vendet e BE-se dhe në vendet kandidate për në BE. Prej këtyre praktikave rezultojnë natyrshëm rekomandimet për përmirësimin e marrëdhënieve SAI-Parlament, që mund të konsiderohen si udhëzime të mundshme, si për SAI-n dhe për komisionet parlamentare .Duke qenë se marrëdhëniet formale dhe ligjore mes SAI-t dhe Parlamentit ndryshojnë shumë midis vendeve të ndryshme si në BE dhe mes vendeve kandidate, si komisionet parlamentare dhe SAI duhet padyshim t'i shohin këto rekomandime në kontekstin e situatës së veçantë ku ndodhen, si dhe në kuadrin e sistemit parlamentar të vendit përkatës.

Pavarësisht nga dallimet në strukturën organizative dhe vendndodhjen formale në strukturën e Shtetit, pothuajse të gjithë SAI-t kudo në botë njohin rëndësinë e:

- Sigurimit të pavarësisë së plotë të SAI-t në përcaktimin e prioriteteve të auditimit dhe në mënyrë të drejtë, faktikisht dhe objektivisht në raportimin e rezultateve të auditimit dhe njëkohësisht

- Fitimit të vëmendjes së duhur parlamentare ndaj rezultateve të auditimit, si një hap jetik në marrjen e masave korrigjuese për problemet e rëndësishme të qeverisjes publike të konstatuara gjatë auditimeve.

T'i pajtosh ose përputhësh të dyja këto objektiva kërkon një qëndrim dhe veprim balancues të kujdesshëm. Të qenit shumë afër në një marrëdhënie me Parlamentin

---

[22] *Anders B. Johnsson: Fjala në Konferencën e INTOSAI-t Fuqizimi i Auditimit Publik të Jashtëm ne Rajonet INTOSAI », 26-27 maj 2010, Vjene, Austri, faqe 51, http://www.intosai.org/uploads/intosaipublikation02112010small.pdf*

mund të kërcënojë pavarësinë e SAI-t, e cila përbën themelin më të rëndësishëm për besueshmërinë e SAI-t. Nëse marrëdhënia SAI-Parlament është shumë e largët, Parlamenti mund të injorojë gjetjet e rëndësishme të SAI-t gjatë auditimeve. Çdo SAI duhet të gjykojë dhe punojë sa më të mirë për të ruajtur ekuilibrin e duhur në këtë marrëdhënie delikate , duke marrë parasysh rrethanat e tij unike kombëtare.

Rekomandimet e mëposhtme duhet të shikohen nga perspektiva e SAI-ve. Megjithatë, disa rekomandime mund edhe të diskutohen me Komisionin Parlamentar përkatës, në rastin kur ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në punën e Komisionit ose përbëjnë kryesisht një shqetësim për të.

Rekomandimet mund të konsiderohen në dy grupime kryesore. Grupi i parë përfshin veprime që një SAI duhet të marrë (në qoftë se ai ende nuk i ka ndërmarrë) për të siguruar se ai është i përgatitur plotësisht për t'i ofruar ndihmë efektive dhe të besueshme Parlamentit dhe komisioneve të tij në mbikëqyrjen e aktiviteteve shtetërore dhe qeveritare. Në parim, këto janë veprime brenda sferës së veprimtarisë së SAI-t, edhe pse disa prej tyre mund të kërkojnë miratimin parlamentar të burimeve shtesë buxhetore.

Ne prezantimin e tij "Marrëdhëniet Parlament-SAI si një nga përparësitë afatgjatë të Auditimit Shtetëror" në Përmbledhjen "Auditimi Suprem ka rëndësi-Praktika të Gjykatës Turke të Llogarive-, në maj 2016, Prof. Dr. Rejai Akyel, ish-President i Gjykatës se Llogarive të Turqisë, sot anëtari më i vjetër i kësaj Gjykate, thekson se "*Parlamenti është i adresuari kryesor i raporteve të auditimit të SAI-t, edhe pse SAI ka disa palë të tjera të interesuara. Prandaj, lidhja mes Parlamentit dhe SAI-t duhet të bazohet në këtë mirëkuptim dhe interes. Veprimet administrative dhe buxhetore kryhen në mënyrë më efektive kur Parlamentet mbështesin dhe të ndjekin zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në raportet e auditimit të SAI-t dhe që kërkohen të zbatohen nga administrata publike.*"[23]

Grupi i dytë i rekomandimeve përfshin veprime që Parlamenti dhe komisionet e tij mund të ndërmarrin (*në qoftë se ende ata nuk e kanë bërë tashmë këtë*) për të forcuar funksionet e tyre mbikëqyrëse dhe përdorimin e punës audituese të SAI-t në këtë drejtim. Sigurisht që një SAI nuk ka autoritet (dhe as nuk duhet ta ketë) të instruktojë Parlamentin se si ky i fundit duhet të veprojë për të realizuar përgjegjësitë e veta kushtetuese. Prandaj dhe këto rekomandime duhen mirëkuptuar si çështje që drejtuesi i një SAI mund të dëshirojë të diskutojë me drejtuesit e Parlamentit dhe të

[23] *Auditimi Suprem ka rëndësi-Praktika të Gjykatës Turke të Llogarive.* http://www.sayistay.gov.tr/tr/Upload/95906369/files/yayinlar/Supreme%20Audit%20Matters.pdf

komisioneve përkatëse për të forcuar mbikëqyrjen parlamentare të aktiviteteve shtetërore dhe qeveritare.

Rekomandime për t'u zbatuar nga SAI

Këto janë hapa që SAI mund të dëshirojë t'i ndërmarrë - në qoftë se ai ende nuk e ka bërë tashmë - për të rritur efektivitetin e tij të auditimit dhe dobinë e tij potenciale në mbikëqyrjen parlamentare.

A) SAI duhet t'i demonstrojë Parlamentit dhe komisioneve të tij se ai është një organ profesional dhe i përgatitur për të ndihmuar në një mënyrë profesionale. SAI, në mënyrë që të arrihet kjo, duhet të sigurojë që stafi i tij, i marrë si një i tërë, i ka njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer gamën e plotë të auditimeve, të cilat do të jenë me vlerë për Parlamentin dhe komisionet e tij. Në varësi të rrethanave, në një SAI të caktuar, kjo mund të kërkojë secilën ose të gjitha masat si në vijim:

- Miratimin e standardeve të duhura të auditimit;
- Zhvillimin dhe promovimin e manualeve të auditimit që pasqyrojnë këto standarde;
- Trajnimin e stafit për të siguruar që standardet dhe procedurat janë kuptuar dhe mund të zbatohen;
- Rekrutimin e stafit për të mbushur boshllëqet kritike në aftësitë e nevojshme;
- Rishikim(të brendshëm dhe të jashtëm) mes kolegëve (termi në anglisht: "peer review"), për të siguruar që puna aktuale e auditimit është në përputhje me standardet dhe procedurat e njohura ndërkombëtarisht.

B) SAI duhet të sigurojë që stafi i tij i kryen detyrat e veta me objektivitetin dhe profesionalizmin e duhur. Kjo mund të kërkojë secilën ose të gjitha masat e mëposhtme:

- Miratimi i standardeve të duhura etike dhe rregulloreve të brendshme për zbatimin e këtyre standardeve që mbulojnë, ndër të tjera, shmangien e konflikteve personale dhe financiare me interes dhe konsideratë të papërshtatshme të faktorëve politike partiake;

- Trajnim për standardet dhe mbi rëndësinë e objektivitetit dhe profesionalizmit në kryerjen e auditimeve dhe në raportimin e rezultateve të auditimit;

- Procedurat e rishikimit për të siguruar përputhjen me standardet.

C) SAI duhet të marrë në konsideratën e duhur shqetësimet dhe gjykimet parlamentare në përcaktimin e prioriteteve të tij të auditimit. Edhe pse SAI duhet të veprojë në mënyrë të pavarur, lidhjet e tij me Parlamentin, sidomos me komisione të caktuara, janë shpesh të gjera. Është e pashmangshme - dhe madje e dëshirueshme - që SAI duhet të jetë i vetëdijshëm për nevojat dhe interesat e Parlamentit dhe të ekzekutivit. Ai duhet t'i marrë ato në konsideratë në përcaktimin e prioriteteve të tij, ndërsa siguron që po plotëson përgjegjësitë e veta të tjera. SAI-t që dëshirojnë të promovojnë marrëdhënie më të ngushta pune me Parlamentin dhe me komisionet e tij, duhet të jenë të hapur për të marrë parasysh pikëpamjet parlamentare mbi objektivat dhe prioritetet e auditimeve që kryejnë. Krijimi i një njësie ndërlidhëse mund ta lehtësojë këtë. Është e domosdoshme, megjithatë, që pikëpamjet e parlamentare mbi auditimet të mos jenë pika e vetme e referimit në këtë drejtim dhe që SAI të ruajë diskrecionin e tij për të pranuar ose refuzuar sugjerimet nga Parlamenti dhe për të kryer auditime me nismën e vet, pavarësisht nga pikëpamjet parlamentare. Një arsye për këtë është se, nëse SAI bëhet shumë i përqendruar në reagimin ndaj interesave parlamentare, puna e tij mund të anojë nga shqetësimet dhe përparësitë afatshkurtra partiake, në mënyra që do ta dëmtonin perceptimin e pavarësisë së SAI-t dhe kështu edhe besueshmërinë e tij. Një tjetër arsye është se anëtarët e parlamentit mund të kenë interesa dhe një axhendë afat-shkurtër. Kështu ata mund të vendosin si një prioritet më i ulët arritjen e përmirësimeve afatgjata në menaxhimin financiar dhe çështje të tjera në mirëqeverisje, me prioritet të lartë për SAI-n.

D) Mënyra me të cilën SAI i raporton rezultatet e auditimit mund të ketë një efekt të konsiderueshëm në reagimin parlamentar ndaj raporteve të auditimit. Në atë masë që ai ka maturi në këtë drejtim, një SAI duhet të jetë mjaft selektiv në zgjedhjen e raporteve të auditimit që i paraqiten Parlamentit dhe komisioneve të tij. Në mënyrë tipike, anëtarët e Parlamentit janë njerëz shumë të zënë, me materiale të shumta për lexim që ju jepen atyre, shumë më tepër nga sa ata mund të trajtojnë. Shumë raporte të auditimit përfshijnë çështje administrative të cilat është mirë të trajtohen duke punuar me ministrinë përkatëse ose me Ministrinë e Financave, në vend që të kërkohet vëmendja parlamentare. Është e domosdoshme një përzgjedhje materialesh për Parlamentin, nga ana e SAI-t.

Në përgjithësi, për të shmangur mbingarkesën e deputetëve, do të ishte më mirë nëse raportet e auditimit mbi këto çështje të jenë paraqitur paraprakisht në ministrinë respektive, me përmbledhjet periodike të përcaktuara për Parlamentin dhe komisionet përkatëse për informimin e tyre. Në parim, SAI duhet t'i raportojë vetëm Parlamentit për çështje që ai beson se me të vërtetë meritojnë vëmendjen parlamentare. Këto mund të përfshijnë raportet e auditimit që zbulojnë probleme të veçanta të një rëndësie të tillë, që kërkojnë presionin nga Parlamenti, ose veprim legjislativ, i cili mund të jetë i nevojshëm për të zgjidhur problemin, ose raportet e auditimit që zbulojnë një dukuri të qëndrueshme të një ose më shumë ministrive, të cilat dështojnë për të marrë veprimet korrigjuese për mangësitë e gjetura nga auditimet. Përveç kësaj, mund të ketë kërkesa të përcaktuara me ligj që raporte të caktuara auditimi të adresohen në Parlament (p.sh. raporti për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të një viti më parë, etj.).

E) Raportet e auditimit të SAI-t, të cilat konsiderohen të kenë pragun e duhur të materialitetit (janë të rëndësisë së duhur), duhet t'i paraqiten Parlamentit ose komisionit përkatës, me një deklaratë të qartë se pse besohet që ato kërkojnë vëmendjen parlamentare. Raportet e zgjedhur që respektojnë konceptin e materialitetit për Parlamentin mund të përfshijnë gjetje, vërejtje, komente dhe rekomandime si në fushat e mëposhtme:

- Auditimi i pasqyrave financiare të qeverisë;
- Auditimet e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë;
- Auditimet e performancës ose të vlerës së parasë të shërbimeve publike;
- Hetime të ndryshme;
- Analiza e raporteve të mëparshme të auditimit të një natyre të përbashkët;
- Dokumentet këshillimore;
- Propozimet dhe komentet mbi draft-ligje;
- Udhëzime mbi praktikat e mira.

Stili i të shkruarit i raporteve të auditimit gjithashtu mund të luajë një rol të rëndësishëm në ngjalljen e interesimit të duhur nga ana e anëtarëve të Parlamentit, për çështjet e ngritura në raport. Raportet duhet të jenë të qartë dhe koncizë, por

me prova të mjaftueshme për të bindur një lexues objektiv, duke përfshirë anëtarët e Komisionit, për vlefshmërinë e gjetjeve të auditimit.

Disa SAI e kanë gjetur veçanërisht të dobishme në këtë drejtim për të përfshirë një përmbledhje të shkurtër ekzekutive në raport, në mënyrë që të përcjellin gjetjet dhe rekomandimet kryesore shpejt, lehtë dhe qartë për lexuesit që janë shumë të zënë me punë. Raportet e auditimit duhet të jenë të shkruara në një mënyrë të drejtë dhe faktike dhe të merren me çështje të rëndësishme në kohën e duhur, që t'i sigurojnë Komisionit Parlamentar mënyrën profesionale dhe serioze me të cilën është kryer auditimi dhe raporti i shkruar i SAI-t, duke përforcuar kredibilitetin e rezultateve të auditimit.

Raportet duhet të jenë të balancuara, pa qëndrime në favor të ndonjë partie, jo-ideologjike dhe e shkruar në kushtet e legjislacionit, për të shmangur konflikt me Komisionet parlamentare. Raportet e auditimit zakonisht kanë të bëjnë me kontrollin financiar, me menaxhimin e duhur të fondeve publike dhe zbatimin nga ana e qeverisë të politikave të saj, por jo të bëjnë politika qeverisëse ato vetë. SAI-t duhet të jenë krejtësisht apolitike. Në parim, SAI-t duhet të shmangin komentet mbi politikat e qeverisë. Në praktikë, megjithatë, paraqitja dhe zbulimi i problemeve në zbatimin e këtyre politikave mund të ngrenë pyetje të pashmangshme lidhur me vetë politikat e qeverisë. Këtu SAI duhet të tregohet shumë i kujdesshëm, pasi sikurse e thekson edhe Audituesi i Përgjithshëm i GAO-s, z. Gene L. Dodaro në Përshëndetjen e tij drejtuar KLSH me rastin e 90-Vjetorit të krijimit, "Ne nuk bëjmë politika. Ne auditojmë zbatimin e politikave qeveritare". [24]

Shumë SAI e kanë gjetur të dobishme për të krijuar një njësi ose për të pasur një person të veçantë për të koordinuar kontaktet e SAI-t me Parlamentin. Përgjegjësitë e njësisë mund të përfshijnë mbajtjen e kontakteve ditore dhe komunikimin me Komisionet parlamentare përkatëse. Në këtë cilësi, njësia ndërlidhëse me Parlamentin mund të sigurojë se SAI të jetë e vetëdijshme për interesat aktuale parlamentare dhe shqetësimet që mund të duhet të merren parasysh në zhvillimin e programit të auditimit vjetor të SAI-t. Njësia mund të sigurojë që deputetët e interesuar të mbahen të informuar për punën e SAI-t që mund të jetë me interes të drejtpërdrejtë për ta. Njësia ndërlidhëse mundet po ashtu të sigurojë një mjet ose pistë të dobishme komunikimi përmes të cilës deputetët mund t'i përcjellin pikëpamjet e tyre SAI-t për çështjet me interes të përbashkët. Informatat e mbledhura nga njësia ndërlidhëse në lidhje me pikëpamjet parlamentare për punën

[24] *Gene L. Dodaro, 25 maj 2015, http://www.klsh.org.al/web/pub/albumi_i_klsh_2264_1.pdf*

e SAI-t duhet të ndahen me drejtuesit e SAI-t. Njësia ndërlidhëse mund të ndihmojë gjithashtu të bashkërendojë punën e njësive ose departamenteve të ndryshme të SAI-t me Komisionet Parlamentare.

Ndjekja e çështjeve të auditimeve kryesore të viteve të mëparshme duhet të përfshihet në programin vjetor të auditimit të SAI-t, në mënyrë që të sigurojë që masat e duhura janë marrë nga të audituarit. SAI duhet t'i vërë rezultatet e këtij rishikimi në dispozicion të Komisioneve përkatëse, veçanërisht në qoftë se ka një trend mosveprimi nga ana e Ekzekutivit në adresimin e problemeve të rëndësishme të vërejtura në auditime. Rishikimi duhet gjithashtu të përgatitet, kur është e përshtatshme, për të ndihmuar komisionet përkatëse në shqyrtimin e çështjeve të ndjekjes parlamentare të rekomandimeve të SAI-t.

Çështje që drejtuesit e SAI-t mund të dëshirojnë të diskutojnë me anëtarët e Parlamentit

Këto çështje përfshijnë veprime që janë plotësisht brenda sferës së Parlamentit. Në raste të përshtatshme, drejtuesi(ose drejtuesit, kur është organ kolegjial) i SAI-t mund ta gjejë të e dobishme për t'i diskutuar këto çështje me drejtuesin e Parlamentit dhe me deputetë të tjerë, të cilët janë të interesuar në përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare. Është e rëndësishme të theksohet, megjithatë, se SAI duhet gjatë gjithë kohës të shmangë çdo qasje që jep të kuptojë se ai po kërkon të udhëzojë Parlamentin se si ky i fundit të kryejë sa më mirë përgjegjësitë e veta kushtetuese. Përkundrazi, SAI duhet të theksojë natyrën simbiotikë (në simbiozë, në përputhje, dakordësi të plotë) të marrëdhënieve mes Parlamentit dhe SAI-t, hapat që SAI ka marrë për ta bërë veten më të dobishëm për Parlamentin, si dhe të propozojë veprimet e mëposhtme si masa që Parlamenti mund të marrë për të rritur dobinë e SAI-t në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare.

Veprimet që ndikojnë drejtpërdrejt marrëdhëniet SAI-Parlament

1. SAI të përcaktojë në mënyrë të qartë, në legjislacionin e auditimit suprem shtetëror, llojin e raporteve të auditimit dhe dokumentet e tjera që SAI duhet t'i paraqesë Parlamentit. Në mënyrë ideale, do të kishte një numër raportesh auditimi të vlefshme për t'u përzgjedhur, pasi dihet se ato janë dokumente të rëndësishme shtetërore, që të justifikojnë (ose kërkojnë) vëmendjen parlamentare. Auditimi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit është një shembull i tillë. Raporte të tjera të auditimit duhet të paraqiten në Parlament, ose në një prej komisioneve të tij të

dedikuar, vetëm nëse kërkohet ose nëse konsiderohet nga SAI që meritojnë vëmendjen parlamentare.

2. SAI të bëjë të mundur që të miratohet nga Parlamenti një legjislacion i auditimit shtetëror suprem, i cili të garantojë që SAI nuk është në asnjë mënyrë ose formë në varësi të Ekzekutivit, por i përgjigjet vetëm Parlamentit. SAI duhet të jetë i pavarur nga institucionet e tjera, sepse kjo pavarësi, së bashku me kompetencën dhe integritetin e stafit të tij, janë themelet për kredibilitetin e SAI-t, dhe si pasojë për ndikimin e tij në Parlament, Ekzekutiv dhe në publik në përgjithësi.

3. Emërimi i Kryetarit të SAI-t të bëhet në mënyrë të tillë që ai / ajo të gëzojë në Parlament sa më shumë konsensus që të jetë e mundur. Kjo mund të bëhet nga Parlamenti ose Presidenti(kur Kryetari caktohet me propozim të tij), me ndërmarrjen e konsultimeve të gjera në mesin e të gjitha partive të përfaqësuara në Parlament, përpara se sa të bëhet zgjedhja e Kryetarit të SAI-t me një shumicë të thjeshtë apo të cilësuar të të gjithë deputetëve. Për më tepër, drejtuesi i SAI-t nuk duhet të hiqet lehtë gjatë mandatit të tij / saj, përveçse për arsye të specifikuara të vlefshme, të tilla si arësye të forta shëndetësore, mashtrim apo paaftësi për të vazhduar për të kryer detyrat. Për ta mbrojtur dhe më tej drejtuesin e SAI-t nga çdo presioni i mundshëm politik dhe nga një shkarkim i padrejtë, çdo propozim për heqjen e tij duhet të jetë e nevojshme të ketë një kuorum për të treguar konsensus të gjerë (të themi, dy të tretat e shumicës) në Parlament.

4. Që SAI të jetë i besueshëm dhe sa më i dobishëm për Parlamentin në funksionet e tij mbikëqyrëse, ai duhet të shihet, si në Parlament dhe nga çdo institucion tjetër, si një entitet i pavarur, që ushtron i lirë gjykimin e vet në lidhje me çështjet brenda fushës së tij të përgjegjësisë. Marrëdhënia e Parlamentit dhe e komisioneve të tij me SAI-n duhet të shihet si bashkëpunuese. Në këtë drejtim, SAI duhet të ketë fuqinë dhe lirinë për të zgjedhur çështjet, temat që do të jenë subjekt i auditimit (përveç atyre që janë të detyruara me ligj) dhe për të vendosur se si t'i kryejë sa më mirë këto auditime. Në të njëjtën kohë, Parlamenti dhe komisionet e tij kanë një interes të ligjshëm si në programin e auditimit të SAI-t në përgjithësi, ashtu dhe të kërkojnë mbulim me auditim të çështjeve me interes të veçantë për ta.

Momenti i prezantimit të planit vjetor të auditimeve te SAI-t duhet të jetë një moment i rëndësishëm për raportet SAI-Parlament, moment të cilin SAI mund ta shfrytëzoje për të dhënë mesazhe kryesore për punën e tij të ardhshme njëvjeçare. Dr. Vitor Caldeira, President i Gjykates Evropiane te Audituesve, në fjalën e tij përpara Komisionit të Kontrollit Buxhetor të Parlamentit Evropian ne janar 2016, ndërsa

prezantonte planin e auditimeve te ECA-s, theksonte se" ...*Unë do të doja të theksoj disa nga auditimet specifike në lidhje me ato prioritete mbi të cilat ne kemi në plan të fillojmë të punojmë këtë vit. Siç thashë në fillim, përmirësimi i ekonomisë dhe krijimi i vendeve të punës mbetet një prioritet kyç për BE-në. Në vitet e fundit ne kemi përparësi auditimin e masave të punësimit të të rinjve. Në vitin 2016, ne do të kthejmë vëmendjen tonë drejt përpjekjeve për të përmirësuar ekonominë me forcimin e tregut të brendshëm, duke përfshirë iniciativa që lidhen me agjendën digjitale të Komisionit Evropian. Në veçanti, kemi në plan për të filluar auditime për mbështetjen e lëvizshmërisë së punëtorëve me shpejtësi të lartë, në përmirësimin e infrastrukturës si dhe rrjeteve rrugore dhe hekurudhore, si dhe në iniciativat për të hequr barrierat për një treg të vetëm dhe për të përmirësuar rregullimin e shërbimeve financiare. Ekonomia evropiane vetëm do të zhvillohet dhe të rritet në një atmosferë të qeverisjes së shëndoshë financiare dhe ekonomike. Kjo gjithashtu do të vazhdojë të jetë një prioritet i auditimit. Në vitin 2016, Gjykata ka në plan për të raportuar mbi ndihmën financiare për shtetet anëtare të BE-së, mbi procedurat e trajtimit të defiçitit të tepruar dhe mbikëqyrjen e agjencive të vlerësimit të kreditit të BE-së, bazuar në auditimet e filluara vitin e kaluar. Përveç kësaj, Gjykata ka në plan për të audituar e Mekanizmin e ri të Vetëm Mbikëqyrës dhe Mekanizmi e Vetëm të Zgjidhjeve, për herë të parë, si dhe për të filluar punën në vlerësimin për pesë vitet e para në funksionimin e Semestrit Evropian. Politika e energjisë për ne mbetet prioritet*".[25]

Komisionet parlamentare duhet të jenë në gjendje t'i sugjerojnë SAI-t temat e auditimit për të cilat ata kanë një shqetësim i veçantë dhe SAI duhet t'i konsiderojë seriozisht propozime të tilla. Duke bërë këtë, është e rëndësishme që komisionet parlamentare të ndërgjegjësohen se çdo propozim i tyre për t'u përfshirë në programin vjetor të auditimit të SAI-t, ose si kërkesë shtesë ndaj programit të auditimit, duhet domosdoshmërisht të konsiderohet nga SAI në dritën e prioriteteve të tij në auditim, të fondeve buxhetore dhe kufizimeve të stafit auditues, si dhe që vendimi përfundimtar i takon SAI-t.

5. Kontaktet ndërmjet SAI-t dhe Komisionit Parlamentar duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë, për të krijuar një regjim të qëndrueshëm të marrëdhënieve ndërmjet tyre. Në disa vende, veçanërisht ato në të cilat SAI punon gjerësisht me disa komisione të Parlamentit, është gjetur e dobishme të përgatiten procedurave të

---

[25] *Dr. Vitor Caldeira, Fjala e prezantimit të planit vjetor të punës së ECA-s, janar 2016. Faqe 2.* http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/Speech_WP2016/speech-WP2016-EN.pdf

shkruara që rregullojnë marrëdhëniet, procedura të përgatitura bashkërisht nga SAI dhe nga udhëheqja parlamentare. Shkalla e kontakteve midis SAI-t dhe Komisionit në një masë të madhe varet nga kërkesat e Kryetarit të Komisionit dhe të anëtarëve të tij. Ata mund të ndryshojnë nga një nivel shumë i lartë (në mes të Kryetarit të SAI-t dhe Kryetarit të Komisionit), në një nivel më të ulët (për shembull, në mes të stafit të Komisionit dhe audituesve të SAI-t të përfshirë drejtpërdrejt me raportin e auditimit që shqyrtohet).

6. Vendosja e rregullave dhe procedurave të qarta parlamentare për mënyrën me të cilën Parlamenti dhe komisionet e tij do të merren me raportet e auditimit që SAI u ka paraqitur atyre. Nëse nuk ka të paktën një Komision Parlamentar që të ketë përgjegjësi të qarta për t'u marrë me raportet e auditimit të SAI-t, Parlamenti mund të synojë të marrë në konsideratë përfitimet e të paturit të një ose disa komisioneve të tilla. Ekzistenca e një ose më shumë komisioneve parlamentare përgjegjëse për reagimin ndaj raporteve të auditimit të SAI-t ndihmon për të përqendruar vëmendjen e qeverisë dhe publikut në gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga raportet e auditimit dhe për të ushtruar presion tek Ekzekutivin për zbatimin e rekomandimeve të tilla. Vendimi nëse duhet të ketë një ose disa Komisione Parlamentare të caktuara që do të merren me raportet e auditimit, i takon Parlamentit ta marrë. Si në rastin kur Parlamenti zgjedh të ketë vetëm një komision për auditimet, dhe kur ai zgjedh për disa, çdo zgjedhje ka përfitimet e veta. Modelet e sistemeve efektive të marrëdhënieve Komision Parlamentar – SAI në vende me tradita të ngjashme politike dhe sociale mund të përdoren si shembuj të praktikës së mirë për t'u ndjekur. Praktika tregon shumë shembuj të vendeve me sisteme të avancuara dhe efektive të marrëdhënieve SAI – Komision Parlamentar.

7. Caktimi i një Komisioni Parlamentar për t'u marrë (jo domosdoshmërisht në mënyrë ekskluzive) me pasqyrat financiare dhe aktivitetet e SAI-t, për t'u siguruar se Parlamenti është në gjendje për të monitoruar edhe vetë SAI-n, e jo vetëm raportet e tij. Funksionet e një Komiteti të tillë (që gjendet në disa vende), mund të përfshijnë:

- Shqyrtimin dhe miratimin e projekt-buxhetit të SAI-t;

- Emërimin e audituesve të jashtëm për të audituar pasqyrat financiare të SAI-t, si dhe rishikimin dhe miratimin e pasqyrave të tilla financiare të audituara;

- Vlerësimin i aktiviteteve të auditimit të SAI-t.

8. Përcaktimin në mënyrë të qartë në legjislacion të së drejtës së SAI-t për t'i bërë publike raportet e auditimit brenda një afati të arsyeshëm, pas paraqitjes së

raporteve të tilla në Parlament ose në institucione të tjera, sipas rastit. Në të njëjtën kohë, raporte të caktuara të auditimit (paraqitur në Parlament ose ndryshe) mund të jenë, në një farë mase, të natyrës së sigurisë kombëtare, të ndjeshme nga ana komerciale, të natyrës së nën-gjyqësorit ose të kenë natyra të tjera të fshehta apo sensitive, që nuk do të ishte mirë të diskutoheshin në publik, për shkak të pasojave negative jo në interes të publikut. Edhe pse raste të tilla duhet të jenë po aq të rralla e të pazakonta sa të jetë e mundur, do të ishte e përshtatshme nëse SAI do të kishte autoritetin të refuzonte për t'i bërë raporte të tilla publike. SAI-t mund t'i sugjerojnë Komisionit Parlamentar përkatëse që një raport i tillë, ose ekstrakte të tij, të diskutohen vetëm nga Komisioni, në rast se Komisionet e tjera kanë vendosur tashmë të mos e diskutojnë.

Veprimet që mund të rrisin rolin e Komisioneve Parlamentare

Çështjet e mëposhtme, të cilat gjithashtu mund të ofrohen për diskutim e shqyrtim nga deputetët, kanë të bëjnë me mënyrat e forcimit të veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare që mund të thirren për t'u marrë me raportet e auditimit të SAI-t, por që gjithashtu do të mund të rrisin efektivitetin e Komisioneve Parlamentare në rolet e tyre të tjera. Përderisa përbërja dhe mënyra e funksionimit të Komisioneve Parlamentare mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga një vend në një tjetër, disa nga këto sugjerime duhet të shikohen sipas kushteve specifike të organizimit parlamentar.

Elementet që janë gjetur në shumicën e komisioneve parlamentare dhe që konsiderohen të jenë të një rëndësie të veçantë për funksionimin e duhur të një Komisioni (zakonisht rregulluar me Statute te Parlamentit për funksionimin e Komisioneve ose me ligj) përfshijnë:

- Kuorumin e përcaktuar të numrit të anëtarëve që një takim i Komisionit të konsiderohet i vlefshëm dhe për marrjen e vendimeve në Komision

- Fuqia e Komisionit për të thirrur cilindo person (qoftë ky ministër, drejtor institucioni qendror, gjykatës, prokuror, etj.) për të dëshmuar në takimet e Komisionit dhe për të kërkuar çdo informacion të rëndësishëm për çështjen e auditimit në shqyrtim.

- E drejta e Komisionit për të kërkuar informacion shtesë me shkrim nga çdo person që ka lidhje me çështjen e auditimit në shqyrtim.

- Përbërja e komisioneve parlamentare pasqyron përbërjen politike të partive në Parlament. Megjithatë praktika njeh shumë raste kur merren masa kundërpeshuese, si për shembull, për të siguruar që funksionimi i Komisionit Parlamentar të kryhet sa më shumë që të jetë e mundur, në një mënyrë jo-politike, zgjidhet Kryetari i Komisionit Parlamentar(sidomos i një Komisioni që është përgjegjës për mbikëqyrjen e SAI-t) një anëtar nga një parti opozitare. Një qasje alternative është kur rregullorja parlamentare siguron që anëtarët e Komisionit që nuk pajtohen me shumicën kanë të drejtë të paraqesin një raport të pakicës.

- Të sigurohet personel i mjaftueshëm mbështetës për të ndihmuar Komisionet Parlamentare në detyrat e tyre. Komisionet parlamentare duhet të jenë në gjendje të përdorin ekspertë të pavarur, sa here kanë nevojë për ekspertizën e tyre. Kjo mund të përfshijë dërgimin e të paktën një eksperti nga stafi i SAI-t për të ndihmuar Komisionin në funksionet e tij të raportimit. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për përgatitjen e raporteve të ndjekjes parlamentare ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.

Në shumë vende, është gjetur e dobishme lejimi i publikut të gjerë dhe mediave të jenë të pranishëm gjatë takimeve të Komisionit Parlamentar, me qëllim nxitjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit nga publiku i gjerë ndaj çështjeve që trajtohen nga Komisioni. Përjashtimi më i rëndësishëm nga ky rregull duhet të jenë ato takime ku çështjet janë mbajtur në mënyrë të veçantë të pa ekspozuara, për shkak të ndjeshmërisë apo të implikimeve të sigurisë kombëtare për nga natyra e tyre.

Përvoja e shumë SAI-ve tregon se ndikimi i raporteve të auditimit mbi qeverinë është rritur, kur një Komision Parlamentar i shqyrton këto raporte menjëherë. Sipas raportit të auditimit të NAO-s britanike për ecurinë e të ardhurave buxhetore nga taksat dhe doganat[26], gjatë viteve 2004-2011, rekomandimet e NAO-s, të rimarra edhe nga Komisioni Parlamentar për Llogaritë Publike, kanë mundur të sjellin 93 përmirësime e ndryshime në Ligjin për Taksat në Britaninë e Madhe.

Kur SAI këshillon Komisionin Parlamentar përkatës në lidhje me një raport auditimi të rëndësishëm të së ardhmes së afërt, Komisioni duhet të përpiqet për të diskutuar

[26] *Raporti i NAO-s Nr. HS 730, sesioni 2012-2013 mbi skemat e shmangies se taksave. Faqe 4.* https://www.nao.org.uk/wp-content/uploads/2012/11/1213730es.pdf

raportin brenda një afati kohor të arsyeshëm, për të shmangur rrezikun që gjetjet në raportin e auditimit të bëhen të vjetërsuara.

Ashtu sikurse SAI duhet të përgatitet për takimet e Komisionit Parlamentar, mund të provohet e dobishme që edhe Kryetari i Komisionit po ashtu të ketë një seancë përgatitore. SAI mund të jetë në gjendje për të ndihmuar duke ndihmuar stafin e Komisionit të përgatisë pyetje në lidhje me çështjet kryesore në raportin e auditimit dhe t'ia paraqesë ato Kryetarit të Komisionit përpara mbledhjes së Komisionit. Kjo është një praktikë që zbatohet shpesh në GAO-n amerikanë në raportet më Komisionet e Kongresit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve, si dhe në NAO-n Britanike, kanadeze, etj.

Do të jetë zgjedhja dhe vendimi i Kryetarit dhe i anëtarëve të Komisionit nëse janë apo jo për t'u përdorur pyetje të tilla gjatë takimit të ardhshëm të Komisionit.

Është e kështillueshme që Kryetari i SAI-t dhe / ose personeli i lartë i SAI-t të jenë të pranishëm gjatë takimeve të Komisionit, kur raportet e auditimit të SAI-t duhet të diskutohen. Është gjithashtu një praktikë e mirë që përfaqësuesit e lartë dhe ekspertët teknikë të institucioneve shtetërore subjekte të një raporti auditimi, i cili është duke u diskutuan gjatë një takimi të Komisionit, të jenë të pranishëm, në mënyrë që të përgjigjen për çdo pyetje që mund të kenë anëtarët e Komisionit. Edhe pse të pyeturit e personave gjatë një takimi të Komisionit, duke përfshirë edhe ata nga SAI, është prerogativë e Komisionit, është e dobishme nëse pyetje të tilla janë të dizenjuara për të theksuar ose përforcuar gjetjet e auditimit.

Komisioni duhet të jetë i lirë të kërkojë informacion shtesë para ose pas një takimi të Komisionit, në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë të gjithë informacionin që e konsideron të nevojshëm ose të dobishëm për diskutimin e raportit të auditimit apo të çështjeve të tjera.

Shumë Komisione Parlamentare e kanë gjetur të dobishme për të krijuar një proces ndjekjeje parlamentare të raporteve të auditimit të SAI-t, për të siguruar që vëmendja e duhur u jepet gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit dhe se çdo mangësi në institucionin e audituar po mbushet dhe të metat po korrigjohen.

Është praktikë e shumë Komisioneve Parlamentare të hartojnë, brenda një kohe të arsyeshme, raportin e tyre të veçantë në lidhje me një raport auditimi të SAI-t që ata e kanë shqyrtuar dhe të përshkruajnë aty rekomandimet e tyre ndaj Qeverisë, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e SAI-t. SAI mund të ofrojë ndihmë për Komisionin Parlamentar në përgatitjen e raportit të këtij të fundit. Komisioni Parlamentar mund

t'i paraqesë rekomandimet e tij për miratim në Parlament. Kjo procedurë i jep theks dhe vëmendje të shtuar atyre gjetjeve dherekomandimeve të auditimit, me të cilat Komisioni pajtohet. Procedura është më efektive, megjithatë, nëse raporti i Komisionit miratohet me unanimitet nga anëtarët e Komisionit. Unanimiteti lehtësohet në qoftë se anëtarët e Komisionit diskutojnë hapur çdo lloj ndryshim pikëpamjesh që mund të lindë dhe më pas arrihet në një zgjidhje që do të ishte e pranueshme për të gjithë në Komision. Kjo do të jetë veçanërisht e dobishme, në mënyrë që veprimi korigjues (sikurse është propozuar nga Komisioni), të cilin Qeveria duhet ta zbatojë mbi bazën e gjetjeve nga auditimi, në asnjë mënyrë të mos dobësohet.

Raportet mes Komisionit Parlamentar dhe SAI-t do të ishin më interesante dhe lehtësisht të pranueshme nga Qeveria, nëse ata do të përfshinin rekomandime që priten me kënaqësi dhe janë të bazuara në mësimet e nxjerra nga e kaluara. SAI mund të nxjerrë udhëzime për praktikat e mira në bazë të raporteve të auditimit të shqyrtuara në të kaluarën. Vitet e fundit (2010-2015), disa SAI të zhvilluara tropiane (Gjykata e Auditimit e Hollandës[27], Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, etj.) kanë përgatitur komentarë dhe udhëzues me precedentë nga praktikat e mira të tyre të auditimit të viteve 2000-2010 e më tej.

Praktika ka provuar si të dobishme për një Komision që të ketë një sistem formal ku përgjigjet kërkohen të jepen nga Qeveria ndaj raporteve të SAI-t apo të Komisionit.

Shumë Parlamente e gjejnë të dobishme për Komisionet e tyre që të kërkojnë asistencë teknike nga SAI në përgatitjen e propozimeve legjislative, veçanërisht ato në lidhje me auditimin shtetëror, me menaxhimin financiar dhe çështje që kanë qenë objekt i auditimeve të mëdha. Kjo ndihmë mund të përfshijë përgatitjen e drafteve fillestare të ligjeve të propozuara dhe dhënien e komenteve mbi draftet e përgatitura nga të tjerët. Në analizën përfundimtare, SAI duhet të jetë thellësisht i interesuar në krijimin e një marrëdhënie të mirë pune me Parlamentin dhe Komisionet Parlamentare. Një marrëdhënie e tillë e punës është e mundur vetëm nëse SAI dhe Komisioni Parlamentar bashkëpunojnë në fushat me interes të përbashkët dhe nëse ata gjejnë mirëkuptim mes tyre për çështje të tilla.

[27] *Faqja ne internet e Gjykates se Auditimit te Hollandes, http://www.courtofaudit.nl/english*

KAPITULLI III

Dy Rezolutat e OKB-së për pavarësinë e SAI-ve dhe rolin e Vendeve Anëtare dhe Parlamenteve të tyre në fuqizimin e kësaj pavarësie. Simpoziumet OKB-INTOSAI

Në harkun kohor të tre viteve (22 dhjetor 2011-19 dhjetor 2014), në kuadrin e Axhendës së saj të Zhvillimit post 2015, Organizata e Kombeve të Bashkuara(OKB) ka miratuar dy Rezoluta për institucionet supreme të auditimit, Rezoluta A/66/209 "Nxitja e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit" dhe Rezoluta A / 69/228: "Promovimi dhe fuqizimi i efiçiences, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, me anë të forcimit të institucioneve të larta të auditimit".

Në vlerësim të rolit të madh që këto dy Rezoluta të OKB-se luajnë në forcimin e pavarësisë dhe impaktit të auditimeve të SAI-ve, arkitekti i rritjes cilësore të marrëdhënieve të INTOSAI-t me OKB-në dhe i promovimit të Rezolutave, Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë, është shprehur:

"Miratimi i dy Rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së përbën një rezultat të suksesshëm të përpjekjeve tona të përbashkëta të palodhura të viteve të fundit në frymën e forcimit të auditimit suprem publik në të gjithë botën. Ato përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në kuadër të përpjekjeve tona intensive për të ankoruar rolin e SAI-ve në Axhendën e Zhvillimit Post-2015 të OKB-së.

Do t'i kërkoja të gjithë SAI-ve që t'i informojnë institucionet kompetente vendase dhe ndërkombëtare rreth këtyre Rezolutave dhe t'i bëjnë sa më publike ato.

... Ju mund të dëshironi të hapni diskutimet se si SAI-t mund të ndihmojnë me përparimin e auditimit kundrejt objektivave të zhvillimit të Mjëvjeçarit, duke kontribuar me ide për të matur suksesin dhe duke identifikuar vendet për përmirësim. Do t'ju kërkoja të intensifikoni përpjekjet për të inkurajuar qeveritë në vendet tuaja

për të rritur pavarësinë e SAI-ve dhe për t'i përfshirë ato në monitorimin e zbatimit të strategjive të zhvillimit në nivel kombëtar, rajonal dhe global[1]".

Miratimi i këtyre dy Rezolutave përbën kurorëzimin e përpjekjeve të bashkuara të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) nga i gjithë globi, të një lobimi konkret dhe të mirëorganizuar nga ana e Organizatës së tyre INTOSAI, e cila numëron 191 SAI anëtare nga 191 shtete të botës. Për më shumë për këtë Organizatë ndjekim boksin e mëposhtëm:

[1] *Dr. Josef Moser, fjala me rastin e Miratimit te Rezolutës së OKB së 19 dhjetorit 2014 për forcimin e pavarësisë së SAI-ve, http://www.intosaicbc.org/wp-content/uploads/2015/01/SG-Email-UN-Resolution-2014-fin.pdf*

Boks 10

Organizata e institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI është struktura e dytë ndërkombëtare më e madhe, pas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me 192 SAI(Institucione Supreme të Auditimit) anëtare dhe 5 SAI të asociuara. Që nga themelimi në vitin 1953, në zbatim të motos së saj "Experientia Mutua Omnibus Prodest" (Nga Eksperienca e përbashkët, përfitojnë të gjithë), INTOSAI ka shkëmbyer dije dhe ka nxitur bashkëpunimin me SAI-ve anëtare, duke iu përmbajtur vlerave themelore të institucioneve të auditimit më të lartë publik, si, pavarësia, integriteti, profesionalizmi, besueshmëria, përfshirja, bashkëpunimi dhe inovacioni.

INTOSAI është ndërtuar dhe funksionon si një organizatë e përhershme profesionale, autonome, e pavarur dhe jopolitike e institucioneve supreme të auditimit dhe i përfaqëson ato në raportet me OKB, me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe me donatorët ndërkombëtarë. Ajo ka marrëveshje me 22 institucione donatore dhe përgatit e lançon programe e thirrje për projekte zhvillimi dhe ndërtimi kapacitetesh për të gjitha SAI-t kudo në botë.

E organizuar për të funksionuar si në nivel botëror ashtu dhe rajonal, INTOSAI ka gjashtë struktura rajonale, ndër të cilat nga më kryesoret është EUROSAI, organizata evropiane e institucioneve supreme të auditimit. INTOSAI e bazon aktivitetin e saj të përditshëm tek Sekretariati i Përgjithshëm, me seli në Vjenë, nga viti 1963 dhe i merr vendimet kryesore, nëpërmjet Kongresit të saj, të quajtur INCOSAI, i cili mblidhet çdo tre vjet.

Në këto 61 vite ekzistence, INTOSAI ka organizuar 21 kongrese dhe me qindra forume, simpoziume të përbashkëta me OKB-në, workshope, seminare dhe aktivitete të tjera rajonale e planetare, që lidhen me ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve audituese, si dhe ka pasur arritje të shumta përsa i përket pavarësisë, rritjes së kompetencave, efiçiencës dhe qëndrueshmërisë së SAI-ve.

Që nga viti 1992, organizata ka përgatitur dhe publikuar një gamë të gjerë standardesh, udhëzuesish dhe praktikash më të mira, të quajtura ISSAI, të cilat i kanë ndihmuar dhe i ndihmojnë në praktike SAI-t në të gjithë botën, për të rritur pavarësinë, forcuar identitetin dhe shtuar kapacitetet e tyre profesionale.

Ndër dokumentet themelore të INTOSAI-t janë Deklarata e Limës e vitit 1977, e quajtur ndryshe Magna Carta ose Kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit dhe Deklarata e Meksikos e vitit 2007 për forcimin e pavarësisë së SAI-ve.

Koha kur u miratua Rezoluta e parë e OKB-së ishte koha kur SAI-t luftonin për të konsoliduar pavarësinë e tyre dhe për të siguruar njohjen e plote dhe të padiskutueshme të autoritetit të tyre nga shtetet anëtare të OKB-së, sidomos njohjen dhe kuptimin e rëndësisë që kanë dokumentet themelore të shkencës së auditimit publik suprem, Deklarata e Limës e vitit 1977 dhe Deklarata e Meksikos e vitit 2007. Këto dokumente, nëse njihen dhe zbatohen nga SAI-t dhe parlamentet përkatëse, sigurojnë një auditim suprem të përgjegjshëm, profesional, të aftë të forcojë llogaridhënien dhe rrisë transparencën në administrimin e fondeve dhe aseteve publike.

Rezoluta e Parë

Më 22 Dhjetor 2011 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara Nr. 66 aprovon rezolutën "***Duke nxitur efikasitetin, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike nëpërmjet forcimit të Institucioneve më të Larta të Auditimit***".

Rezoluta e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara A/ 66/209 është kurorëzimi i përpjekjeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve më të larta të auditimit për të forcuar pavarësinë e tyre dhe për njohjen e Deklaratave të Limës dhe Meksikës. Ky sukses u bë i mundur vetëm sepse të gjithë anëtarët e komunitetit të INTOSAI-t krijuan kushtet e nevojshme në fushat e tyre të kompetencës dhe i dhanë në këtë mënyrë përmbajtje dhe besueshmëri motos së INTOSAI-t "*Experientia Mutua Omnibus Prodest*".

Rezoluta e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara paraqet një moment historik në historinë gati 60-vjeçare të INTOSAI-t. Aty, Asambleja e Përgjithshme për herë të parë

shprehimisht pranon se SAI-t mund të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjekti i audituar dhe janë të mbrojtura nga ndikimet e jashtme.

Të gjitha SAI-t u pajisën kështu me një Rezolutë të Kombeve të Bashkuara, e cila u lejon atyre të kërkojnë me shumë këmbëngulje zbatimin e parimeve themelore të pavarësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e ndërtimit të kapaciteteve nga ana e SAI-ve, duke qenë se pavarësia e tyre institucionale. në veçanti nga agjencitë e audituara, është njohur për herë të parë nga të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.

Inkurajimi nga Asambleja e Përgjithshme për të gjithë shtetet anëtarë të OKB-së për të zbatuar parimet e përcaktuara në Deklaratën e Limës dhe Meksikës rriti vendosmërinë e të gjitha SAI-ve dhe veçanërisht të atyre që janë ende duke luftuar për të arritur elementet themelore të pavarësisë së tyre.

Simpoziumet e përbashkëta OKB-INTOSAI, që zhvillohen rregullisht një herë në çdo dy vjet në dy dekadat e fundit, garantuan njohjen dhe besimin reciprok të të dy organizatave. Me Rezolutën, institucionet supreme të auditimit u pajisën me një dokument që u lejonte atyre të këmbëngulnin pranë asambleve të parlamenteve të tyre, që të zbatohen parimet bazë të pavarësisë se SAI-ve. Në nivelin më të lartë të vendimmarrjes së shteteve, inkurajimi i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për të gjitha shtetet anëtare, që të zbatojnë parimet e përcaktuara në deklaratat e Limës dhe Meksikos, u dha të kuptonte SAI-ve qe nuk ishin të vetme në përpjekjet e tyre për përgjegjshmëri dhe transparencë të rritur në administratën publike. Kjo përkrahje pa rezerva e OKB-së rriti vendosmërinë e tyre, sidomos të SAI-ve në vendet në zhvillim, për të luftuar të sigurojnë elementet bazë të pavarësisë së plote nga qeveritë. Sfida rezultoi sa e vështirë, aq edhe e gjatë, pse dëshirat dhe ngacmimet e disa segmenteve qeveritare për ndërhyrje që kufizonin pavarësinë e SAI-ve, vijuan në shumë vende të botës, sidomos tek SAI-t e vendeve në zhvillim.

Rezoluta e Parë (Përmbajtja)

Kombet e Bashkuara

Asambleja e Përgjithshme

Rezoluta A/66/209

Promovimi i eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit.

Asambleja e Përgjithshme,

Në mbështetje të Rezolutës të Këshillit Social dhe Ekonomik 2011/2, datë 26 Prill 2011,

Gjithashtu, në mbështetje të Rezolutave 59/55 të datës 2 Dhjetor 2004 dhe 60/34 të datës 30 Nëntor 2005, si dhe rezolutat e mëparshme mbi administrimin dhe zhvillimin publik,

Në mbështetje të Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara[2]

Duke nënvijëzuar nevojën për përmirësimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik

Duke nënvijëzuar gjithashtu faktin se një administrim publik eficient, i përgjegjshëm, efektiv dhe transparent, ka një rol kryesor në zbatimin e qëllimeve të zhvillimit të

---

[2] *Shiko Rezolutën 52/2 mbi Deklaratën e Mijëvjeçarit të OKB, http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf*

pranuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe objektivat e zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Duke theksuar nevojën për krijimin e kapaciteteve si një mjet për të promovuar zhvillimin dhe mirëpritjen e bashkëpunimeve ndërmjet INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara, në lidhje me këtë,

1. *Njeh faktin se Institucionet Supreme të Auditimit, mund të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë eficiente dhe efektive, vetëm nëse ata janë të pavarur nga njësitë e audituara dhe janë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme.*
2. *Gjithashtu njeh, rolin e rëndësishëm të këtyre institucioneve, në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administrimin publik, i cili i vjen në ndihmë edhe arritjes së objektivave dhe prioriteteve për zhvillim kombëtar, si dhe arritjes së qëllimeve të pranuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë edhe qëllimet e zhvillimit të Mijëvjeçarit.*
3. *Vlerëson punën e INTOSAI-t në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës, si dhe përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të burimeve publike, në të mirë të qytetarëve.*
4. *Gjithashtu, vlerëson Deklaratën e Limës, Udhëzuesit mbi rregullat e Auditimit të vitit 1977[3] dhe Deklaratën e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve, në vitin 2007[4] dhe inkurajon shtetet anëtare, të aplikojnë këto deklarata, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare.*
5. *Inkurajon shtetet anëtare dhe institucionet e ngjashme në OKB, të vazhdojnë dhe të intensifikojnë marrëdhëniet e tyre, duke përfshirë edhe krijimin e kapaciteteve, me INTOSAI-n, për të promovuar mirë-qeverisjen eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën, duke forcuar rolin e institucioneve supreme të auditimit".*

Rezoluta e Dytë

Vetëm tre vite më vonë, më 19 dhjetor 2014, Asambleja e Përgjithshme e OKB-se miratoi një Rezolutë të dytë për pavarësinë e SAI-ve. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, njëkohësisht President i Gjykatës Austriake të Auditimit, "*Miratimi i Rezolutës se dyte te OKB-se është një hap i mëtejshëm i rëndësishëm, në kuadrin e përpjekjeve intensive te INTOSAI-t, për të ankoruar rolin e*

---

[3] Deklarata e Limës, Udhëzime mbi Rregullat e Auditimit, miratuar në Kongresin e 9-të të INTOSAI-t, 17 – 26 Tetor 1977.

[4] Deklarata e Meksikos mbi INTOSAI-n, miratuar në Kongresin e 19-të të INTOSAI-t 5 – 10 Nëntor 2007

SAI-ve në Agjendën e Zhvillimit Post 2015 të OKB-së. Një nga qëllimet kryesore të Agjendës së Zhvillimit Post 2015 të OKB-së, është përmirësimi i sistemeve të kontabilitetit publik dhe llogaridhënies publike, me synim mirëqeverisjen publike dhe rritjen e transparencës".

Rezoluta e dytë e OKB-së, në mënyrë të ngjashme me Rezolutën e parë, thekson se SAI-t mund të kryejnë detyrat e tyre objektivisht dhe në mënyrë efektive, vetëm nëse ato janë të pavarura nga subjektet që auditojnë dhe janë të mbrojtura nga çdo ndikim i jashtëm. Ajo njeh rolin e rëndësishëm te SAI-ve në promovimin e efiçiences, llogaridhënies, efektshmërisë dhe transparencës së administratës publike. Ky rol është thelbësor për arritjen e objektivave dhe përparësive të zhvillimit kombëtar Sërish, OKB vlerëson Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikos mbi pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe i inkurajon shtetet anëtare për të aplikuar, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare institucionale, parimet e përcaktuara në këto deklarata. Rezoluta inkurajon shtetet anëtare dhe institucionet e Kombeve të Bashkuara për të vazhduar dhe intensifikuar bashkëpunimin e tyre me SAI-t, duke përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve, ne INTOSAI, në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë në të gjitha nivelet, duke siguruar efiçiencë, llogaridhënie, efektivitet dhe transparencës, përmes forcimit te SAI-ve.

E ndodhur përpara pasojave të krizës botërore ekonomike dhe financiare 2008- 2012 (e cila u shkaktua dhe nga informacioni i mangët apo i devijuar fiskal dhe financiar) dhe domosdoshmërisë së disiplinimit të mëtejshëm të financave publike dhe rritjes së transparencës fiskale e financiare të qeverisjes kudo ne botë, OKB gjykoi se partnerët më të rëndësishëm të qeverive në botë, në përballimin e këtyre sfidave janë SAI-t dhe organizata e tyre mbarëbotërore, INTOSAI. Gjatë viteve 2011-2014, kontaktet, konsultimet, seminaret dhe simpoziumet e përbashkëta OKB-INTOSAI vijuan rregullisht dhe me intensitet, duke bindur OKB-në për rolin e pazëvendësueshëm dhe kyç të institucioneve supreme të auditimit në shëndoshjen dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës së financave publike. Sipas Zv-Sekretarit të Përgjithshëm te OKB-se, z. Wu Hongbo, në fjalën e tij ne Simpoziumin e 23-te OKB-INTOSAI, "*Siç mund të jeni në dijeni, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka tashmë lëshuar një thirrje për veprim, kur miratoi në dhjetor të vitit 2014, një Rezolutë të dytë për Promovimin dhe nxitjen e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet supreme të auditimit.*

Me këtë Rezolutë, Asambleja e Përgjithshme u bën thirrje shteteve anëtare që "...t'i kushtojnë vëmendjen e duhur pavarësisë dhe ngritjes së kapaciteteve të

institucioneve supreme të auditimit, dhe për përmirësimin e sistemeve të kontabilitetit publik në Axhendën e Zhvillimit Post-2015 të OKB-së."

Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale të OKB-së, duke punuar ngushtë me partnerët kryesorë, duke përfshirë INTOSAI-n, është i angazhuar për të mbështetur përpjekjet kombëtare, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të nxitur qeverisjen dhe administrimin publik efikas, transparent dhe të përgjegjshëm.

Ky simpozium i përbashkët është një përpjekje e tillë. Unë e konsideroj këtë Simpozium një mundësi të mirë për diskutime të gjera dhe shkëmbimeve të frytshme në lidhje me mësimet e nxjerra dhe këshillat që institucionet kombëtare të auditimit suprem mund të japin[5]".

Rolin e SAI-ve në qëndrueshmërisë dhe transparencën e financave publike e ka promovuar dhe vlerësuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, në përditësimin e Kodit të tij të Transparencës Fiskale në gusht 2014. Kjo është e rëndësishme për INTOSAI-n, pse mbështetja e OKB-së shtyn edhe shumë organizata botërore donatore të ndihmojnë me fondet e tyre nismat e strukturave rajonale të INTOSAI-t, për të rritur kapacitetet audituese të SAI-ve, sidomos të atyre të vendeve në zhvillim. OKB thekson në Rezolutë edhe rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërkombëtar, për të mbështetur zhvillimin e SAI-ve dhe ndërtimin e kapaciteteve te duhura audituese, në bazën e standardeve të INTOSAI-t dhe praktikave më të mira, të lidhura me kontabilitetin publik dhe auditimin suprem. Si OKB dhe organizatat e tjera ndërkombëtare kanë kërkuar nga parlamentet e vendeve anëtare që të njihen me përmbajtjen e Rezolutës, duke siguruar përkrahjen dhe ndihmesën e duhur, së pari, për pavarësinë e plotë të SAI-ve respektive dhe së dyti, për rritjen e kapaciteteve të tyre audituese në nivelin e sfidave të kohës. Sipas përcaktimit të Dr. Moser në letrën që ai u dërgon të gjitha SAI-ve anëtare me rastin e miratimit te Rezolutës së Dytë, "*…vetë SAI-t tani po punojnë në nivel të organizatës së tyre INTOSAI, për të garantuar kontributin e SAI-ve në përgatitjet për Agjendën e Zhvillimit Post 2015 të*

---

[5] *Wu Hongbo, Zv-Sekretarit i Përgjithshëm i OKB-së, Fjala përshëndetëse në hapjen e Simpoziumit të 23-të OKB-INTOSAI, 2 mars 2015, Vjenë, http://www.un.org/en/development/desa/usg/statements/mr-wu/2015/03/23rd-unintosai-symposium.html*

OKB-së, të cilat do të vazhdojnë intensivisht dhe janë planifikuar të përfundojnë, nga ana e INTOSAI-t, në fund të këtij vit[6]i".

Rezoluta e Dytë (Përmbajtja)

Kombet e Bashkuara

Asambleja e Përgjithshme

Rezoluta A/C.2/69/L.25/Rev.1

Më 20 Nëntor, 2014

Sesioni i 69, Komiteti i Dytë "Globalizimi dhe Ndër-varësia"

Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Qipro, Finlanda, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Izraeli, Italia, Japonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malajzia, Maroku, Hollanda, Norvegjia, Portugalia, Republika e Koresë, Republika e Moldavisë, Rumania, Serbia, Sllovakia, Spanja, Ukraina dhe Anglia dhe Irlanda e Veriut; rishikuan projekt Rezolutën

Promovimi dhe nxitja e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke forcuar institucionet supreme të auditimit

---

[6] Dr. Josef Moser, fjala me rastin e Miratimit të Rezolutës së OKB së 19 dhjetorit 2014 për forcimin e pavarësisë së SAI-ve, po aty, fq.3, http://www.intosaicbc.org/wp-content/uploads/2015/01/SG-Email-UN-Resolution-2014-fin.pdf

Asambleja e Përgjithshme,

duke kujtuar Rezolutën e saj 66/209 të 22 Dhjetorit 2011,

duke kujtuar gjithashtu angazhimet e rezultateve të dala nga Konferencat dhe samitet më të mëdha të Kombeve të Bashkuara në fushën ekonomike, shoqërore dhe të mjedisit,

duke përfshirë dokumentin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm , Deklaratën e Mileniumit të Kombeve të Bashkuara , Rezultatin e Samitit Botëror të 2005 , Konsensusin e Montereit të Konferencën Ndërkombëtare mbi Financimet për Zhvillim, Deklaratën e Dohas mbi Financimet për Zhvillim: dokumentin përfundimtar të Konferencës Ndërkombëtare mbi Financimet për Zhvillim për Rishikimin e Zbatimit të Konsensusit të Montereit, dokumentin përfundimtar të takimit plenar të nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme mbi Qëllimet për Zhvillim të Mileniumit, ashtu si edhe dokumentin përfundimtar të aktivitetit special për ndjekjen e përpjekjeve drejt përmbushjes së Qëllimeve për Zhvillim të Mileniumit, Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullimin dhe Zhvillimin , veprimet kryesore për zbatimin e mëtejshëm të Programit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullimin dhe Zhvillimin dhe Deklaratën e Pekinit[10] dhe Platformën për Veprim

Duke kujtuar më tej rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 67/290 të 9 Korrikut 2013 dhe 68/1 të 20 Shtatorit 2013, dhe deklaratën ministeriale të segmentit të nivelit të lartë të sesionit të 2014 të Këshillit Ekonomik dhe Social, si dhe forumit politik të nivelit të lartë mbi zhvillimin e qëndrueshëm, Duke kujtuar më tej rezolutën e saj 68/309 të 10 Shtatorit 2014, në të cilën mirëpriti Raportin e Grupit të Hapur të Punës mbi Qëllimet për Zhvillim të qëndrueshëm dhe vendosi se propozimi i Grupit të Hapur të Punës që gjendej në raport, duhet të ishte baza për integrimin e qëllimeve për zhvillimin e qëndrueshëm në axhendën për zhvillim post-2015, ndërsa njeh se kontribute të tjera do të merren në konsideratë, në procesin interqeveritar të negocimit gjatë sesionit të 69 të Asamblesë së Përgjithshme,

Duke theksuar nevojën për të përmirësuar eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike,

Duke theksuar gjithashtu, se një administratë publike eficiente, e përgjegjshme, efektive dhe transparente luan një rol thelbësor në zbatimin e qëllimeve për zhvillim të dakortësuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë Qëllimet për Zhvillim

të Mileniumit,

Duke theksuar nevojën për ngritjen e kapaciteteve si një mjet për të promovuar zhvillimin, dhe duke mirëpritur bashkëpunimin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit me Kombet e Bashkuara për këtë qëllim,

1. *Njeh se SAI't mund të përmbushin detyrat e tyre me objektivitet dhe efektivitet vetëm nëse ata janë të pavarur nga subjektet e audituara dhe të mbrojtur nga influencat e jashtme;*

2. *Njeh gjithashtu rolin e rëndësishëm të SAI've në promovimin e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, që nxit edhe arritjen e objektivave dhe prioriteteve të zhvillimit kombëtar, si edhe të qëllimeve të zhvillimit të dakordësuara ndërkombëtarisht;*

3. *Konstanton duke vlerësuar punën e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin më të madh të eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit, transparencës, si dhe marrjes dhe përdorimit eficient dhe efektiv të burimeve publike në përfitim të qytetarëve;*

4. *Konstanton gjithashtu duke vlerësuar Parimet Udhëzuese të Auditimit të Deklaratës së Limës të vitit 1977 dhe Deklaratën e Meksikos mbi Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit të vitit 2007 dhe inkurajon Shtetet Anëtare të aplikojnë, në mënyrë të vazhdueshme me strukturat e tyre kombëtare, parimet e përcaktuara në këto Deklarata;*

5. *Inkurajon Shtetet Anëtare dhe institucionet përkatëse të Kombeve të Bashkuara të vazhdojnë të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, duke përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve, me INTOSAI-n në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë në të gjitha nivelet duke siguruar eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën nëpërmjet SAI've të forta, duke përfshirë sipas rastit, përmirësimin e sistemeve kontabël publike;*

6. *Njeh rolin që luajnë institucionet supreme të auditimit në nxitjen e përgjegjshmërisë qeverisëse për përdorimin e burimeve dhe performancën e tyre në arritjen e qëllimeve për zhvillimin;*

7. *Konstanton interesin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit për axhendën e zhvillimit post -2015;*

8. *Inkurajon Shtetet Anëtare t'i kushtojnë vëmendjen e duhur pavarësisë dhe ngritjes së kapaciteteve së SAI've në përputhje me strukturat e tyre kombëtare, ashtu si edhe përmirësimit të sistemeve kontabël publike në përputhje me planet kombëtare për zhvillim në kuadrin e Axhendës për Zhvillim Post 2015;*

9. *Thekson rëndësinë e vazhdimësisë së bashkëpunimit ndërkombëtar për të mbështetur vendet në zhvillim në ngritjen e kapaciteteve, me njohuri dhe praktikat më të mira lidhur me kontabilitetin publik dhe auditimin".*

Simpoziumet OKB-INTOSAI[7]

Boks 11

Simpoziumet OKB-INTOSAI sigurojnë forcimin e kapaciteteve për SAI-t (*Objektivi 2 i Planit Strategjik të INTOSAI-t*). Nëpërmjet shkëmbimit të përvojave në fusha specifike dhe të informacionit në të gjitha fushat përkatëse të auditimit të sektorit publik, simpoziumet kanë kontribuar në kërkimin shkencor të aplikuar dhe zhvillimin e metodologjive për auditimin suprem shtetëror.

Ato kanë nisur të mbahen në Vjenë që nga viti 1971,zakonisht në intervale çdo dy vjet, të sponsorizuara nga INTOSAI së bashku me Kombet e Bashkuara, duke siguruar trajnim për pjesëmarrësit nga SAI-t e vendeve në zhvillim dhe vendeve në tranzicion.

Simpoziumet OKB-INTOSAI organizohen nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, i cili në bazë të Statutit të INTOSAI-t është Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit. Programi teknik i Simpoziumit hartohet nga Sekretariati i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara.

[7] *Faqja në internet e INTOSAI-t. Prezantimi i Simpoziumeve OKB-INTOSAI.*
http://www.intosai.org/events/unintosai-symposia/chronology-topics-reports.html

Historia e bashkëpunimit mes OKB dhe INTOSAI-t starton në vitin 1971 me Seminarin e Parë të përbashkët, në nivel të eksperteve dhe grupeve të përbashkëta të punës. Tetë seminaret e para, të mbajtura po në Vjenë, ju kushtuan shkëmbimit të eksperiencave mes eksperteve të të dyja organizatave ndërkombëtare. Seminari i 9-të, i organizuar me datat 12-21 shtator 1990, i kushtohej kontabilitetit dhe auditimit të Programeve të Ndihmës së Huaj dhe Auditimit të Përpunimit Elektronik të të Dhënave. Më vonë, janë zhvilluar edhe nëntë seminare të tjera të përbashkëta, si më poshtë, përpara se sa aktiviteti të merrte formën përfundimtare të Simpoziumit:

Nr.	Data	Tema e Seminarit OKB/INTOSAI
1	03-14 maj 1971	Parimet e përgjithshme, metodat dhe qëllimet e auditimit të qeverisë dhe problemet e lidhura institucionale
2	02-14 shtator 1994	Teknikat dhe metodat e përdorura nga Institucionet Supreme të Auditimit me qëllim përmirësimin e auditimit financiar dhe të performancës
3	03-21 maj 1976	Buxhetimi publik dhe kontabiliteti, pozita e Institucioneve Supreme të Auditimit në shtetin modern, auditimi i ndërmarrjeve publike
4	14-25 maj 1979	Parimet e auditimit, auditimit Organizata, auditimin e performancës dhe auditimi Shtetëror të ndërmarrjeve publike
5	14-25 shtator 1981	Konceptet e auditimit, Kontrollit të faturave tatimore, Kontrollit të Institucioneve Financiare të Qeverisë për zhvillimin dhe kontrollin e performancës në ndërmarrjet publike
6	02-12 tetor 1984	Auditimi Publik dhe Menaxhimi i Sistemeve te Kontrollit të Brendshëm në vendet në zhvillim
7	22-30 shtator 1986	Auditimi i projekteve kryesore të Zhvillimit
8	21-29 prill 1988	Auditimi i Teknologjisë se Informacionit

9	12-21 shtator 1990	Mbi Kontabilitetin dhe Auditimin e Programeve të Ndihmës së Huaj dhe Kontrollit
10	27 maj-4 qershor 1992	Auditimi i Përpunimit Elektronik të të Dhënave Shkëmbimi i eksperiencave, mundësive dhe sfidave
11	25-29 prill 1994	Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Ristrukturimin e Sektorit Publik
12	21-25 tetor 1996	Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe keqadministrimit
13	16-20 mars 1998	Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Auditimin e Punëve Publike
14	27-31 mars 2000	Auditimit i sistemeve publike të kujdesit shëndetësor dhe Institucionet Supreme të Auditimit
15	8-12 prill 2002	Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Auditimin e Bujqësisë
16	31 mars-4 prill 2003	Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Auditimin e përdorimit te fondeve në fushën e arsimit
17	19-23 prill 2004	Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit
18	18-22 prill 2005	Aplikimi i Informacionit dhe Teknologjitë e Komunikimit (TIK) në Auditimin e qeverisjes: Një Strategji për Efiçiencë, transparence dhe llogaridhënie
19	28-30 mars 2005	Vlerat dhe Përfitimet nga Auditimi i Qeverisë në një mjedis te globalizuar

Katër Simpoziumet OKB-INTOSAI 20-23

20	11-13 shkurt 2009	INTOSAI: partner aktiv në rrjetin kundër korrupsionit ndërkombëtar; Sigurimi i transparencës për të promovuar sigurinë sociale dhe uljen e varfërisë
21	13-15 korrik 2011	Praktikat efektive të bashkëpunimit mes SAI-ve dhe qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë publike
22	05-07 mars 2013	Auditimi dhe këshillimi nga SAI-et: Rreziqet dhe Mundësitë, si dhe mundësitë për Angazhimin Qytetar
23	02-04 mars 2005	Axhenda e zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën pas 2015:Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për zhvillimin e qëndrueshëm

Simpoziumi i 20 OKB-INTOSAI, 11-13 shkurt 2009, Vjenë, Austri[8]

Në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve te Bashkuara (OKB), Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t organizoi më datat 11-13 shkurt, 2009 Simpoziumin e 20-te OKB/INTOSAI në Vjenë, Austri,. Tema ishte " *INTOSAI: partner aktiv në rrjetin kundër korrupsionit ndërkombëtar; Sigurimi i transparencës për të promovuar sigurinë sociale dhe uljen e varfërisë* "

Ky ishte Simpoziumi më i suksesshëm i OKB dhe INTOSAI-t në historinë e më shumë se 40 vjet të këtyre eventeve. Më shumë se 170 pjesëmarrës që përfaqësonin 68 SAI-t të vendeve te ndryshme te botes (duke përfshirë edhe 40 kryetarë te SAI-ve), si dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga tetë institucione dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare: Instituti i Auditorëve të Brendshëm (IIA), Interpoli, Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ), Organizata për të Drejtat Ekonomike, Bashkëpunimi dhe Zhvillim (OECD), Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), Zyra e OKB-së për Drogën

[8] *http://www.ccrm.md/file/Activ.%20Intern/Organizatii%20Internationale/INTOSAI/eng/UN-INTOSAI%20Symposium.pdf*

dhe Krimin, Departamenti i OKB-së për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, dhe Banka Botërore, morën pjesë në Simpozium.

Foto në grup: Pjesëmarrësit e Simpoziumit të 20-të OKB/INTOSAI, 11-13 shkurt 2009, Vjenë, Austri

Pjesëmarrësit dhe folësit theksuan rëndësinë e pavarësisë, trajnimit adekuat dhe raportimit publik nga SAI-t. Ata ranë dakord se për shkak se SAI-t i mbikëqyrin të gjitha operacionet e qeverisë, ata janë të pozicionuar në mënyrë unike për të luftuar korrupsionin. Ata deklaruan se INTOSAI e konsideron si detyrën e saj kryesore rritjen e transparencës, promovimin e qeverisjes së mirë, duke garantuar përgjegjshmërinë, luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e besimit të publikut në institucionet qeveritare dhe në punën e tyre. Ata gjithashtu vunë në dukje se INTOSAI duhet të drejtojë duke dhe në shembullin e vet, në luftën kundër korrupsionit dhe se organizata i ka përmbushur përgjegjësitë e saj për të siguruar transparencë dhe për të parandaluar korrupsionin, me anë të një morie aktivitetesh dhe masash.

Rekomandimet

Pjesëmarrësit ranë dakord mbi nevojën për të promovuar integritetin, duke ndërtuar një kulturë që refuzon korrupsionin dhe siguron qeverisjen e përgjegjshme. Ata gjithashtu theksuan nevojën për të ruajtur dhe për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën dhe për të penguar mashtrimin dhe korrupsionin.

Pjesëmarrësit rekomanduan që baza e nevojshme ligjore (ligjet anti-korrupsion, duke përfshirë kodet e sjelljes dhe kodet e etikës) duhet të krijohet dhe forcohet për të

adresuar në mënyrën e duhur korrupsionin, mashtrimin dhe keq menaxhimin në sektorin publik dhe privat. Pjesëmarrësit gjithashtu rekomanduan që bashkëpunimi i ngushtë ndërkombëtar të nxitet për të optimizuar shkëmbimin e informacionit dhe të "know-how", si dhe për rritjen e aktiviteteve të nevojshme të trajnimit.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit mbrojtën nevojën për SAI-t dhe INTOSAI-n për të bashkëpunuar ngushtë me organizatat ndërkombëtare (për shembull, organizatat e OKB-së, Banka Botërore, OECD, Interpol, IIA, OLAF dhe me shoqërinë civile) në rrjetet antikorrupsion.

Grupi i Punës i INTOSAI-t për Luftën kundër Pastrimit Ndërkombëtar të Parave dhe Korrupsionit propozoi me force më poshtë:

- forcimi i bashkëpunimit në mes të INTOSAI-t dhe SAI-t për të (1) parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave dhe (2) të lehtësojë shkëmbimin e informacionit, si dhe zhvillimin e tipologjive dhe udhëzimet e përdorura nga SAI-t;

- forcimin e bashkëpunimit në mes të INTOSAI-t dhe organizatave ndërkombëtare të përfshira në luftën kundër korrupsionit;

- identifikimin e rregullave, masave, politikave dhe programet kombëtare për SAI-t për të zbuluar dhe parandaluar korrupsionin; dhe

- identifikimin e programeve dhe trajnimeve të rëndësishme kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit, duke bashkëpunuar me IDI-n, ne ato raste kur nevojitet trajnim special.

Simpoziumi njëzëri ra dakord qe INTOSAI të hartojë standardet dhe shënime të praktikave më të mira për SAI-t që të luftojnë korrupsionin, mashtrimin, dhe keq menaxhimin, si dhe të nxisin komunikimin e duhur të standardeve dhe shënimeve të tilla, duke përfshirë Iniciativën e Zhvillimit të INTOSAI-t dhe veprimtareve të tjerë.

Pjesëmarrësit gjithashtu deklaruan se plani strategjik i INTOSAI-t 2011-2016 duhet t'i kushtojë vëmendje luftës kundër korrupsionit dhe keq menaxhimit.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e sigurimit të një kornize të duhur kushtetuese në përputhje me deklaratat e Limës dhe Meksikës. Kjo kornizë duhet të sigurojë një mandat të plotë të auditimit, me qasje të pakufizuar në informacion, dhe të lejojë publikimin e hapur te raporteve te SAI-ve. Për më tepër, ajo duhet të mbështesë ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe personelin e nevojshme për pavarësinë

organizative dhe financiare te SAI-ve. Këto janë konsideruar parakushte për rritjen e kredibilitetit të SAI-ve në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe keq menaxhimit. Në këtë drejtim, do të ishte e dobishme për të përgatitur udhëzime për zbatimin e deklaratave te Limës dhe Meksikës dhe për të theksuar rëndësinë e shqyrtimeve mes kolegeve "Peer Reviews".

Të 13 rekomandimet e simpoziumit kulmuan me bindjen se deklaratat e Limës dhe Meksikës duhet të integrohen në ligjet që rregullojnë komunitetin ndërkombëtar, nëpërmjet një rezolute përkatëse të OKB-së.

Simpoziumi i 21 OKB-INTOSAI, 13-15 qershor 2011, Vjenë, Austri[9]

Simpoziumi i 21-të OKB/INTOSAI "Mbi praktikat efektive të bashkëpunimit mes SAI-ve dhe qytetarëve për të rritur përgjegjshmërinë publike", organizuar bashkërisht nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe nga Kombet e Bashkuara (OKB), u mbajt në Vjenë, Austri, nga datat 13 deri në 15 korrik 2011.

Rreth 140 përfaqësues të 66 Institucioneve Supreme të Auditimit (më shumë se një e treta e anëtarësimit të INTOSAI-t) dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, në veçanti Kombet e Bashkuara (KB), si dhe Unioni Ndërparlamentar (IPU), Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit (IBP) dhe GIZ, u bashkuan me debate te gjalla, te udhëhequra nga Presidenti i INTOSAI-t Terence Nombembe. Për herë të parë një Zv-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-se, z Sha Zukang, përgjegjës për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, mori pjese në Simpozium.

[9] *http://www.intosai.org/uploads/schlz21symposiumen3.pdf*

Foto në grup: Pjesëmarrësit e Simpoziumit të 21-të OKB/INTOSAI, 13-15 korrik 2011, Vjenë, Austri

26 përfaqësues të institucioneve të Auditimit Suprem, si dhe përfaqësues të Departamentit të OKB-së për Çështje Ekonomike dhe Sociale (UN DESA), Komitetit te Eksperteve te OKB-së për Administratë Publike (UN CEPA) dhe Zyrës se OKB-së për Drogën dhe Krimin (UNODC) mbajtën prezantime.

Simpoziumi i 22-të OKB-INTOSAI, 5-7 mars 2013, Vjenë, Austri[10]

Në Vjenë, në datat 05-07 Mars u mbajt Simpoziumi i 22-të i OKB/INTOSAI, i organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI, në bashkëpunim me Departamentin e Kombeve të Bashkuara për Ekonominë dhe Çështjet sociale (UN-DESA).

[10] *http://www.intosaijournal.org/insideintosai/insidejuly13.html*

Simpoziumi i 22-të UN/INTOSAI, 5-7 Mars 2013, Vienë/Austri

Në simpozium ishin më shumë se 150 pjesëmarrës nga 60 shtete të ndryshme dhe midis tyre më shumë se 40 Kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare (UN-DESA, UNODC, UNEP, OECD, GIZ). Simpoziumin e nderuan me praninë e tyre përfaqësues të lartë nga Kombet e Bashkuara z. Wu Hongbo, Nën Sekretar i Përgjithshëm për Ekonominë dhe Çështjet Sociale; Kryetarja e Parlamentit Austriak zj. Barbara Prammer dhe Sekretari i Shtetit për Çështjet e Jashtme Dr. Reinhold Lopatka.

Tema kryesore e simpoziumit ishte "Auditimi dhe Këshillimi nga Institucionet Supreme te Auditimit: Risqet dhe mundësitë, si edhe shanset e angazhimit qytetar", e cila u materializua nëpërmjet këtyre nën-temave :

1. Auditimi dhe këshillimi nga SAI-t: Kërkesat dhe mundësitë për auditimin e qeverisjes.
2. Risqet dhe mundësitë e auditimit dhe këshillimit nga SAI-t.
3. Efektiviteti dhe transparenca e auditimit dhe këshillimit nëpërmjet angazhimit qytetar.

Hapjen e këtij Simpoziumi e përshëndeti Dr. Josef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, i cili prezantoi dhe objektivin e këtij Simpoziumi. Sipas z. Moser, duke synuar t'i qëndrojmë besnikë motos së INTOSAI-t Experientia mutua omnibus prodest (eksperienca e përbashkët i shërben të gjithëve), ky simpozium ka si qëllim:

- Identifikimin e mënyrave dhe mjeteve të përdorura nga SAI-t për të kontribuar në mënyrë sa më efektive në përmirësimin e ekonomisë dhe efiçencës së qeverisjes,

- Evidentimi i masave të nevojshme për të përfituar nga avantazhet dhe për të evituar risqet, si dhe
- Rëndësia e shembujve që mund të shërbejnë si modelet më të mira praktike.

Në vijim përshëndeti këtë Simpozium Z. Wu Hongbo, Zv/Sekretari i Përgjithshëm për Çështjet Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara (UN DESA). Në fjalën e tij z. Hongbo theksoi se SAI-t promovojnë transparencën, llogaridhënien duke kontribuar në këtë mënyrë në një qeverisje publike efektive. Duke marrë parasysh eksperiencën e SAI-ve, këshillat e tyre të vazhdueshme mbi mbrojtjen e burimeve financiare publike janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm.

Në lidhje me temën e parë, "Auditimi dhe këshillimi nga SAI-t; Kërkesat dhe mundësitë për auditimin e qeverisjes", u ndoqën prezantimet e mëposhtme:

1. Auditimi dhe këshillimi në kontekstin e auditimit të performancës nga SAI-t e Brazilit dhe Kamerunit.

Për SAI-n e Brazilit referoi z. Carlos Alberto Sampaio de Freitas i cili në prezantimin e tij theksoi faktin se këshillimi nga ana e SAI-ve është një qasje e rëndësishme në auditimin e performancës dhe duhet të dimensionohet në përputhje me strategjinë e SAI-t dhe duke marrë parasysh realitetin politik dhe administrativ të një vendi. Njohja e kufijve dhe mundësive nga SAI-t çon në përmirësimin e qëllimit të tyre strategjik.

Për SAI-n e Kamerunit referoi z. Celestin Mgoba Ankamtsene, i cili në prezantimin e tij u përqendrua në specifikat e funksionit të kontrollit në kontekstin e auditimit të performancës, sfidat dhe limitet në funksionin e kontrollit të auditimit të performancës, si shfaqet funksioni i këshillimit në auditimin e performancës si dhe sfidat dhe limitet në funksionin e këshillimit të auditimit të performancës.

2. Vlerat dhe përfitimet e auditimit dhe këshillimit sipas perspektivës së organizatave donatore, nga Dr. Barbara Dutzler, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für internationale Zusammenarbeit, GIZ). Në prezantimin e saj Dr. Barbara Dutzler u përqendrua në 3 momente:
a. Arsyeja pse GIZ mbështet SAI-t, është fakti që SAI-t mund te sjellin ndryshime në jetën e qytetarëve;

b. Mënyra e mbështetjes së SAI-ve nga GIZ, e cila kryhet nëpërmjet dhënies së këshillimeve afatgjata;
c. Mësimet e nxjerra: Në shumë vende në zhvillim, ende nuk kuptohet siç duhet roli që luajnë degë të ndryshme të qeverisjes dhe për rrjedhim nuk kuptohet siç duhet kontrolli, auditimi dhe këshillimi.

3. Vlerat dhe përfitimet e auditimit dhe këshillimit sipas perspektivës së klientëve të auditimit: entet legjislative dhe të auditimit nga Z. Hon. A.F. Mahlalela, Kryetar i Organizatës së Llogaridhënies Publike të Zhvillimit të Komunitetit të Afrikës së Jugut (SADCOPAC).
Z. Mahlalela në fjalën e tij u përqendrua në dhënien e mesazheve të qarta dhe të thjeshta të auditimeve, ndërveprimin e rregullt të SAI-ve dhe legjislativit, mbështetja dhe këshillimi në nivelin e Shoqatës së Komiteteve Publike të Llogarisë. Z. Mahlalela e mbylli fjalën e tij duke theksuar se sipas tij bashkëpunimi ndërmjet legjislativit dhe SAI-ve është një nga marrëdhëniet me më shumë përfitime dhe të vlefshme e që mbështet qeverisjen e mirë në të gjithë botën.

4. "Sfidat e SAI-t në lidhje me mënyrat e qëndrueshme dhe efikase për të komunikuar gjetjet e auditimit dhe rekomandimet", nga SAI-t e Polonisë dhe SHBA-së. Për SAI-n e Polonisë referoi . Jacek Jezierski, President i Zyrës së Lartë të Auditimit të Polonisë, i cili në fjalën e tij theksoi se pavarësisht nëse merremi me auditimin apo këshillimin, duhet t'i qëndrojmë besnikë idesë së ndikimit që duam të kemi. Ne duhet t'i trajtojnë komunikimin dhe raportimin si mjete për të siguruar impaktin tonë dhe për këtë na nevojitet një sistem i mirë i ndjekjes së auditimit për të qenë të sigurt se impakti që do të arrijmë ka të bëjë me vlerën e parasë.

Për SAI-n e SHBA-së referoi z. Timothy P. Bowling, PHD, Shef i Zyrës së Cilësisë në Zyrën e Lartë të Llogarisë në SHBA, i cili u ndal në çështje si sfidat që hasin SAI-t në procesin e komunikimit, principet kryesore të komunikimit, instrumentet dhe mjetet në komunikimin me qytetarët dhe palët e tjera të interesuara, instrumentet dhe mjetet për promovimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara në procesin e auditimit, etj.

Në lidhje me temën e dytë, "Risqet dhe mundësitë e auditimit dhe këshillimit nga SAI-t", u ndoqën prezantimet e mëposhtme:

1. Bashkëpunimi, komunikimi dhe masat e performancës si bazë për vlerat dhe përfitimet e SAI-ve nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI) dhe SAI i Xhamajkës. Për IDI referoi z. Einar Gorrissen, i cili në prezantimin e tij u përqendrua në matjen e performancës së kuadrit ligjor të SAI-ve.

Prezantimi i SAI-t të Xhamajkës u përqendrua në rritjen e efektivitetit nëpërmjet bashkëpunimit me pushtetin legjislativ, gjyqësor dhe ekzekutiv.

2. Kufijtë ndërmjet auditimit dhe këshillimit të SAI-ve dhe auditi bashkekzistues/i brendshëm nga SAI-t e Emirateve të Bashkuara Arabe (UAE) dhe Koresë Prezantimi i SAI-t të Emirateve të Bashkuara Arabe u përqendrua në kufijtë që hasin auditi i jashtëm dhe i brendshëm sipas perspektivës së UAE.

Prezantimi i SAI-t të Koresë u përqendrua në shtyllat e ligjit mbi auditimin në sektorin publik, në arritjet dhe sfidat si dhe në rolin e SAI-t të Koresë në zhvillimin e auditimit publik.

3. Afatet kohore të auditimit dhe këshillimit si një faktor në efektivitetin e SAI-ve, nga SAI-t e Samoas dhe Federatës Ruse.

Për SAI-n e Samoas referoi z. Lyn Provost, Kontrollor dhe Auditues i Përgjithshëm i SAI-t, i cili në prezantimin e tij u përqendrua në kërkesat e raportimit për subjektet publike në Zelandën e Re, faktorët që ndikojnë në afatet kohore të raportimit nga subjektet publike si dhe rëndësinë e afateve kohore në procesin e auditimit. Për SAI-n e Federatës Ruse referoi Dr. Sergey Stepashin, i cili në prezantimin e tij u përqendrua në afatet kohore të auditimit, analizat dhe përpunimin e rekomandimeve si faktorë që ndikojnë në efektivitetin e SAI-ve.

Në lidhje me temën e tretë, “Efektiviteti dhe transparenca e auditimit dhe këshillimit nëpërmjet pjesëmarrjes së qytetarëve”, u ndoqën prezantimet e mëposhtme:

1. Praktikat për angazhimin e qytetarëve në auditim dhe këshillim nga ana e SAI-ve, nga SAI i Danimarkës dhe Kilit.

Për SAI-n e Danimarkës referoi z. Henrik Berg Rasmussen, Drejtor në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Danimarkës, i cili në prezantimin e tij u ndal në avantazhet

që vijnë nga bashkëpunimi me organizatat shoqërore. Sipas z. Rasmussen këto organizata japin kontributin e tyre në kuptimin e subjekteve në mënyrë të përgjithshme si dhe në hartimin e auditimeve të veçantë. Zgjedhja e subjekteve për auditim bëhet duke parë rëndësinë që kanë këto subjekte për qytetarët. Në përfundim të auditimeve ne synojmë publikimin e rezultateve të auditimit në një mënyrë që të jetë e lexueshme për qytetarët theksoi në fund z. Rasmussen. Për SAI-n e Kilit referoi z. Ramiro Mendoza Zúñiga, Kontrollor Gjeneral i Republikës së Kilit dhe Sekretar Ekzekutiv i OLACEFS, i cili në prezantimin e tij u përqendrua në parimet bazë të qeverisjes dhe kohezionit social, kontrollin dhe qytetarët në Amerikën Latine, transparencën e praktikave të një SAI, praktikat e llogaridhënies bazuar në menaxhimin e llogaridhënies sikurse dhe në integritetin dhe cilësinë e stafit të një SAI.

2. Mundësia e angazhimit të qytetarëve nga SAI-t me qëllim rritjen e llogaridhënies publike në zhvillimin e qëndrueshëm nga Elia Armstrong, Shefe e Degës së Menaxhimit të Zhvillimit, UN DESA.

Zj. Armstrong në prezantimin e saj u përqendrua në vendin që i takon llogaridhënies publike në zhvillimin e qëndrueshëm. Ajo theksoi se SAI-t mund të angazhojnë qytetarët në punën e tyre me qëllim përmirësimin e llogaridhënies publike. Angazhimi i qytetarëve mund të bëhet gjatë fazave të informimit, konsultimit dhe vendimmarrjes, nëpërmjet proceseve interaktive.

3. "Qeverisja e mirë: Mbrojtja e burimeve publike në përfitim të qytetarëve", nga Zj. Margaret Saner, nga Komiteti i Ekspertëve të Administrimit Publik të Kombeve të Bashkuara (CEPA).

Në prezantimin e saj Zj. Saner u përqendrua në auditimin sipas kontekstit lokal, në sqarimin e konceptit të përfshirjes së qytetarëve, ku sipas saj ekziston një spektër i gjerë i formave të angazhimit të qytetarëve duke filluar nga ofrimi i thjeshtë i informacionit nëpërmjet konsultimit dhe pjesëmarrjes deri në vendimmarrje nëpërmjet dhënies së zgjidhjeve në bashkëpunim.

Në këtë Simpozium mori pjesë dhe një delegacion i KLSH, i kryesuar nga Kryetari dhe me dy drejtues departamentesh auditimi në përbërje të tij.

Simpoziumi i 23-të OKB/INTOSAI, Vjenë, 2-4 Mars 2015[11]

Në datat 2-4 mars u zhvillua në Vjenë Simpoziumi i 23-të, organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) me temë : "*Axhenda e zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën pas 2015: Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për zhvillimin e qëndrueshëm*".

Simpoziumi drejtohej nga z.Josef Moser, kryetar i Gjykatës Austriake të Audituesve dhe njëherazi Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe z. Wu Hongbo, Nën-Sekretar i Përgjithshëm për Çështjet Social Ekonomike në Kombet e Bashkuara. Punimet e simpoziumit u përshëndetën në ditën e parë të tij nga SHTZ. Heinz Fischer, President i Austrisë.

Çështja e parë që u trajtua lidhej me pritshmërinë që kanë parlamentet, qeveritë, Kombet e Bashkuara, organizatat e shoqërisë civile, donatorët, qytetarët etj, në lidhje me rolin që mund të luajnë Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) në zhvillim e qëndrueshëm. U theksua rëndësia e e forcimit të mekanizmave të mbikqyrjes dhe e

[11] *http://www.intosai.org/news/previous-information/previous-information-2015/020315-23-un-int-symposium.html*

rolit të parlamenteve dhe rëndësia vitale që ka monitorimi, dhe raportimi në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Çështja e dytë lidhej me parakushtet që duhet të plotësojnë SAI-et për t'u angazhuar në mënyrë efektive ne Axhendën e zhvillimit të Pas-2015, si pavarësia e SAI-ve, kapacitet e nevojshme profesionale të SAI-ve për të audituar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, mandatin e nevojshëm, etj.

Simpoziumi u përqendrua gjithashtu në mundësitë konkrete të SAI-ve për t'u angazhuar në mënyrë efektive në axhendën e Zhvillimit të Pas-2015 dhe eksperiencat konkrete të tyre dhe u evidentuan fushat në të cilat kërkohet përmirësim, si qeverisja dhe ndërtimi i kapaciteteve në administratën publike, transparenca, llogaridhënia dhe partneriteti.

Trajtimi i temës së zhvillimit të qëndrueshëm dhe roli që mund të luajnë SAI-et në këtë drejtim pasqyron rëndësinë që i kanë dhënë Kombet e Bashkuara dhe komuniteti i INTOSAI-t avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Simpoziumi punoi intensivisht në drejtim të rolit që duhet të luajnë SAI-t në Axhendën e Zhvillimit të Pas-2015 dhe në implementimin e saj. Simpoziumi përpunoi tezat si më poshtë :

- Pritshmëritë që kanë partnerët dhe qytetarët për SAI-t lidhur me çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm,

- Parakushtet që duhet të plotësojnë SAI-et për t'u angazhuar në mënyrë efektive në Axhendën e zhvillimit të Pas-2015 dhe plotësimi i detyrimeve që lindin nga strategjia e objektivave të zhvillimit, të vendosura nga shtetet anëtare në rezolutën A/66/228,

- Eksperiencat dhe mundësitë e SAI-ve për t'u angazhuar në Axhendën e zhvillimit të Pas-2015. Në përfundim të punimeve, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e përmbushjes së pritshmërive që kanë partnerët tek SAI-t dhe INTOSAI :

- Qytetarët i shikojnë SAI-t si institucione të besueshme, të cilat nëpërmjet raporteve dhe gjetjeve të tyre ndihmojnë në përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet.

- Legjislativi pret nga SAI-t informacione të pavarura, objektive dhe në kohë në lidhje me përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efikasitet, duke pasur një vëmendje të veçantë në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

- Kombet e Bashkuara presin nga INTOSAI dhe SAI-t të zhvillojnë standardet dhe kapacitetet e nevojshme, për të qenë të aftë të zbatojnë dhe të arrijnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Miratimi në shtator të 2015 i axhendës së Zhvillimit të Pas-2015 pritet të sjellë ndryshime transformuese në lidhje me mënyrën se si do të rriten ekonomitë e vendeve tona, se si do të zhvillohen shoqëritë tona, se si do të bashkëpunojnë të gjitha vendet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara për të luftuar ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e planetit tonë .

Në këtë Simpozium mori pjesë dhe një delegacion i KLSH, i kryesuar nga Kryetari dhe drejtues të tjerë të lartë në përbërje të tij.

Kapitulli IV

NIK-u polak dhe Parlamenti, NAO Britanike, SAI-et Hollandës, Danimarkës, Norvegjisë, Portugalisë dhe Parlamentet e tyre

Britania e Madhe, Komisioni i Llogarive Publike

Ndërtesa e Parlamenti Britanik në Londër

Ndërtesa e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Londër

1. Origjina e Komisionit të Llogarive Publike

- Komisioni i Llogarive Publike u formua në vitin 1861, nga një nismë e William Gladstone, atëhere Kancelari i Thesarit (Ministri i Financave) i Mbretërisë së Bashkuar. Nisma pasoi një raport nga e Komisioni i Zgjedhur mbi Paratë Publike në vitin 1857, i cili rekomandonte që llogaritë që krahasonin shpenzimet me paratë e votuara nga Parlamenti të përgatiteshin për të gjithë departamentet e Qeverisë dhe të dorëzoheshin çdo vit tek një komision i Dhomës së Komuneve.

- Krijimi i Komisionit të Llogarive Publike u pasua pesë vjet më vonë, më 1866 nga Ligji (Akti) për Departamentet e Thesarit dhe të Auditimit, i cili kërkohet që të gjitha departamentet qeveritare të përgatisnin llogari për auditimin e pavarur. Akti gjithashtu krijoi postin e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm, duke kombinuar funksionet e Kontrollorit të Thesarit me ato të Komisionerëve të Auditimit.

- Sipas neneve të Ligjit të vitit 1866, Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm autorizonte dhënien e fondeve tek departamentet qeveritare, shqyrtonte çdo llogari të fondeve të akorduara nga Parlamenti dhe i raportonte rezultatet e auditimeve të tij Komisionit të Llogarive Publike. Komisioni i Llogarive Publike pastaj i raportonte konkluzionet e tij Dhomës së Komuneve.

2. Veprimtaria e Komisionit të Llogarive Publike

- Komisioni i Llogarive Publike vepron nën Rregulloren 148 të Dhomës së Komuneve. Ai është një grup që përfaqëson të gjitha partitë e Parlamentit Britanik, i përbërë nga 15 deputetë, duke përfshirë Sekretarin Financiar të Thesarit. Komiteti nuk kërkon të merret me politikë: qëllimi i tij është të shqyrtojë nëse fondet, paratë publike të votuara nga Parlamenti janë shpenzuar në përputhje me dëshirat e Parlamentit.

SIr Amyas Morse, Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit (NAO) të Britanisë së Madhe (i dyti nga e majta) duke marrë pjesë në një mbledhje të Komisionit të Llogarive Publike të Parlamentit Britanik, gjatë diskutimit të projektit të braktisur me vlerë 100 milionë euro të rrjetit televiziv shtetëror BBC "Nisma e Medias Dixhitale", më 18 maj 2016.

- Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Komisioni i Përzgjedhjes, në bazë të përfaqësimit të partive në Dhomën e Komuneve. Sipas Rregullores Parlamentare, Kryetari i Komisionit të Llogarive Publike ka qenë gjithmonë një anëtar i lartë i opozitës zyrtare dhe është zakonisht një ish-ministër. Kryetare e tanishme është zj. Meg Hillier e Partisë Laburiste, ish-Sekretare e Shtetit për Energjinë dhe Ndryshimin Klimatik.

- Veprimtaria e Komisionit të Llogarive Publike shtrihet në të gjitha departamentet e qeverisë qendrore, në agjencitë ekzekutive dhe në departamentet vendore. Ajo gjithashtu përfshin Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, Institucionet më të larta të arsimit dhe rreth 1700 agjenci dhe institucione të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, të cilat marrin grante nga departamentet qeveritare. Shpenzimet totale dhe të ardhurat që mbikëqyr Komisioni kapin shifrën e mbi 600 miliardë sterlinave në vit.

- Marrëdhëniet e Komisionit të Llogarive Publike me Kontrollorin dhe Audituesin e Përgjithshëm të NAO-s Britanike janë në qendër të punës së Komisionit. Hetimet e tij janë të bazuara në raportet e auditimeve të NAO-s dhe në memorandumet e paraqitura nga kjo e fundit në Parlament dhe në Komision nga Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm. Ai është audituesi i jashtëm i të gjitha departamenteve të qeverisë dhe agjencive dhe i një game të gjerë të organeve të tjera publike. Sipas Ligjit të Auditimit Kombëtar të vitit 1983, Kontrollori dhe

Audituesi i Përgjithshëm i NAO-s gjithashtu ka fuqinë që t'i raportojë Parlamentit Britanik mbi ekonomicitetin, efiçiencën dhe efektivitetin me të cilat këto institucione të lartpërmendura kanë përdorur burimet e tyre.

- Kjo realizon një marrëdhënie të ngushtë mes Komisionit të Llogarive Publike dhe Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm të NAO-s. Kryetari i Komisionit dhe Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm takohen rregullisht për të diskutuar çështje me interes të përbashkët, si dhe Nao dhe Komisioni mbajnë takime të rregullta dhe periodike për të diskutuar punën e ardhshme.

Boksi i mëposhtëm paraqet strukturën dhe mënyrën e funksionimit të Zyrës Kombëtarë të Auditimit (NAO):

Boks 12

NAO

Historia

1. Zyra e Kontrollorit dhe Audituesit të Përgjithshëm është krijuar nga Ligji për Thesarin dhe Departamentet e Auditimit të vitit 1866. Kontrollori i Përgjithshëm emërohet nga Mbretëresha, me propozimin e Kryeministrit, aprovimin e Kryetarit të Komitetit të Llogarive Publike dhe miratimin e Dhomës së Komuneve. Ai është një zyrtar i Dhomës së Komuneve.

2. NAO kontrollon shpenzimet publike në emër të Parlamentit dhe punëson një staf prej 880 vetash. Kontrollori i Përgjithshëm verifikon llogaritë e të gjitha departamenteve qeveritare dhe një gamë të gjerë të organeve të tjera të sektorit publik dhe ai ka autoritet ligjor për të raportuar në Parlament mbi ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin me të cilat departamentet dhe organe të tjera kanë përdorur burimet e tyre. Ai dhe NAO janë krejtësisht të pavarur nga qeveria.

Veprimtaria

Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) mbikqyr shpenzimet publike në emër të Parlamentit, duke e ndihmuar atë t'u kërkojë llogari departamenteve të qeverisë dhe për të ndihmuar drejtuesit e shërbimit publik në përmirësimin e punës dhe shërbimin e ofruar.

NAO auditon pasqyrat financiare të të gjitha departamenteve qeveritare dhe një gamë të gjerë të organeve të tjera publike dhe prodhon rreth 60 vlerësime të raporteve të auditimit në vit.

- Në vitet 2011-2012, NAO ka audituar shpenzimet dhe të ardhurat me vlerë që arrin mbi 1 trilion stërlina nëpërmjet 458 llogarive.
- Vlerësimet e NAO-s përmbajnë rekomandime si të përmirësohen shërbimet. Programi i punës është i fokusuar në tre fusha që ndikojnë në ecurinë e të gjitha departamenteve në arritjen e vlerave financiare: përmirësimin e menaxhimit financiar dhe raportimit; duke përdorur më mirë informacionin; dhe për të siguruar që shërbimet janë kryer me kosto-efektive.

Puna e NAO-s çon në një efikasitet të kursimeve dhe fitimeve në shuma prej qindra miliona paund. Në vitin 2011 shuma e kaloi 1 miliardë stërlina.

3. Zyrtarët e Llogarive

- Sistemi i Zyrtarëve të Llogarive(Kontabilitetit) është një tjetër tipar kryesor i Komisionit të Llogarive Publike në Britaninë e Madhe. Një "Zyrtari i Llogarive" emërohet nga Thesari për çdo votë parlamentare dhe për secilën agjenci ekzekutive dhe strukturë jo- departamentale publike. Zyrtari i Llogarive është zakonisht Sekretari i përhershëm i një departamenti qeveritar apo shefi ekzekutiv i një agjencie qeveritare, ose i një institucioni jo-qeveritar publik. Një zyrtar i Llogarive ka një përgjegjësi personale për të siguruar menaxhimin e duhur financiar brenda organizatës së tij/saj, si dhe për llogari të Komisionit për menaxhimin e tij/saj të fondeve publike.

4. Dëgjesat publike të Komisionit të Llogarive Publike

- Nëse Komisioni vendos për të dëgjuar provat në bazë të një raporti auditimi të sjellë nga NAO, ai do të thërrasë zyrtarin përkatës të Llogarive për të dhënë dëshminë e tij/saj dhe sjellë provat përkatëse. Zyrtari i kontabilitetit është shqyrtuar së bashku me zyrtarin e Thesarit që mbulon llogaritë e institucionit në fjalë, zakonisht një zyrtar i lartë i Thesarit, i cili përgjigjet në emër të Qeverisë për shumë çështje të përgjithshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e fondet publike që dalin jashtë kornizës së zyrtarit të Llogarive të agjencisë së audituar. Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm gëzon statusin e një dëshmitari të përhershëm përpara Komisionit dhe zëvendësi i tij merr pjesë në të gjitha seancat.

Menjëherë pas publikimit të raportit të auditimit të NAO-s mbi programin qeveritar të mbështetjes sociale ndaj personave me aftësi të kufizuar, Komisioni i Llogarive Publike organizon seancë dëgjimore me drejtuesit e programit përkatës qeveritar, në praninë e përfaqësuesve të shoqatave të personave me aftësi të kufizuar dhe të drejtuesve të lartë të NAO-s, 20 mars 2015.

- Edhe pse Komisioni i Llogarive Publike pranon se Zyrtarët e Llogarive do të kenë deleguar gjerësisht përgjegjësitë e tyre, kjo nuk i largon ata nga përgjegjësia e tyre që të japin llogari përpara Komisionit dhe Parlamentit për të gjitha fushat e shpenzimeve për të cilat ata janë përgjegjës.

- Dëgjesat e Komisionit për çështjet e ngritura nga auditimet e NAO-s zakonisht mbahen publike dhe mund të jenë në televizion apo të regjistrohen për transmetimet radio. Një rregjistrim fjalë për fjalë të provave të paraqitura mbahet në të gjitha rastet dhe është zakonisht në dispozicion të publikut si një dokument i Dhomës së Komuneve.

5. Raportet e Komisionit të Llogarive Publike

- Pas një seancë të dëgjimit të provave dhe marrjes në konsideratë të provave të tjera të përgatitura me kërkesë të Komisionit gjatë seancës dëgjimore, Komisioni i Llogarive Publike mblidhet për të marrë në shqyrtim një draft raport nga Kryetari i Komisionit. Raporti përfundimtar do të përmbajë një numër të gjetjeve dhe rekomandimeve bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit të NAO-s, si dhe do të përfshijë procesverbalet e dëshmive të seancës dëgjimore.

- Në përgatitjen e rekomandimeve të tij, Komisioni i Llogarive Publike kërkon të zhvillojë ekspertizë në fusha të veçanta dhe të shpërndajë praktikën e mirë. Për shembull, Raporti i Komiteti të Llogarive Publike <u>për Programin Qeveritar të Mbështetjes së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME-ve)</u>, i publikuar më 18 maj 2016[1], thotë se Qeveria e ka humbur momentin në përpjekjet e saj për të shpenzuar më shumë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të.

Komisioni arrin në përfundimin se ndërsa Qeveria ka raportuar progres kundrejt objektivit të saj për shpenzimet e SME-ve nga viti 2010 deri në vitin 2015, "*nuk është*

---

[1] *http://www.parliament.uk/business/committees/committees-a-z/commons-select/public-accounts-committee/news-parliament-2015/commissioning-contracting-smaller-providers-report-published-15-16/*

e qartë se SME-të tani janë më të afta për të konkurruar me ofruesit më të mëdhenj se sa ato në treg, ose nëse ato janë duke marrë ndonjë tender më shumë se më parë nga ana e Qeverisë".

Komisioni nuk është i bindur se nisma për të hequr pengesat për SME-të ka rezultuar në një konkurrencë më të rritur, duke parë provat se ofruesit e mëdhenj të shërbimeve dhe mallrave vazhdojnë të dominojnë në treg.

Një shembull tjetër është Raporti i Komisionit i publikuar me 4 maj 2016 **"**Llogaridhënia në Parlament për paranë e taksapaguesve" [2]. Raporti vlerëson se "*Zyrtarët e Llogarive të Departamenteve janë një element i rëndësishëm në aftësinë e Parlamentit për mbajtur Qeverinë të përgjegjshme. Ata janë personalisht përgjegjës dhe u kërkohet llogari nga Parlamenti për përdorimin nga ana e departamentit që mbulojnë të parasë publike dhe administrimin e aseteve të saj. Ata kanë për të balancuar këto përgjegjësi në Parlament me përgjegjësitë e tyre të tjera si Sekretarë të Përhershëm për të shërbyer pranë Ministrive të tyre* ». Ndërkohë, Raporti vëren se «*Megjithatë, metodat gjithnjë e më komplekse të ofrimit të shërbimeve publike dhe mungesa e vazhdueshme e treguesve të qartë të kostos së shumë programeve qeveritare dhe e të dhënave të performancës kanë minuar llogaridhënien. Ka edhe shumë shembuj se si Zyrtarët e Llogarive të Departamenteve kanë lejuar projekte dhe iniciativa, të tilla si financimi për Kompaninë e Fëmijëve dhe programin e-Kufi, që këto programe të vazhdonin të financoheshin, pavarësisht provave të forta për vlerën e dobët të shërbimit publik për paranë e ofruar. Kur një Zyrtar i Llogarive ka shqetësime serioze rreth vlerës së dobët të shërbimit publik për paranë e ofruar, ai ose ajo mund ta bëjnë të pranishëm shqetësimin duke kërkuar zyrtarisht(dhe publikisht) nga Ministri një « Drejtim ministror » për të vazhduar. Mirëpo drejtimet nuk janë duke u përdorur në mënyrë efektive si një kontroll i llogaridhënies: ato janë të pakta dhe shumë larg numrit të Zyrtarëve të Llogarive që kanë shqetësime në lidhje me vlerën për para të shërbimit publik të ofruar ose për leverdishmërinë e politikave qeveritare në departamentin e tyre. Për pasojë ka një mungesë të dëmshme të transparencës, pasi shqetësimet e Zyrtarëve të Llogarive për përdorimin e parasë publike nuk janë sjellë në vëmendjen e Parlamentit* ». Raporti përfundon që «*Ne synojmë që të kthehemi rregullisht tek llogaridhënia efektive në punën tonë, për të siguruar që qeveria të mbahet përgjegjëse për shpenzimin e parave të taksapaguesve* ».

---

[2] *http://www.publications.parliament.uk/pa/cm201516/cmselect/cmpubacc/732/73202.htm*

Një tjetër raport i Komisionit të Llogarive Publike që ka bërë bujë në Britani është "Trajtimi i mashtrimit tatimor[3]", raport i publikuar me 15 prill 2016. Në të Komisioni konstaton se "*Drejtoria e Taksave dhe Doganave nuk po bën sa duhet për të trajtuar mashtrimet tatimore, të cilat janë përgjegjëse për të paktën 16 miliardë sterlina në tatime të pa mbledhura çdo vit. Drejtoria ka bërë progres të kufizuar vetëm në uljen e nivelit të humbjeve të mashtrimit tatimor i cili ka mbetur relativisht konstant gjatë 5 viteve të fundit, me rreth 3% të të gjitha detyrimeve tatimore. Strategjia e Drejtorisë së Taksave dhe Doganave për trajtimin e mashtrimit tatimor është e paqartë, sidomos qasja e saj për ndjekjen penale, ku ajo nuk e di numrin e nevojshëm për të siguruar një pengesë efektive ndaj mashtrimit. Dështimi për të ndjekur më shumë se një individ nga lista "Falciani", ku Drejtoria e ka mbyllur këtë rast, si dhe Autoriteti i Sjelljes Financiare që nuk marrë masa të mëtejshme, të krijon përshtypjen në publik se të pasurit mund t'ia hedhin me evazionin fiskal. Drejtoria e Taksave dhe Doganave gjithashtu duhet të shpjegojë se pse shuma e tatimit që pretendon se ka nxjerrë nga puna e saj e pajtueshmërisë me taksat rritet ndjeshëm çdo vit, por madhësia e hendekut tatimor (diferenca midis shumës së tatimit që ajo mbledh dhe sa në teori duhet të mbledhë) qëndron e njëjtë*".

Në tërësi, rekomandimet e Komisionit marrin një qasje largpamëse për të siguruar që mësimet janë mësuar për të ardhmen. Në vitet e fundit, Komisioni i Llogarive Publike ka ndihmuar në zhvillimin e teknikave të reja të menaxhimit publik, të tilla si matja e performancës dhe Kontabiliteti burimor.

- Dhoma e Përfaqësuesve ka një mundësi vjetore për të debatuar raportet që Komisioni i Llogarive Publike ka prodhuar gjatë gjithë vitit. Sipas Ligjit mbi Parlamentin, Kryetari i Komisionit prezanton debatin dhe përmbledh disa nga raportet e publikuara nga Komisioni gjatë 12 muajve. Sekretari Financiar i Thesarit, një Ministër i qeverisë, i përgjigjet debatit. Ky debat plotëson rrethin e përgjegjësisë, i cili fillon me miratimin në Parlament të buxheteve të departamenteve apo parashikimeve për to.

[3] *http://www.publications.parliament.uk/pa/cm201516/cmselect/cmpubacc/674/67403.htm#_idTextAnchor004*

6. Procesverbali i Thesarit

- Me një marrëveshje që i qëndron kohës shumë mirë, Qeveria duhet t'i përgjigjet një raporti të Komisionit të Llogarive Publike brenda dy muajve. Përgjigjet janë të njohura si Proces-verbali i Thesarit, duke reflektuar faktin se ata janë koordinuar nga Departamenti i Thesarit (ose ndryshe Ministria e Financave), i cili përgjigjet për të gjitha rekomandimet që ndikojnë në tërë Qeverinë.

- Mbi 90% e rekomandimeve të Komisionit të Llogarive Publike pranohen çdo vit dhe gjatë tre viteve fundit, puna e NAO-s dhe e Komisionit ka çuar në kursime prej mbi 1.78 miliardë sterlina, ose me një mesatare prej 592 milionë sterlina në vit[4].

[4] Portali https://www.nao.org.uk/

Polonia

Rasti i një bashkëpunimi intensiv SAI-Parlament (NIK-SEJM)

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe NIK-ut Polak në datën 23 maj 2012 në Varshavë, nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe Presidenti i NIK, z.Jacek Jezierski.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj dhe Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, Z. Krzysztof Kwiatowski gjatë nënshkrimit të një Deklarate të Përbashkët në datën 3 mars 2016.

Dhoma e Kontrollit të Lartë Shtetëror (NIK) është organi më i lartë i kontrollit të shtetit në Poloni dhe i raporton Parlamentit polak (Sejm). Kjo vartësi parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Polonisë dhe në Ligjin mbi Zyrën Supreme të Auditimit.

NIK i paraqet Sejm-it mbi 150 deklarimeve mbi rezultatet e auditimit, duke ndjekur misionin e tij, i cili është për të informuar Parlamentin për gjendjen e shtetit, përfshirë financat publike. Në seancat plenare të Sejm, President i NIK paraqet dokumente të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e NIK, si dhe opinionet e tij mbi çështjet kritike që lidhen me auditimet e kryera nga NIK.

Ish-Presidenti i NIK, z. Jacek Jezierski, një nga personalitetet më të spikatura të auditimit suprem publik ne Evropë, ne adresimin e tij të fundit përpara Parlamentit polak Sejm, me 14 korrik 2013, shprehej:" *E nderuar Zj. Kryetare dhe te nderuar deputete anëtarë te Sejm! Në vitin 2012, kemi dërguar 185 raporte me rezultatet e auditimit në Sejm. Kemi audituar 2.856 subjekte. Kemi përfshirë gjetjet tona në 2.930 deklarata pas auditimit. Ne kemi zhvilluar 65 propozime për përmirësime ligjore, duke sugjeruar ndryshime specifike në shumë ligje themelore të Shtetit. I kemi dërguar Prokurorisë 136 raporte të dyshimit të arsyeshëm për krim ndaj interesave financiare të Shtetit, si dhe 182 njoftime të shkeljes së disiplinës së financave publike*[5] *».*

[5] *Jacek Jezierski, raport përpara Parlamentit Polak, 14 korrik 2013.*
https://www.nik.gov.pl/en/news/report-on-nik-s-activity.html

Boksi i mëposhtëm paraqet strukturën e organizimit të Dhomës Kombëtare të Auditimit Shtetëror (NIK) të Polonisë:

Boks 13

Zyra e Lartë e Auditimit ose NIK (emri i mëparshëm ka qenë Dhoma e Lartë e Kontrollit) është organi më i lartë i pavarur i auditimit, misioni i të cilit është të mbrojë shpenzimet publike. Për më shumë se 90 vjet, NIK ka vlerësuar funksionimin e shtetit polak dhe menaxhimin e fondeve publike.

Funksionimi dhe organizimi i NIK-ut është parashikuar në Kapitullin 9 të Kushtetutës së Republikës së Polonisë dhe në Ligjin për NIK-un, më 23 dhjetor 1994 (me amendimet e paraqitura nga Ligji i 22 janarit 2010).

Në vitin 2014, nga auditimet e NIK, rezultoi se dëmi nga parregullsitë financiare ishte rreth 4.5 miliardë dollarë. Çdo shtetas që paguan taksat për shtetin, kërkon të jetë i sigurt që këto para shpenzohen në mënyrë të përshtatshme. NIK, si monitorues i fondeve publike, kujdeset për shpenzimet efikase dhe të besueshme të këtyre fondeve. Veç zbulimit të parregullsive, NIK propozon edhe zgjidhjet e mundshme që synojnë shpenzime më efikase në të ardhmen. Auditimet e NIK zbulojnë se në cilat fusha shteti funksionon mirë dhe në cilat duhet të bëhen përmirësime. Disa përmirësime bëhen gjatë auditimeve, ndërsa të tjera në përfundim të tyre. Nëse parregullsitë rrjedhin nga vakume në rregullore apo nga dispozita ligjore të paqarta, NIK propozon ndryshime në ligj.

Zyra e Lartë e Auditimit heton çdo fushe ku përfshihen shpenzimet publike dhe përdorimi i pasurive shtetërore. NIK gjithashtu kontrollon nëse institucionet publike bëjnë punën e tyre në mënyrë efektive, efikase dhe ekonomikisht. Çdo vit, NIK auditon mijëra subjekte, duke paraqitur kështu pamjen e përgjithshme të funksionimit të shtetit. Deklarimet mbi rezultatet e auditimit i paraqiten Sejm-it (Dhoma e ulët e Parlamentit polak) dhe institucioneve përgjegjëse për funksionimin e duhur të subjekteve të audituara.

Në seancat plenare të Sejm-it, NIK paraqet dokumentat më të rëndësishëm dhe opinionin e saj mbi çështjet më të rëndësishme që lidhen me kontrollet që kryen. Përfaqësuesit e NIK marrin pjesë edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe të nën-komiteteve.

NIK i paraqet Sejm-it dokumentet e mëposhtme:

- Analiza e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare
- Opinione mbi votimin për miratimin e qeverisë
- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të urdhëruar nga Sejmi dhe organet e tij
- Deklarimet mbi rezultatet e auditimeve të kryera me kërkesë të Presidentit dhe Kryeministrit si dhe rezultatet e auditimeve të rëndësishme
- Mocionet në Sejm për shqyrtimin e problemeve të caktuara në lidhje me organet që kryejnë detyra publike
- Prononcimet mbi kundërshtimet për sa i përket veprimtarisë së Ministrave, Krerëve të Zyrave Qendrore ose Presidentit të Bankës Kombëtare që vijnë nga auditimet e kryera nga NIK
- Raport mbi aktivitetin e vitit të shkuar
- Informacion se si janë përdorur gjetjet e auditimit në lidhje me ligjvënien dhe aplikimin e tij.

Gjithashtu, NIK është i detyruar të paraqesë tek Sejm edhe një plan periodik pune. Rezultatet e auditimit nuk duhet të bëhen publike pa u dorëzuar më parë tek Sejm-i. Presidenti i NIK merr pjesë në seancat plenare të Sejm dhe çdo vit i paraqet Sejm-it "Analizën e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe udhëzimet mbi politikën monetare".

Çdo vit, përfaqësues të NIK marrin pjesë në qindra mbledhje parlamentare (në 2009 - 916 mbledhje, në 2010 - 720, në 2011 - 966, në 2012 - 932, në 2013 - 719). Ata paraqesin dhe japin shpjegime mbi rezultatet e auditimeve si dhe japin opinione mbi nismat ligjore të deputetëve. NIK bashkëpunon rregullisht me Komitetin Shtetëror të Auditimit, i cili është përgjegjës për të dhënë mendim mbi planin e punës të NIK, raportet vjetore të aktivitetit të tij, mbi buxhetin dhe raportin e ekzekutimit të tij etj. Komisioni kryen vlerësimin periodik të aktivitetit të Nik, duke përfshirë edhe analiza e deklarata mbi rezultatet e auditimit dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të

auditimit. Komiteti gjithashtu merret me veprimtaritë ndërkombëtare të NIK, bashkëpunimet me organe të tjera të auditimit në Poloni dhe me analizimin e ankesave dhe sugjerimeve drejtuar NIK.

Në Poloni, Komisioni përkatës parlamentar mund të shqyrtojë raportin e auditimit edhe duke nxjerrë një rezolute, por kjo bëhet rrallë në praktikë (zakonisht ajo nënkuptohet, sikurse thuhet në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit). Përveç kësaj, në varësi të përmbajtjes dhe konkluzioneve të raportit të auditimit, Komisioni mund të përgatisë dhe miratojë:

A. Një "Desideratum (Memorandum kërkesash)" të Komisionit. Ky Memorandum mund t'i drejtohet Këshillit të Ministrave, ministrave individualë ose organeve të tjera shtetërore qendrore. Marrësi është i detyruar t'i përgjigjet Memorandumit dhe t'i njoftojë Kryetarit të Sejm-it (Parlamentit) polak me shkrim mendimin e tij brenda 30 ditëve.

B. Një "opinion" me pikëpamjet e Komisionit mbi një çështje të caktuar. Opinioni mund të dërgohet në të njëjtat organe si Memorandumi. Një përgjigje ndaj opinionit nuk është e detyrueshme, por Komisioni mund të kërkojë një letër qëndrim të organit që i është dërguar opinioni lidhur me çështjet e ngritura në opinion (edhe brenda 30 ditëve).

Memorandume dhe opinione të miratuara nga Komisioni janë bërë shpesh, pas shqyrtimit të raporteve të auditimit, dhe ata nganjëherë përmbajnë një referencë të drejtpërdrejtë në raportin e auditimit të SAI-t. Përgjigjet ndaj memorandumeve dhe opinioneve, si dhe raportet e organeve shtetërore në fjalë për punën e tyre, shqyrtohen në mbledhjet e Komisionit. Në qoftë se një përgjigje nuk është marrë në kohë ose përgjigjja e marrë konsiderohet e pakënaqshme, Komisioni mund ta ri-dërgojë Memoradumin apo opinionin, të paraqesë një mocion te Kryetari i Sejm-it (Parlamentit) për refuzimin e përgjigjes si të pakënaqshme, ose të paraqesë një projekt-rezolute përkatëse për Sejm-in.

Presidenti i NIK, z. Krzysztof Kwiatkowski duke folur në Parlamentin Polak

Përfaqësuesit NIK gjithashtu marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare. NIK është i detyruar të paraqesë planin e tij vjetor të punës pranë Sejm. Në bazë të ligjit organik të NIK, Sejmi dhe organet e tij kanë gjithashtu të drejtë për të porositur auditime.

Presidenti i NIK merr pjesë në seancat plenare të Sejm, në bazë të Ligjit për NIK dhe aktit nënligjor të Sejmit polak. Çdo vit, Presidenti i NIK i paraqet Sejm-it Raportin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit dhe udhëzimet e politikës monetare, si dhe raportin e aktivitetit të NIK (raportin e Performancës).

Çdo vit, përfaqësuesit e NIK marrin pjesë në qindra mbledhje të komisioneve dhe nënkomisioneve parlamentare. Ata paraqesin rezultatet e auditimeve të NIK, japin shpjegimet përkatëse dhe shprehin opinionet e tyre për nismat legjislative të deputetëve. Përfaqësuesit e NIK gjithashtu mund të përdorin gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, të bëjnë komente mbi raportet dhe deklarimet e paraqitura në një komision të caktuar nga ana e përfaqësuesve të qeverisë ose pjesëmarrësve të institucioneve të tjera shtetërore në takim.

Në mënyrë të vazhdueshme, NIK bashkëpunon me Komisionin Parlamentar të Auditimit Shtetëror, i cili jep opinionet e tij mbi planin e punës të NIK, mbi raportin e tij vjetor të aktiviteteve, mbi buxhetin e NIK dhe raportin mbi ekzekutimin e tij. Komisioni bën vlerësimin periodik të veprimtarisë së NIK. Si pjesë e këtij vlerësimi shqyrton deklaratat mbi rezultatet e auditimit dhe analizon ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. NIK gjithashtu i paraqet Komitetit dokumenta, duke përfshirë por jo u kufizuar në aktivitetet ndërkombëtare të NIK, bashkëpunimin mes NIK dhe organeve të tjera të auditimit në Poloni, si dhe analizën e plotësimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve drejtuar NIK[6].

---

[6] *Faqja në internet e NIK. Dritarja mbi « Marrëdhëniet me Parlamentin ».*
https://www.nik.gov.pl/en/about-us/cooperation-with-the-parliament/

Danimarka

Marrëdhëniet mes SAI-t dhe Komisioneve Parlamentare [7]

Ndërtesa e Parlamentit Danez, Kopenhagen

Ndërtesa e SAI-t danez (Rigsreviosionen) në Kopenhagen

1. Roli i përgjithshëm dhe Objektivat e Parlamentit dhe Komisioneve Parlamentare në lidhje me SAI-n

Kushtetuta danez u miratua në vitin 1849 dhe dy vjet me vone, në 1851, u krijua Komiteti i Llogarive Publike të Parlamentit (PAC). Zyra Kombëtare e Auditimit e Danimarkës (NAOD) është vendosur si strukturë organizative nën Parlamentin, si institucion i pavarur.

Kompetencat dhe funksionet e PAC kanë marrë formën e tyre aktuale me Ligjin e Komitetit të Llogarive Publike të vitit 1976. Sipas ligjit, PAC mund të kërkojë që SAI të shqyrtojë dhe mbulojë me auditim fusha të caktuara të interesit të tij; me fjalë të tjera, PAC mund të kërkojë që një auditim i caktuar të kryhet. Pasi kryhet auditimi dhe raporti është plotësuar, ai i dërgohet PAC-ut. PAC e bazon punën e tij mbi raportet e SAI-t.

Auditori i Përgjithshëm e ndihmon PAC me një Raport që është një përmbledhje e llogarive të Shtetit. Duke vepruar kështu, sigurohet që të ardhurat e Shtetit janë të përfshira në llogari, si dhe që asnjë shpenzim nuk është paguar pa u kryer sipas autoritetit të Ligjit mbi Financat Publike ose një baze tjetër ligjore. PAC gjithashtu siguron se fondet administrohen siç duhet dhe se opinioni mbi financat e Shtetit është i shëndetshëm.

Parlamenti zgjedh gjashtë anëtarë të PAC, bazuar në përfaqësimin proporcional. Kështu që secila parti e madhe është përfaqësuar në PAC. Kryetari i PAC është anëtari

[7] *Pjesa më e madhe e materialeve janë siguruar nga portali http://www.rigsrevisionen.dk/*

me eksperiencë më të gjatë në grup. Anëtarët e PAC paguhen dhe nuk duhet të jenë domosdoshmërisht anëtarë të Parlamentit. Mandati i PAC-së është për katër vjet dhe ai nuk preket nga zgjedhjet e përgjithshme. PAC nuk është një komision parlamentar. Për këtë arsye, është Komisioni i Financave ai që zyrtarisht paraqet llogaritë e Shtetit në Parlament.

2. Marrëdhëniet mes PAC dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (NAOD)

NAOD është një organizatë e pavarur që kryen auditimet në emër të Parlamentit. Sipas Ligjit mbi Llogaritë e Shtetit (Akti i Audituesit të Përgjithshëm), i cili u miratua më 1 Janar 1976, auditimi i llogarive të Shtetit duhet të kryhet nga Audituesi i Përgjithshëm, i cili drejton një organizatë monokratike.

Pas amendimit të Aktit të Audituesit të Përgjithshëm në vitin 1991, NAOD u vendos organizativisht nën autoritetin e Parlamentit, ku Audituesi i Përgjithshëm emërohet nga Kryetari i Parlamentit me rekomandimin e PAC.

Në vitin 1996, Akti i Audituesit të Përgjithshëm u ndryshua përsëri, duke i dhënë, ndër të tjera SAI-t qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë dhe llojet e tjera të informacionit të kompanive publike. Për më tepër, Audituesi i Përgjithshëm u tërhoq nga te qenit auditues i shoqërive plotësisht me përgjegjësi të kufizuar. Përveç Aktit të Audituesit të Përgjithshëm, Audituesi i Përgjithshëm gjithashtu vepron nën Udhëzimin e Parlamentit për Audituesin e Përgjithshëm mbi marrëdhëniet me publikun dhe me Administratën Publike.

3. Roli i PAC në rishikimin e raporteve dhe produkteve të tjera të SAI-t

PAC shqyrton raportet e Audituesit të Përgjithshëm, dhe pastaj Komisioni (PAC) komenton mbi to; prej këtej raportet dorëzohen në Parlament dhe ministri që mbulon aktivitetin e institucionit të audituar. Ministrat duhet të përgjigjen ndaj raporteve brenda katër muajsh, duke përshkruar veprimet korrigjuese që synojnë të ndërmarrin. Ministrat janë të detyruar të përgjigjen, sepse Akti(Ligji) i Përgjegjësisë Ministrore i bën ata politikisht dhe administrativisht përgjegjës për zonën e kompetencave të tyre. ai paraprirë tabelë ilustron marrëdhëniet ndërmjet NAOD, KMFP, ministritë dhe Parlamenti. Shigjetat e kuqe me origjinë nga ministritë të tregojnë procesin e kontradiktore.

Pasi Audituesi i Përgjithshëm ka marrë përgjigjen e një ministri ndaj një raporti, Audituesi i Përgjithshëm ka një muaj që të konsiderojë përgjigjen dhe të raportojë pikëpamjet dhe qëndrimet e tij tek me një memorandum vijues. Përgjigjet e Ministrave dhe opinionet e Audituesit të Përgjithshëm ndaj këtyre përgjigjeve riprodhohen në raportin përfundimtar të PAC mbi llogaritë e Shtetit.

Sipas Kushtetutës, raporti përfundimtar mbi llogaritë e Shtetit formon bazën për Parlamentin që të miratojë llogaritë e Shtetit, ose quajtur ndryshe Buxhetin e Shtetit të vitit të kaluar.

4. Pavarësia e SAI-t

Sipas Aktit(Ligjit) të Audituesit të Përgjithshëm, Audituesi i Përgjithshëm është i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Audituesi i Përgjithshëm vendos se si të organizojë dhe të kryejë auditimet, si dhe nëse janë të nevojshme auditime shtesë. PAC është i vetmi organ që mund të kërkojë kryerjen e një auditimi.

5. Roli i PAC në programin e auditimeve të SAI-t, kërkesat për auditimet dhe metodologjinë e auditimit

Për shkak se Auditori i Përgjithshëm është i pavarur në kryerjen e detyrave të tij, PAC nuk merr pjesë në planifikimin e auditimeve të SAI-t, as nuk diskuton zgjedhje të metodologjisë në auditim. Megjithatë, Audituesi i Përgjithshëm e inkorporon në programin e auditimit kërkesën e PAC për auditime.

6. Funksione të tjera

PAC ia bën propozimin për emërimin dhe shkarkimin e Audituesit të Përgjithshëm të Kryetarit të Parlamentit, i cili, pas negocimeve me zëvendës Kryetaret e Parlamentit, ia paraqet kandidaturën Komitetit të Përhershëm Ligjor në Parlament. Nëse propozimi nuk miratohet, Kryetari njofton PAC, i cili më tej paraqet një kandidaturë të re. PAC mund të kërkojë që pozicioni i Audituesit të Përgjithshëm të shpallet edhe një herë.

PAC zakonisht mblidhet një herë në muaj dhe vlerëson me kujdes raportet e auditimit. Audituesi i Përgjithshëm merr pjesë në takimet e PAC, ku raportet më të fundit të auditimit janë diskutuar tërësisht, si dhe jepen ide të reja për raportet e auditimit.

Që me miratimin e Aktit të vitit 1991, buxheti i SAI-t paraqitet nga Audituesi i Përgjithshëm në PAC. PAC e diskuton atë, bën komente dhe ia dërgon Kryetarit të Parlamentit, i cili siguron se ai është konsideruar së bashku me buxhetin e vet Parlamentit. Buxheti i SAI-t është pjesë e Buxhetit te Parlamentit.

Auditimi i vete SAI-t kryhet nga Grothen dhe Perregaard, një kompani e certifikuar e auditimit publik, në përputhje me Ligjin e Audituesit të Përgjithshëm dhe Udhëzimin e Përhershëm të Parlamentit. Auditimi kryhet në përputhje me parimet, siç përcaktohet në praktikat e mira të Auditimit Publik, dhe përfshin auditimin financiar, si dhe auditimin e performancës.

Sipas Ligjit të Audituesit të Përgjithshëm, Audituesi i Përgjithshëm i ndihmon ministrat në organizimin e kontabilitetit dhe të auditimit të brendshëm. Prandaj dhe ministritë ia përcjellin të gjithë draft-legjislacionin përkatës për shqyrtim SAI-t.

Norvegji

Marrëdhëniet mes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë dhe Komisioneve Parlamentare [8]

Ndërtesa e Parlamentit Norvegjez, Oslo

Ndërtesa e SAI-t Norvegjez, Oslo

1. Roli i përgjithshëm dhe objektivat e Parlamentit dhe komisioneve parlamentare në raport me SAI-n

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (OAG) është agjencia kontrolluese e Parlamentit, Ligjvënësit. Zanafilla e saj daton qysh prej Kushtetutës Norvegjeze të vitit 1814, e cila përcaktonte se Parlamenti, gjatë mandatit katër vjeçar, kishte të drejtën të zgjidhte pesë Auditor të Përgjithshëm për të vlerësuar të dhënat financiare të qeverisë. Këta 5 auditorë të përgjithshëm, njëri prej të cilëve caktohej kryetar, përbënin Bordin e Përgjithshëm të Audituesve me kompetencë të plotë për të mbikëqyrur të gjitha çështjet e politikës së përgjithshme. Natyra politike e audituesve të përgjithshëm reflekton përbërjen politike të Parlamentit prandaj ky bord përbëhet shpesh nga ish-anëtare të Parlamentit.

OAG-ja është organi mbikëqyrës i Parlamentit. I paraqet ligjvënësit si rezultatet e auditimeve të realizuara, ashtu edhe një raport mbi vetë aktivitetin e saj. Të gjitha komunikimet e OAG-së publikohen si dokumente zyrtare parlamentare dhe shqyrtohen në sesionet plenare të Parlamentit. Të gjitha gjetjet e OAG-së prezantohen dhe trajtohen, në emër të Parlamentit, nga Komisioni i Përhershëm i Hetimit dhe i Çështjeve Kushtetuese (këtu e në vazhdim Komisioni)

---

[8] *Pjesa më e madhe e materialeve janë siguruar nga portali https://www.riksrevisjonen.no/en/Pages/Homepage.aspx*

Komisioni duhet të shqyrtojë dhe t'i paraqesë rekomandime Parlamentit mbi:

• komentet e OAG-së, së bashku me përgjigjet dhe miratimin e llogarive vjetore si dhe vendimet e masat e rekomanduara në lidhje me këtë çështje

• Raportin vjetor të OAG-së mbi aktivitetin e saj, si dhe raportin nëse auditimet mbi llogaritë janë realizuar në përputhje me udhëzimet ndaj OAG-së

• Raportet e OAG-së rreth auditimit të administratës dhe mbrojtjes së interesave shtetërore në sipërmarrjet shtetërore, etj... dhe çështjeve lidhur me akvititetet e OAG-së.

2. Përbërja dhe Modeli i Veprimit të Komisioneve Parlamentare përballë SAI-t

Pas zgjedhjeve, të gjithë anëtarët e Parlamentit emërohen në përbërjen e komisioneve të përhershme parlamentare. Procedurat e përzgjedhjes dhe detyrat për komisionet e ndryshme janë të përcaktuara në Rregulloren e Parlamentit. Sipas këtyre rregullave, grupet parlamentare duhet të jenë, sa më shumë të jetë e mundur, proporcionalisht të përfaqësuara në këto komisione.

Siç parashikohet, Komisioni i Hetimit dhe i Çështjeve Kushtetuese shqyrton dhe bën rekomandime lidhur me të gjitha raportet e OAG-së. Gjithashtu, Komisionit i lejohet të ndërmarrë vetë ekzaminime nëpër ministri. Qëllimi i këtyre kontrolleve me iniciativën e vetë Komisionit është që të marrë informacion, që konsiderohet i nevojshëm, për t'i mundësuar Parlamentit të trajtojë ato çështje që kanë të bëjmë me përgjegjësinë kushtetuese dhe parlamentare të anëtarëve të qeverisë. Në të tilla raste, OAG-së mund t'i kërkohet që të japë mendim ose të bëjë një deklaratë para se të merret ndonjë vendim, megjithatë OAG-ja nuk ka detyrim për të vepruar karshi këtyre kërkesave.

3. Roli i Komisioneve Parlamentare në shqyrtimin e raporteve dhe produkteve të tjera të SAI-t

Raportet e Auditimit nuk kanë shumë gjasë të nisin "*impeachment*" ndaj një ministri. Në vend të kësaj, Parlamenti mund të kërkojë përgjegjësinë parlamentare ose politike të qeverisë ose Ministrit. Megjithatë, kriticizmi politik/parlamentare ndaj ministrit përgjegjës është rezultati më i rëndomtë i raporteve. Janë zhvilluar shumë seanca dëgjimore mbi raportet e OAG-së mbi auditimin e performancës.

Zakonisht, kryetari i Bordit dhe anëtarë të tjerë të OAG-së marrin pjesë si vëzhgues gjatë sesioneve parlamentare, kur diskutohen raportet e auditimit.

Po ashtu, përfaqësues nga OAG marrin pjesë gjatë seancave dëgjimore në Komisione, kur temë diskutimi janë raportet e OAG-së. Megjithatë, kjo nuk është procedura normale.

4. Shkalla e pavarësisë së SAI-t përballë Komisioneve Parlamentare

Pavarësia buron nga pushteti ligjvënës që Parlamentit i atribuohet nga Kushtetuta, i cili është i detyruar të ofrojë një kuadër ligjor rreth mandatit, detyrimeve dhe fushëveprimit të punës audituese. Gjithashtu, parlamenti përcakton burimet financiare të OAG-së.

Legjislacioni aktual nuk rregullon mënyrën sesi OAG-ja duhet të kryejë detyrat e tij. Pavarësisht kësaj, ekziston një lloj mirëkuptimi mes Parlamentit dhe OAG që konsiston në atë se OAG-ja gëzon pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, në lidhje me standardet, metodologjinë dhe procedurën që do të zbatohet gjatë punës audituese.

Megjithatë, ekziston edhe një marrëdhënie informale mes anëtarëve të Komitetit dhe Bordit të Audituesve të Përgjithshëm. Rast pas rasti janë zhvilluar takime mes Komitetit dhe Bordit. OAG-ja ka gjithashtu kontakt të vazhdueshëm me administratën dhe kryesinë e Parlamentit mbi çështjet administrative dhe buxhetore.

5. Roli i Komisionit mbi veprimtarinë e SAI-t

Ky rol spikat në fusha të tilla si (a) Programi i Auditimit të SAI, (b) Kërkesën e Komisionit për auditim/hetime nga SAI, (c) Llojin e asistencës që SAI u ofron komisioneve parlamentare, (d)influencën e Komisionit mbi metodologjinë audituese të SAI-t.

(a) OAG është i lirë të vendosë prioritetet e veta dhe të planifikojë punën në përputhje me kushtet e referuara, si dhe të zgjedhë metodat e duhura në ushtrimin e detyrave.

(b) Dispozitat ligjore lidhur me OAG nuk rregullojnë nëse Parlamenti ose Komisionit kanë tagrin për të urdhëruar OAG-në në kryerjen e një auditimi specifik, në veçanti mbi auditimet e performancës. Sipas ligjit, vetëm Parlamenti, në një sesion parlamentar, mund të kërkojë realizimin e një auditimi të caktuar. Komisioni nuk konsiderohet se ka pushtetin për të bërë një kërkesë të tillë. Sot, duket se ka një

mirëkuptim të përbashkët mes politikanëve për të kufizuar numrin e kërkesave. **(c)** nëse komisioni kërkon më shumë informacion rreth një gjetjeje specifike, komisioni në të shumtën e rasteve u bën një kërkesë ministrive. Natyrisht, OAG-ja do t'i përcillen kopje të korrespondencës mes komisionit dhe ministrive, por kjo nuk ndodh gjithmonë.

Rast pas rasti, komisioni mund t'i kërkojë OAG-së që t'i përcjellë më shumë informacion. Kontakti dhe komunikimi mes Komisionit dhe OAG-së, kur trajtohen raporte të auditimit nuk është i parashikuar në asnjë dispozitë ligjore e për pasojë nuk ndjek një procedurë përkatëse.

(d) E gjitha punë audituese bazohet në standardet dhe manualet e auditimit, të adoptuara nga Bordi i Auditorëve të Përgjithshëm. Komisioni nuk ka influencë mbi metodologjinë audituese të OAG-së.

6. Funksione të tjera të mundshme

Funksione te tjera te SAI-t janë:

(a) funksioni i SAI-t përballë procesit ligjvënës, (b)miratimi i buxhetit vjetor të SAI-t, (c)Vlerësimi e punës së SAI-t nga komisionet parlamentare (d) Auditimi i SAI-t (dhe llojin e auditimit), (e) emërimi, shkarkimi i Kryetarit të SAI-t, miratimi i legjislacionit të SAI-t, etj..

(b) OAG nuk ka një funksion specifik *vis-à-vis* procesit ligjvënës dhe është plotësisht i pavarur nga pushteti ekzekutiv (qeveria dhe administrata publike). Megjithatë, OAG ftohet të komentojë mbi ligjet e propozuara nga pushteti ekzekutiv para se ato të dërgohen për miratim përfundimtar në Kuvend.

(c) OAG propozon projektbuxhetin që kalon menjëherë në Kryesinë e Parlamentit. Kryesia përgatit buxhetin e propozuar, së bashku me buxhetin për vetë Parlamentin, për miratim përfundimtar në sesionin parlamentar. Zakonisht, kryesia e parlamentit nuk zotëron kompetencën për të ndryshuar projektbuxhetin e propozuar nga OAG. Megjithatë, kryesia ka tagrin për ta bërë një gjë të tillë, dhe gjatë përgatitjes së buxhetit që do t'i propozohet Parlamentit, Kryetari i Bordit të Audituesve të Përgjithshëm duhet të japë sqarime rreth projektbuxhetin gjatë një takimi që zhvillon me Komisionin.

Miratimi përfundimtar realizohet pa shkurtime apo reduktim të buxhetit.

(d) Komisioni apo parlamenti nuk kryen një vlerësim specifik të punës së OAG-së. Megjithatë, Komisioni bën komente mbi punën e Bordit së bashku me rekomandimet që i dërgohet Parlamentit, nëpërmjet raportit vjetor mbi aktivitetet e OAG-së.

(e) Llogaritë e OAG-së auditohen nga një Llogaritar i Autorizuar nga Shtetit, i cili emërohet nga kryesia e parlamentit si audites (auditim financiar). Raporti i auditimit i paraqitet parlamentit së bashku me deklaratat financiare të OAG-së, që miratohen nga audituesit e përgjithshëm.

(f) Audituesit e Përgjithshëm zgjidhen për një mandat katër vjeçar dhe konstituojnë Bordin e Audituesve të Përgjithshëm.

Të qenit një anëtar i bordit konsiderohet si një pozicion besimi dhe ata nuk mund të shkarkohen gjatë periudhës së zgjedhjes.

Legjislacioni që rregullon OAG nuk mund të rishikohet. Vetë OAG-ja ka përgatitur një legjislacion të ri dhe një draft iu dërgua parlamentit në Janar të këtij viti(?). Drafti po i nënshtrohet një dëgjesë të jashtme me organet ekzekutive(ministritë). Me shumë gjasë, Parlamenti do ta shqyrtojë këtë draft më vonë gjatë këtij viti. Një çështje e rëndësishme që duhet të theksohet në legjislacionin e ri është statusi i pavarësisë së OAG-së(pavarësi si në raport me Qeverinë ashtu edhe me Parlamentin). Për shembull, konsiderohet e rëndësishme për OAG-në e drejta për të vendosur në mënyrë të pavarur rreth detyrave audituese dhe programit të punës. Nga ana tjetër, OAG do të vazhdojë të synojë që ketë një marrëdhënie të ngushtë dhe dialog të vazhdueshëm me Parlamentin dhe Komisionin e Hetimit dhe të Çështjeve Kushtetuese. Edhe nëse Parlamenti apo Komisioni nuk do të bëjnë kërkesa formale, do të merren në konsideratë edhe ato kërkesa informale kur OAG të vendosë rreth programit të auditimit.

Sipas këtij drafti, vetëm Parlamenti në sesione plenare do të ketë pushtetin për t'i dhënë udhëzime OAG-së që të ndërmarrë auditime hetuese specifike. Është e një rëndësie të madhe fakti se e gjitha puna audituese bazohen në vlerësimin e riskut dhe materialitetit.

OAG ka në dizpozicion një sërë burimesh të përshtatshme dhe brenda kësaj kornize, duhet të vendosë sesi t'i alokojë në detyra të ndryshme që realizon. Nevoja që Parlamenti të japë udhëzime të tilla ndaj OAG-së duhet të konsiderohet si kundër nevojës së OAG-së për të planifikuar burimet e domosdoshme financiare dhe njerëzore në funksion të detyrimeve dhe përgjegjësive të saj ligjore.

Portugali

Marrëdhënia mes Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe Komisioneve Parlamentare[9]

Ndërtesa e Parlamentit Portugez, Lizbonë *Ndërtesa e Gjykatës së Llogarive, Lizbonë*

Marrëdhëniet kryesore mes Gjykatës së Llogarive (Tribunal de Contas) dhe Parlamentit janë vendosur me Komisionin e Financave dhe Ekonomisë. Megjithëse nuk ka rregulla apo rregullore për të siguruar karakterin jopolitik të komisioneve parlamentare, Gjykata sipas nenit 7 të ligjit nº 98/97 është e pavarur, vetëqeverisëse dhe e papërgjegjshme, anëtarët nuk mund të shkarkohen nga zyra dhe i nënshtrohen vetëm ligjit.

Sipas Kushtetutës, Parlamenti njihet me gjendjen financiare vetëm nëpërmjet Gjykatës së Llogarive. Në realitet, e megjithëse është një akt tipik konsultimi, Opinioni i Gjykatës është një instrument i rëndësishëm për të analizuar financat e shtetit. Ajo bën një vlerësim financiar për të dalë me një vendim mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e zbatimit të buxhetit. Gjithashtu, vlerëson ekonomicitetin, efiçensën dhe efektivitetin e menaxhimit dhe besueshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Gjykata praktikisht asiston Parlamentit me qëllimin e kësaj performance. Në të njëjtën mënyrë, marrëdhënien bashkëpunuese midis dy organeve buron nga paragrafi 2 i nenit 36 të ligjit nº. 8/97, e cila parashikon mundësinë që Gjykata të njoftojë Parlamentin për informacionin që ka mbledhur, gjatë zbatimit të buxhetit

[9] *Pjesa më e madhe e materialeve janë siguruar nga portali http://www.tcontas.pt/en/english.shtm*

ose deri në publikimin e Llogarisë së Përgjithshme Shtetërore (*General State Account*.)

Për më tepër, brenda fushëveprimit të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe me objektivin e forcimit të marrëdhënieve me Parlamentit, adresuesi kryesor i veprimtarisë së Gjykatës, ligji parashikon se Parlamenti mund të kërkojë që Gjykata: "të ofrojë raporte periodike mbi rezultatet e kontrollit te buxhetit përgjatë vitit, sqarime për vlerësimin e buxhetit të shtetit si dhe raportin mbi Llogaritë e Përgjithshme Shtetërore" ose më tej "të njoftojë mbi informacionet, raportet ose opinionet në lidhje me funksionet respektive të kontrollit financiar.

Përtej fushës së rreptë të zbatimit të buxhetit, Parlamenti mund të kërkojë që Gjykata të ndërmarrë auditime mbi aktivitetet e kryera nga ente të ndryshme, publike ose private, të cilat janë subjekt i kompetencave të saj.

(Më e pakta që mund të kërkojë Parlamenti është që Gjykata e Llogarive t'i ofrojë informacione, raporte ose opinione, në lidhje me detyrat respektive të kontrollit financiar, veçanërisht në prezencën e presidentit ose gjatë sesioneve të komisioneve parlamentare ose të shërbimeve mbështetëse, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nº 98/97.)

Po aq e rëndësishme, është pjesëmarrja e Gjykatës së Llogarive në procesin ligjbërës, të natyrës financiare, me kërkesën e Parlamentin në formën e dhënies së opinioneve këshilluese.

Sa i përket programit të auditimit të Gjykatës dhe metodologjisë audituese, komisionet parlamentare nuk kanë ndikim. Parlamenti miraton legjislacionin e Gjykatës dhe buxhetit vjetor të saj.

Raporti vjetor mbi aktivitetin e Gjykatës, si dhe certifikimi i pasqyrave financiare të Gjykatës, i paraqiten Komisionit të Ekonomisë dhe Financave - vetëm për informacion. Komisionet parlamentare nuk kanë kompetencë të vlerësojnë punën e Gjykatës. Emërimi ose shkarkimi i kreut të Gjykatës bëhet nga Presidentit i Republikës, me propozimin e Ekzekutivit.

KAPITULLI V

Kuvendi i Kosovës, komisionet e tij dhe Zyra Kombëtare e Auditimit

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës *Ndërtesa e Zyrës Kombëtare të Auditimit*

Kosova shtet i pavarur dhe SAI i saj

Më 17 shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur. Pavarësia e Kosovës shtroi përpara sfida të mëdha për shtet-ndërtim, në kuadrin e forcimit të institucioneve demokratike të shtetit më të ri të Evropës.

Sigurisht, kjo nuk mund të arrihej pa një forcim të llogaridhënies dhe të mirëmenaxhimit të financave publike, të cilët përbëjnë dy shtyllat kryesore të zhvillimit të një shteti. Qeverisja e mirë është katalizatori i ngritjes së institucioneve demokratike dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, falë edhe mbështetjes ndërkombëtare, është shndërruar në një institucion me një rol kyç në proceset shtet-ndërtuese të Kosovës.

Që në ditët e para pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi i Kosovës ngriti Komisionin për Buxhet e Financa, si një strukturë që, ndërmjet të tjerash, do të mbikëqyrte edhe aktivitetin dhe raportet e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Me 19 janar 2009, vetëm 11 muaj nga Shpallja e Pavarësisë, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar Pieter Feith emëroi z. Lars Lage Olofsson si Auditor të Përgjithshëm të Kosovës. Z. Olofsson është një personalitet ndërkombëtar i auditimit suprem publik, me mbi 25 vjet eksperience. Ai ka qenë Ndihmës i Audituesit të Përgjithshëm të

Suedisë dhe Këshilltar i Lartë i programit të BE dhe OSBE "SIGMA-Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim".

Gjatë pesë viteve të qëndrimit të tij në detyrë, z. Olofsson ndërmori programe konkrete dhe ambicioze për ngritjen e aftësive profesionale të audituesve supreme të Kosovës, duke realizuar kualifikimin e një numri të konsiderueshëm të tyre për certifikimin e pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore. Krahas kësaj, z. Olofsson vendosi marrëdhënie shumë korrekte me Kuvendin e Kosovës dhe Komisionin e tij për Buxhet e Financa, duke realizuar një informim të gjerë të anëtarëve të Kuvendit për auditimet e Zyrës dhe mesazhet kryesore të tyre.

Z. Lars Lage Olofsson dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH, duke nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) dhe KLSH, 13 shkurt 2012, Tiranë.

Duhet theksuar se që në fillim, imazhi i ndërtuar pranë deputeteve të Kosovës për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm është shume pozitiv, si një institucion me standarde dhe pak ose aspak i ndikuar nga politika. Gjithnjë e më shpesh deputetet e Kuvendit bazohen në shifrat dhe konkluzionet e auditimeve të Zyrës.

Punën e bërë nga Kuvendi, mbështetur në auditimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), e ka vlerësuar edhe Kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, z. Sadri Osmani, i cili theksoi se: "*Gjetjet nga auditimet e ZKA na kanë ndihmuar ne si Komision të ushtrojmë trysninë e duhur mbi shumë njësi buxhetore dhe mbi Qeverinë, për të përmirësuar administrimin financiar. Mund t'ju sjell një rast, auditimi nga ZKA i Radio Televizionit të Kosovës, që është një njësi buxhetore publike, për të cilin qytetarët e Kosovës paguajnë. Menaxhimi i kësaj njësie ka patur shumë probleme të mbartura nga viti në vit, duke krijuar një situate të vështirë për administrimin e këtij entiteti. Tani situata aty është përmirësuar*".

Z. Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës dhe z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit te Larte te Shtetit, gjatë një takimi pune në Prishtinë, 2016.

Dëshmi të rolit tejet të rëndësishëm që SAI i Kosovës ka për jetën shoqërore e politike të vendit dhe për kontributin e tij në menaxhimin e përgjegjshëm të financave publike, e përbën fakti se SAI ishte institucioni i fundit që kaloi nën drejtimin e autoriteteve të Kosovës (me 30 mars 2016 emërohet Auditor i Përgjithshëm i Kosovës z. Besnik Osmani, një personalitet i njohur në fushën e financave publike të vendit).

SAI i Kosovës njihej më së shumti si Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe emërimi i z. Osmani shënon dhe kalimin e këtij institucioni nga "mandati" ndërkombëtar në "mandatin" e shtetit të Kosovë, duke sjelle edhe ndryshimin e emrit nga ZAP në Zyrën Kombëtare të Auditimit, si simbolikë të "kombëtarizimit" të një institucioni deri vonë me drejtim "ndërkombëtar".

ZAP ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me KLSH më 14 shkurt 2012. Të dyja SAI-t kanë realizuar shumë aktivitete të përbashkëta, si trajnime, konferenca e seminare pune, vizita të ndërsjella për marrje eksperience, etj. ZAP-i ka qenë pjesëtar aktiv në analizat vjetore dhe konferencat shkencore të KLSH për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, duke përshëndetur dhe dhënë mendime me vlerë.

Mbi bazën e kësaj Marrëveshje, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj dhe Auditori i Përgjithshëm i ZKA, Z. Besnik Osmani nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Planin e Veprimit për aktivitete të përbashkëta për vitet 2017-2018, në Prishtinë, në datën 22 nëntor 2016.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj dhe Auditori i Përgjithshëm i ZKA, Z. Besnik Osmani gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Planit të Veprimit për aktivitetet e përbashkëta 2017-2018 mes Zyrës Kombëtare te Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prishtinë, 22 nëntor 2016.

Marrëveshja e re përfshin shkëmbimin e përvojave në nivel praktik dhe teknik për zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të auditimit publik dhe praktikave të mira evropiane, vijimin e traditës së krijuar midis dy institucioneve për realizimin e seminareve, workshop-eve dhe trajnimeve të përbashkëta, të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve të audituesve të KLSH dhe ZKA, sesione edukative dhe këshilluese

me qëllim përditësimin e materialeve të metodologjisë në auditim, për fushat me interes të përbashkët, si dhe 6 auditime të përbashkëta në dy vitet në vijim(qëllimi i auditimit dhe çështjet kyçe do të vendosen bashkërisht dhe raportet e auditimit do t'u dërgohen Parlamenteve respektive). Temat e përzgjedhura për t'u audituar do të kenë interes kombëtar dhe rajonal dhe do t'i shërbejnë zhvillimit të strategjive kombëtare të të dy vendeve.

Raportet me Komisionin për Buxhet dhe Financa

Zyra Kombëtare e Auditimit u konturua sipas imazhit perëndimor të një SAI dhe si e tillë, roli i saj është pazgjidhshmërisht i lidhur me vetë Kuvendin e Kosovës, bazuar në traditën që një SAI i pavarur është një "agjent" i Parlamentit, një "rojtar" i tij mbi fondet publike. Për rrjedhim, rritja e kapaciteteve të një SAI nuk duhet parë vetëm brenda kësaj organizate, por e lidhur ngushtë me kapacitetet e vetë Parlamentit për të kuptuar dhe shqyrtuar me imtësi gjetjet dhe rekomandimet e SAI-t, si dhe për të ndjekur me forcë zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke ushtruar presionin dhe autoritetin e tij.

Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrton raportin vjetor të ZKA-së si dhe kërkesat buxhetore apo propozimin për buxhetin vjetor të kësaj Zyre, në kuadër të shqyrtimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Raportet e përgatitura nga Zyra Kombëtare analizohen nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa si burim informacioni me rastin e shqyrtimit të projektbuxhetit të Republikës së Kosovës, respektivisht propozim-buxhetin e organizatave buxhetore. Të dhënat nga raportet e auditimit, që kanë të bëjnë me gjetjen mbi mënyrën e kryerjes së shpenzimeve dhe performancën e një organizate buxhetore nga viti paraprak, mund të përdoren nga komisioni si fakt për të propozuar ndryshimin e buxhetit (rritjen apo zvogëlimin-bazuar në menaxhimin dhe performancën) për një organizatë buxhetore gjatë amendimit të buxhetit të Kosovës për vitin pasardhës.

Përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, kur shqyrtohet raporti vjetor financiar i Zyrës Kombëtare dhe projektbuxheti. Komisioni ka menduar që Zyra Kombëtare e Auditimit apo përfaqësuesit e saj do të ishte e dobishme që të merrnin pjesë në takimet e komisionit me rastin e shqyrtimit të projektbuxhetit vjetor. Deri më tani nuk është aplikuar kjo praktikë, përveç shqyrtimit të dokumenteve të raporteve dhe rekomandimeve të Auditorit te Përgjithshëm, ndërsa prania fizike e përfaqësuesve te ZAP jo. Ky bashkëpunim amplifikon forcën e rekomandimeve të dhëna në rastin e shqyrtimit të projektbuxhetit për vitin e ardhshëm si dhe në rastin e shqyrtimit të

raport vjetor financiar të qeverisë për buxhetin e Kosovës. Sipas Auditorit të Përgjithshëm, z. Besnik Osmani, ka një sfazim ne kohe te marrjes se raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për zbatimin e Buxhetit te Shtetit te vitit te kaluar. Ky raport merret ne muajin prill të çdo viti, në kohën kur rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shtim ose pakësim të buxhetit të njësive të ndryshme ekonomike buxhetore jepen gjatë muajit tetor, kur diskutohet në Komision projekt-Buxheti i Qeverisë për vitin e ardhshëm. Kjo diference në kohë ka bërë që në disa raste Komisioni për Buxhet dhe Financa të rekomandojë për shtim buxheti për institucione, në auditimin e të cilave ZKA ka dalë me opinion mohues ose me rezerva për pasqyrat e tyre financiare. Auditori i Përgjithshëm ka biseduar me kryetarët e të dyja komisioneve të mbikëqyrin ZKA dhe ndan bindjen se shumë shpejt ky sfazim në kohë do të zhduket dhe Komisionet do të marrin në kohën e duhur raportin e ZKA për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin e kaluar.

Sipas Kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa (KBF), z. Naser Osmani, ky Komision ka në plan krijimin e marrëdhënieve më të ngushta me ZKA-në, me rastin e shqyrtimit të buxhetit të Republikës së Kosovës, përmes pranisë së përfaqësuesve të ZKA-së në Komision dhe marrjes parasysh të rekomandimeve dhe gjetjeve, me rastin e propozimit te projekt-buxhetit dhe miratimit në Kuvend. Po ashtu, përfshirja e KBF do ta ndihmonte procesin. Kjo do të kontribuonte në thellimin e marrëdhënieve dypalëshe. Nga njëra anë, rekomandimet e ZAP do të merrnin parasysh e do të jetësoheshin me shumë, nga ana tjetër kjo do të ndihmonte Komisionin që në rast të rekomandimeve apo amendimeve të buxhetit për organizatat buxhetore, respektivisht për rritjen apo shkurtimin e buxhetit të tyre, të bazohet përveç nevojave buxhetore edhe në mënyrën e menaxhimit dhe performancës së këtyre njësive në vitet e mëparshme.

Lidhja e vetme mes ZAP dhe Parlamentit deri në vitin 2009 ishte Komisioni për Buxhet dhe Financat. Por sikurse u shpreh edhe vete Kryetari i këtij Komisioni, z. Naser Osmani,*”...si deputete ishim shume te ngarkuar, raportet e auditimit te ZAP ishin voluminoze dhe fizikisht nuk e kishim kohen t’i këqyrnim te gjitha*”. Për rrjedhoje, edhe pse ky komision ishte përgjegjës për kontrollin buxhetor dhe të financave, për shkak të gjerësisë së kompetencave te tij në shqyrtimin e implikimeve financiare të çdo projektligji të paraqitur ne Kuvendin e Kosovës dhe për përgatitjen e buxhetit të Republikës, duke mos i lënë kështu hapësirën e kërkuar ZAP-it, kontaktet e Komisionit me ZAP-in, njohja e auditimeve, gjetjeve dhe mesazheve qendrore te tyre ishin të cekëta dhe nuk krijonin në thelb atë duet te domosdoshëm Parlament-SAI për t’i dhënë forcën, autoritetin e duhur dhe jehone gjetjeve të SAI-t dhe për të

siguruar zbatimin rigoroz të rekomandimeve të tij. I vetëdijshëm në mangësitë e deritanishme në raportet me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), z. Osmani shprehet se është i vendosur të bëjë një vijë të qartë demarkacioni mes kompetencave dhe e mbikëqyrjes së auditimeve dhe aktivitetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit nga ana e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionit te tij, duke shmangur kështu të gjitha dublimet që janë vërejtur deri tani në punën e të dy Komisioneve.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës gëzon përkrahjen e autoriteve kryesore të Shtetit kosovar.

Auditori i Përgjithshëm i ZKA Besnik Osmani dhe Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, priti me 9 shtator 2016 në takim Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës, z. Besnik Osmani, i cili i dorëzoi kreut të vendit raportin vjetor për vitin 2015. "*E mirëpres raportin dhe gjetjet e tij. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gëzon besim dhe kredibilitet*", u shpreh Presidenti Thaçi[1].

[1] *Pasqyrimi i takimit në media. http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=98149*

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani u shpreh në takim se ZKA ka evidentuar përmirësime, porse mbeten ende edhe disa probleme.

Duke iu referuar punës së auditorëve, Presidenti Thaçi theksoi se duhet të ruhet dhe të afirmohet sa më shumë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Krijimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike: "PAC"-u kosovar

Duke parë mungesat e mëdha të raporteve Kuvendi i Kosovës-ZAP dhe vëmendjen jo të duhur që Kuvendi i kushtonte deri atëherë auditimeve dhe gjetjeve të ZAP, disa përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë, me mbështetjen edhe të donatorëve, kërkuan krijimin e një strukture të re, një komisioni të ri brenda Parlamentit të Kosovës. Nisën kështu përpjekjet për krijimin e një Komisioni të Llogarive Publike, të PAC-ut (*Public Accounts Committee*) kosovar, sipas modelit anglosakson, i profilizuar dhe kompetent vetëm për shqyrtimin e raporteve të auditimit të SAI-t të Kosovës. Përpjekjet si te Kuvendit të Kosovës, edhe të shoqërisë civile, e cila u tregua shumë aktive dhe ndihmoi me materiale dhe trajnime për deputetet, u finalizuan më 24 korrik 2009, kur Kuvendi i Kosovës miratoi ngritjen e Komisionit të Mbikëqyrjes së Financave Publike (KMFP), strukture e cila filloi veprimtarinë e saj më 2 nëntor të 2009.

Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare shqyrton raportin vjetor të performancës, raportet individuale të auditimit për organizatat buxhetore dhe raportin vjetor të auditimit. Në vit, KMFP shqyrton rreth 20-30 raporte auditimi, ndërsa po bëhen përpjekje për të rritur numrin e shqyrtimeve duke bërë një kategorizim më efektivë të raporteve, duke i grupuar në një të vetëm ato të cilat kanë tipare të përbashkëta sa i përket gjetjeve. Më konkretisht, shqyrtimi i raporteve të auditimit për komunat realizohet duke i grupuar dhe duke zhvilluar një mbledhje të përbashkët me kryetarët e komunave, dhe jo mbledhje me secilin kryekomunar.

Një faktor i rëndësishëm që ka forcuar lidhjen me ZKA-së dhe Parlamentit është numri i faqeve të raportit të Auditimit. Këto raporte janë rreth 30-40 faqe, duke u përmbajtur formës së kërkuar nga standardet ndërkombëtare. Konkluzionet e auditimit shprehen në formën e opinioneve të kualifikuar, pakualifikuar, me theksin të çështjes, refuzues e kundërshtues, duke bërë përmbajtjen më të qartë e koncize për t'u kuptuar nga deputetët, madje atyre u përcillet një raport edhe më i përmbledhur në 3-5 faqe. Marrëdhënia simbiotike reflektohet edhe në faktin se Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare ka të drejtë t'i bëjë propozime ZKA-së për

kryerjen e një auditimi tematik. Kjo nuk përbën një cenim të pavarësisë së ZKA-së, pasi një kërkesë e tillë duhet të miratohet nga Auditori i Përgjithshëm.

Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare, si një Komision për ZKA-në, përbëhet nga 9 anëtarë ku kryetari emërohet nga Opozita, ndërsa Nënkryetari nga partia/koalicioni maxhoritar. Kryesimi nga një anëtar i Opozitës thekson pavarësinë e Komisionit, pra shërben si një distancim nga qeveria, e cila në fakt është objekt i auditimit.

Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari përcakton axhendën e raporteve që do të shqyrtojë, duke i prioritarizuar në bazë të opinionit të dhënë nga audituesi e për rrjedhim opinionet e pamodifikuara apo me theksim të çështjes marrin një rëndësi të veçantë, në varësi edhe të peshën financiare dhe sociale të institucionit buxhetor që trajtohet në raport. Ka raste që shqyrtohen edhe ato raporte që tregojnë një performancë të mirë të organizatës buxhetore të audituar, për të rritur besueshmërinë e kësaj të fundit në rast të kërkimit të fondeve shtesë

Pasi përcaktohet axhenda, me përjashtim të shqyrtimit të raportit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara që duhet të shqyrtohet nga të gjithë deputetët, secili deputet përzgjedh një raport auditimi dhe pikërisht këtu është momenti kur formohet një skuadër deputet-auditues, që do të marrë në pyetje eprorin e institucionit të audituar, Para se të shqyrtohet një raport auditimi, Komisioni, sipas rastit mund të bëjë një takim paraprak me audituesit për t'u njohur me çështjen, objekt auditimi. Është e rëndësishme të theksohet se Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare tregon kujdes në shmangien e konfliktit të interesit. Nëse një deputet përzgjedh një raport auditimi për një institucion, në të cilën ka ushtruar detyra zyrtare, ai heq dorë nga ky raport dhe nis kështu një përzgjedhje të re të raporteve të auditimit. Sakaq, në rast të shqyrtimit të një raporti që kërkon një ekspertizë të veçantë, Komisioni ka të drejtë të angazhojë ekspertë të jashtëm.

Ministri e ka detyrim të jetë prezent në mbledhjen e komisionit kur shqyrtohen raporti për ministrinë e tij. Në rast mungese, shqyrtimi i raportit shqyrtohet deri në një komunikim të dytë me ministrinë dhe nëse konstatohet një mungesë e dytë, raporti dërgohet për shqyrtim në seancë plenare. Shqyrtimi i raporteve nga KMFP nuk i kufizon që raportet të shqyrtohen edhe nga komisione të tjera, sipas fushës së tyre përkatëse. Më konkretisht, një raport auditimi të performancës mbi Menaxhimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore mund të shqyrtohet edhe në Komisioni mbi Arsimin, Shkencën, Teknologjinë, Kulturën, Rininë dhe Sportet.

Në bazë të gjetjeve të raportit dhe mungesës së argumenteve të subjektit të audituar, Komisioni vendos me shumicën e votave dërgimin e çështjeve në seancë plenare, duke rritur kështu llogaridhënien dhe transparencën me projektimin e raportit si një kontroll i Parlamentit. Mund të sjellim si shembull faktin se në dhjetor 2015, Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe rekomandimet lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014. Më pas, janë miratuar edhe rekomandimet lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin 2014. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe Rekomandimet që kanë të bëjnë me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike luan një rol të rëndësishëm në amplifikimin e raporteve të auditimit. Shqyrtimi në komisionin parlamentar rrit peshën e raporti të auditimit duke i dhënë nuanca imperative zbatimit të rekomandimeve, madje këto të fundit shpesh dalin si rekomandime të vetë Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare. Në mbledhjen nr.31, datë 1 korrik 2016, në shqyrtimin Raportit të Auditimit të performancës mbi Menaxhimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore KMFP vendosi që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në afatin kohor brenda tre muajve, të përgatisë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit. Po ashtu KMFP, vendosi të shtohet një rekomandim i ri që MASHT të rrisë cilësinë e teksteve shkollore, t'i obligojë shkollat që t'i kthejnë tekstet shkollore, dhe të aplikojë masa ndëshkuese për shkollat që nuk e bëjnë kthimin e teksteve shkollore. Për këto rekomandime u vendos që të përfshihen në udhëzimin e ri administrativ për shpërndarjen e teksteve shkollore.

Secili deputet bëhet monitorues i zbatimit të rekomandimeve të një raporti auditimi specifik dhe subjekteve të audituar u lihet një afat kohor, zakonisht 1 muaj, për të dorëzuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së shërben si matës i besueshmërisë së një institucioni dhe në rastet e ministrive, mungesa e zbatimit pasjellë edhe përgjegjësi politike. Tërheqja e vëmendjes që mund t'u bëhet ministrave për moszbatimin e rekomandimeve, falë prezencës së theksuar të mediave dhe fokusit që opinioni tregon karshi mbledhjes së

komisionit, projekton presionin parlamentar dhe atë publik në një pikë të vetme, kah rritjes së përgjegjshmërisë së ministrit.

Zbatimi i rekomandimeve të ZKA-së është një kriter për përfitimin e fondeve nga ndërkombëtarët dhe në Kosovë janë shënuar shumë raste në komuna, ku u është refuzuar fondi, ngaqe nuk janë zbatuar rekomandimet e ZKA-së.

Megjithatë, nuk ka një mekanizëm për të rritur forcën detyruese të zbatimit të rekomandimeve. Kryetari i Zyrës Kombëtare të Auditimit, z. Besnik Osmani synon të zgjeroje debatin lidhur me atë se çfarë forme duhet të ketë mekanizmi detyrues për zbatimin e rekomandimeve te ZKA, duke u shprehur se atyre subjekteve, njësi buxhetore që nuk kanë zbatuar rekomandimet, nuk duhet t'u jepen më shumë fonde se ç' kanë pasur. Në funksion të forcimit të marrëdhënieve SAI- Parlament, z. Besnik Osmani ka theksuar se raportet e auditimit duhet të shqyrtohen nga të gjithë deputetët dhe duhet të jenë pjesë e punës së tyre. Pavarësisht se nuk ka një aplikim të plotë të marrëdhënies SAI-Parlament, sipas modelit anglosakson, Kosova përbën një shembull unik në rajon dhe një praktikë e mirë për t'u ndjekur.

Mbledhjet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike ndiqen rregullisht nga mediat e Kosovës, si ato elektronike dhe gazetare te shtypit.

Nga takimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shqyrtimin e raportit të auditimit të ZKA në Ministrinë e Kulturës, në prani të Ministrit të Kulturës dhe të eksperteve të ZKA, 21 shtator 2016.

Ekzistenca e dy Komisioneve e ka bërë të nevojshme edhe ndarjen e detyrave, duke synuar të mos shkaktohen përplasje apo dublim në punën e komisioneve. Ndarja është bërë duke përcaktuar rolin *ex-ante* që duhet të luajë Komisioni për Buxhetin dhe Financat dhe rolin *ex-post* që duhet të luajë Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare. Kjo do të thotë se në shqyrtim ex-ante, KBF kontrollon politikat financiare qeveritare duke marrë për bazë rekomandimet që dalin nga kontrolli *ex-post* që bën

KMFP të shpenzimeve të kaluara qeveritare, në bazë të shqyrtimit të raporteve të përgatitura nga ZKA.

Boks 14

Modeli anglosakson: Roli ex-post i Komisionit të Llogarive Publike është që të shqyrtojë:

***(a)** çfarëdo llogarie të sjellë para Parlamentit;*

***(b)** çfarëdo raporti të sjellë para ose të bërë për Parlamentin nga Auditorit i Përgjithshëm; dhe*

***(c)** çfarëdo dokumenti tjetër të sjellë para Parlamentit, ose që i referohet atij nga Byroja Parlamentare apo nga Auditori i Përgjithshëm në lidhje me kontrollin financiar, llogaritë dhe auditimin në lidhje me shpenzimet publike.*

Roli ex-ante i Komisionit të Financave është që të shqyrtojë

***(a)** çfarëdo raporti ose dokumenti tjetër të sjellë para Parlamentit nga anëtarët e Ekzekutivit, ku përmbahen propozimet për, ose buxhetet e, shpenzimeve publike ose propozimet për sjelljen e rezolutave të ndryshimit të tatimeve, duke marrë parasysh çfarëdo raporti ose rekomandimi që ka të bëjë me dokumente të tilla që i janë dhënë atyre nga çfarëdo komisione tjetër që kanë fuqi që të konsiderojnë dokumente të tilla ose ndonjë pjesë të tyre;*

***(b)** çfarëdo raporti të bërë nga ndonjë komision ku caktohen propozimet në lidhje me shpenzimet publike;*

***(c)** ligjet buxhetore; dhe*

***(d)** çfarëdo çështje tjetër që ka të bëjë ose që ndikon në shpenzimet e Administratës ose shpenzimet tjera që paguhen nga Fondi i Konsoliduar Skocez.*

Reference (Instituti i Kërkimeve të Kosovës)
http://www.kipred.org/repository/docs/Mbik%C3%ABqyrja_e_Financave_Publike_n%C3%AB_Kosov%C3%AB__212926.pdf

Në shqyrtimin e çështjeve të lidhura me ZKA, takimet mes dy komisioneve janë zhvilluar në formën e tryezave apo workshop-eve të organizuara nga Projekti GIZ i Qeverise Gjermane. Është diskutuar që takimet mes dy institucioneve të jenë më të shpeshta, sidomos në fazën e shqyrtimit të buxhetit në Kuvend, një praktikë që pritet të zbatohet se shpejti.

Marrëdhënia mes ZKA dhe Parlamentit është reflektuar edhe në bërjen e kërkesave nga Komisionet. Në vitin 2014, KBF i ka rekomanduar Kuvendit që në bazë të ligjit për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, t'i kërkojë ZAP të kryejë auditimin e performancës së televizionit shtetëror RTK dhe raportin t'ia përcjellë Kuvendit.

Nga prezantimi i Raportit vjetor të Performances së ZKA, 22 shtator 2016 pranë Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Z. Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, ka prezantuar para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, raportin e Performancës së Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrave vjetore financiare për vitin 2015, të audituara nga audituesi i jashtëm privat "Grant Thornton", kompani e mirënjohur e angazhuar nga Kuvendi.

Ky raport përmban informata për punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit gjatë vitit 2015. Z. Osmani ka njoftuar Komisionin se gjatë kësaj kohe janë kryer gjithsej 109 auditime, prej të cilave 91 auditime të rregullsisë për të gjitha organizatat buxhetore

dhe 18 auditime të performancës dhe fondeve të donatorëve. Në total janë dhënë 1033 rekomandime prej të cilave 336 apo 32% janë zbatuar, 304 apo 29% janë në proces të adresimit ndërsa 393 apo 37% nuk janë adresuar fare.

Auditori i Përgjithshëm, para anëtarëve të Komisionit ka ngritur shqetësimin e tij, për rekomandimet që nuk po adresohen nga organizatat buxhetore. Ai ka kërkuar nga deputetët që bashkërisht të punohet në gjetjen e modaliteteve për krijimin e mekanizmave detyrues, në mënyrë që numri i rekomandimeve të pa-adresuara të bjerë dhe njëkohësisht të rritet performanca në administratën publike.

Pas një diskutimi thelbësor, raporti është miratuar si i tillë nga anëtarët e komisionit, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme për Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Cikli që ndjek llogaridhënia në Kosovë është si më poshtë :

1. *Autorizimi i shpenzimeve qeveritare nga Kuvendi;*

2. *Prodhimi i llogarive vjetore nga departamentet e qeverisë dhe organet tjera publike;*

3. *Auditimi i këtyre llogarive nga Zyra kombëtare e Auditimit(ZKA);*

4. *Dorëzimi i raportet të auditimit tek Kuvendi për t'u rishikuar nga Komisioni per Mbikqyrjen e Financave Publike(KMFP);*

5. *Nxjerrja e raporteve dhe rekomandimeve nga KMFP; dhe*

6. *Reagimi i qeverisë ndaj raporteve të KMFP.*

Falë kësaj marrëdhënie të konsoliduar, Parlamenti dhe qytetarët kanë mundësi të informohen edhe rreth funksionimit të auditimit të brendshëm. Hallka e fundit e raportimit të auditimit është vetë qeveria ndërkohë që falë raporteve të ZKA-së, ku përfshihet edhe auditimi i brendshëm, Parlamenti informohet edhe mbi funksionimin e auditimit të brendshëm.

Buxheti i SAI-t në Kosovë

Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF), në vitin 2016, në cilësinë e komisionit të përhershëm ka shqyrtuar projektligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe ka marrë parasysh kërkesat e ZKA për pagën e Auditorit të Përgjithshëm deri në nxjerrjen e ligjit për pagat e funksionarëve të lartë. Po ashtu ka përkrahur propozimet që statusi i audituesve të dallohet nga shërbyesit civilë e të rregullohet me këtë ligj.

Buxheti i ZKA përgatitet në pajtim me ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë. Kuvendi vendos apo miraton buxhetin e ZKA në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Si përfundim, mund te thuhet se, pavarësisht se nuk ka një aplikim të plotë të marrëdhënies SAI-Parlament, sipas modelit anglosakson, Kosova përbën një shembull unik në rajon dhe një praktikë të mirë për t'u ndjekur.

CIP - Katalogimi në botim - BK Tiranë

RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit

Eksperienca e vendeve europiane në auditimin e jashtëm publik / RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit; përg. Fatos Çoçoli ; red. Redi Ametllari. – Tiranë : KLSH, 2016

156 f. : me il. ; 16.1x23.8 cm.
Bibliogr.
ISBN 978-9928-159-54-0

1. Administrimi publik 2. Financa publike
3. Kontrolli

351.9(4)

ILAR®

Seria : botime KLSH 15/2016/66

ISBN: 978-9928-159-54-0

9 789928 159540